



**HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)**

FËMIJË! A JU KA SHKUAR NDO NJËHERË NË MENDJE?

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



24 ORË

**NGA JETA E
MUSLIMANIT**

**HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)**



Shtëpia Botuese "Furkan ISM"
Brigada II Maqedonase, lokali 22
1000 Shkup, Maqedoni



Publikuar: qershor, 2010

Përkthyer nga: Marsela Tarelli

www.harunyahya.com
www.harunyahya.com/albanian
info@harunyahya.com

PËRMBAJTJA

HYRJE10

24 Orë në Jetën e Muslimanit Sipas Mësimeve

të Kur'anit16

Zgjimi në mëngjes16

Pastrimi22

Veshja30

Ngrënia e mëngjesit38

Në rrugë56

Në punë74

Në treg80

Ushtrimet dhe stërvitja fizike86

Falja e namazit90

Shkuarja për në shtrat98

Këndvështrimi Kur'anor i Besimtarit104

Sjellja ndaj familjes dhe shokëve104

Sjellja ndaj mirësive108

Sjellja ndaj bukurisë114

Reagimi kundrejt ndodhive në dukje negative120

Qëndrimi gjatë sëmundjes128

**Qëndrimi i shfaqur në situata të vështira
dhe të pafavorshme130**

Cilësitë e Larta të Karakterit të Besimtarit134

Vigjilenca ndaj kurtheve të djallit134

Mirëkuptimi, toleranca dhe falja138

Durimi142

Fjala e mirë144

Urtësia148

Mikpritja150

Paqja dhe respekti i ndërsjelltë152

Shmangia e inatit dhe grindjes154

Thuaj "Jo" lakmisë156

Lënia e dyshimit dhe thashethemeve158

Lënia e talljes160


Vetësakrifikimi162

Të vepruarit me drejtësi164

Singeriteti166

Përfundim168

Shtojcë Mashtrimi i Evolucionit172



HYRJJE

Në Kur'an, Allahu i përgjigjet të gjitha pyetjeve që ka nevojë të dijë njeriu përgjatë gjithë jetës së tij dhe jep zgjidhjet më të përsosura dhe më kuptimplota për të gjitha problemet që ngrihen. Ashtu siç thotë në vargun e dytë të sures Bekare: "Ky është libri që nuk ka dyshim në të. Ai është udhëzim për ata që ruhen." Vargjet e tjera tregojnë se Zoti ynë ka shpjeguar gjithçka në Kur'an:

Në tregimet e tyre pati mësimet e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë dhe sqarues i çdo sendi e, edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson. (Sure Jusuf: 111)



Ne ty të shpallëm Librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe përgëzim për Muslimanët. (Sure Nahl: 89)

Një njeri besimtar e jeton gjithë jetën e tij nën dritën e Kur'anit dhe përpiket që ditë pas dite të verë në zbatim atë që ka mësuar në vargjet e tij. Në gjithçka që ai bën, që nga çasti që ngrihet në mëngjes e derisa shkon në shtrat në darkë, përpiket të mendojë, të flasë dhe të veprojë i orientuar sipas busullës së Kur'anit. Allahu na tregon në Libër se ky përkushtim e sundon gjithë jetën e besimtarit.


Thuaj: "Falja ime dhe kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e gjithë botërave." (Sure En'am: 162)

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT


Por, disa njerëz mendojnë se feja është diçka që përbëhet nga disa rite në kohë të caktuara, se jeta është e ndarë në kohë për falje dhe kohë të tjera. Ata mendojnë për Allahun dhe jetën tjetër vetëm atëherë kur falen, agjërojnë, japin lëmoshë apo shkojnë në haxh në Mekë. Në kohë të tjera, ata janë të zhytur vetëm në jetën e kësaj bote. Jeta për ta është një luftë për mbijetesë. Njerëz të tillë janë thuajse plotësisht të ndarë nga Kur'ani dhe kanë qëllimet e tyre personale në jetë, ata kanë botëkuptimin e tyre përse i përket moralit, kanë një pikëpamje krejtësisht të tyre përse i përket botës dhe vlerave të saj. Ata as që e kanë idenë se çdo të thonë në të vërtetë vargjet e Kur'anit.

Një njeri që ndjek këshillat e Librit dhe Sunnetin e të Dërguarit të Allahut, (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), si udhërrëfyes të jetës së tij, sigurisht, që do t'i japë asaj formë krejt ndryshe nga dikush me një qasje sipërfaqësore në fe. Një njeri i tillë nuk harron kurrë se është i nënshtruar ndaj fatit që Allahu ka caktuar për të dhe do ta jetojë jetën e tij duke besuar dhe duke iu mbështetur Atij. Brenda kësaj fryme, ai e di se nuk ka përse të ndihet në ankth, i frikësuar, i shqetësuar, shpresëhumbur, i dëshpëruar, apo i mposhtur nga paniku në kohë vështirësish. Ai do të përballojë gjithçka që i kalon rrugës së jetës së tij. Çdo fjalë, vendim apo veprim i tij tregon se ai e jeton jetën sipas Sunnetit, i cili është zbatimi në praktikë i Fjalës së Allahut. S'ka rëndësi se me se është i zënë, qoftë kur del shëtitje, kur ha ushqim, kur shkon në shkollë, kur studion, kur punon, kur merret me sport, kur bisedon me dikë, kur sheh televizor apo kur dëgjon muzikë, ai është i vetëdijshëm se ka përgjegjësi për jetën e tij dhe e jeton atë duke e kënaqur Allahun. Ai tregon kujdes të madh për çështjet që i janë besuar dhe në të njëjtën kohë është i preokupuar për të fituar kënaqësinë e Allahut në gjithçka që kryen. Ai kurrë nuk sillet në atë mënyrë që bie ndesh me këshillat e Kur'anit apo që kundërshton Sunnetin.

Harun Jahja (Adnan Oktar)



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



Harun Jahja (Adnan Oktar)

Të jetosh sipas vlerave të Islamit është e mundur vetëm duke zbatuar urdhërat dhe këshillat e parashtruara në Kur'an për çdo aspekt të jetës. Kjo, dhe praktika e Sunnetit është mënyra e vetme që njerëzit mund të arrijnë sukses dhe lumturi në këtë botë dhe në tjetrën. Zoti ynë na tregon në Kur'an se njeriu mund të bëjë një jetë të mirë vetëm duke kryer vepra të mira:

Çdokush që bën vepër të mirë, mashkull apo femër qoftë, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim jetë të mirë dhe do t'i kompensojmë me më të mirën e asaj që vepruan.

(Sure Nahl: 97)

Me lejen e Allahut, të jetuarit sipas mësimave të Kur'anit dhe Sunnetit u mundëson njerëzve të zhvillojnë një horizont të gjerë të kuptuarit, u jep atyre një mençuri të lartë, aftësinë për të dalluar të mirën nga e keqja si dhe aftësinë për ta trajtuar një çështje në thellësi. Këto cilësi do t'i mundësojnë njeriut që i ka ato, të jetojë çdo moment të jetës së tij në lehtësi, e cila buron nga këto përparësi. Një njeri që jeton në bindje ndaj Allahut dhe përjetëson Fjalën e Tij do të jetë krejtësisht i ndryshëm nga njerëzit e tjerë në mënyrën se si sillet, ulet dhe ecën, në botëkuptimin e tij, në mënyrën si i shpjegon dhe interpreton gjërat dhe në zgjidhjet që gjen për problemet me të cilat përballet.

Ky libër do të shpjegojë veprat që kryen dhe ngjarjet me të cilat përballet çdo ditë të jetës Muslimani, i cili jeton sipas këshillave të Kur'anit. Libri, në shtjellimin e tij do të na tregojë se si duhet të sillet Muslimani ndaj ngjarjeve dhe situatave të përditshme. Qëllimi i tij është i dyfishtë: të na njohë me idenë e jetës së lumtur që vjen vetëm nëse jetësohen vargjet e Kur'anit dhe t'i ftojë të gjithë njerëzit në këtë jetë të vrytytshme të ofruar nga mësimet e tij. Është e sigurt se, vetëm Fjalët e Kur'anit mundësojnë që njeriu të jetojë çdo orë dhe çdo çast të jetës së tij në një ambient paqësor i cili i ngjan Parajsës, larg nga stresi, shqetësimi dhe ankthi që kanë ngulfatur këtë botë.

Kapitulli 1

24 ORË NË JETËN E MUSLIMANIT SIPAS MËSIMEVE TË KUR'ANIT

Zgjimi në mëngjes

Një nga ndryshimet thelbësore midis atyre që jetojnë sipas urdhërave të Kur'anit dhe njerëzve të tjerë, të cilët e refuzojnë Allahun është ky: mençuria që Allahu u jep atyre që përdorin ndërgjegjen dhe qëndrojnë të përlurur prej madhështisë së Allahut. (Për një shtjellim më të gjerë shih: *Mençuria e Vërtetë e Përshkruar në Kur'an, Harun Jahja*) Për shkak të mençurisë së tyre, besimtarët bëhen menjëherë të vetëdijshëm për shkaqet që fshihen prapa ngjarjeve, të cilat, pabesimtarët dhe ata të cilët janë të paaftë ta kuptojnë të vërtetën, i trajtojnë si të pakuptimta.

Që nga çasti që besimtari ngrihet në mëngjes, e di se në çdo përvojë që përjeton gjatë ditës ngërthen në vetvete një "shenjë", (siç i quan Allahu në Kur'an, ajet = shenjë). Fjala "shenjë" u vishet atyre ngjarjeve që janë prova të qarta të ekzistencës, njëshmërisë dhe cilësive të Allahut. Gjithashtu, ajo është fjala që përdoret për vargjet e Kur'anit. Një ide tjetër e ngjashme në kuptim është "faktet që të çojnë drejt besimit." Kjo mund të përkufizohet për ato fakte që e

sjellin një njeri drejt besimit dhe, në të njëjtën kohë, bëjnë që besimi tij të rritet, të zhvillohet dhe të forcohet. Por, vetëm ata që i kthehen singlerisht Allahut mund t'i njohin këto "shenja" dhe fakte që të shpien drejt besimit. Vargu i 190-të i Sures Ali Imran është një shembull për këtë:

Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e ditës dhe të natës, ka Shenja për njerëzit inteligjentë. (Sure Ali 'Imran: 190)

Për ata që kanë besim dhe jetojnë duke ndjekur këshillat e Kur'anit, çdo ditë e re është plot me prova të ekzistencës së Allahut dhe fakte që të orientojnë drejt besimit. Për shembull, hapja e syve dhe fillimi i ditës është një nga mirësitë që Allahu i ka dhënë njerëzimit dhe një nga faktet mbi të cilat ne duhet të mendojmë pak më thellë. Kjo, për faktin se njeriu është i pavetëdijshëm gjatë gjithë natës dhe gjithçka mund të mbajë mend janë disa



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



ëndrra të paqarta të cilat zgjasin veç 3-5 sekonda. Gjatë kësaj kohe, njeriu është në gjumë dhe nuk ka asnjë lidhje me këtë botë. Shpirti i tij dhe trupi ndahen nga njëri – tjetri dhe kjo kohë për të cilën njeriu mendon se e kalon në gjumë është në të vërtetë një lloj vdekjeje. Allahu na shpall në Kur'an se shpirtrat e njerëzve merren gjatë kohës që ata janë në gjumë.

Allahu ua merr shpirtrat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj, Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar. . . (Sure Zumer: 42)

Ai ua merr shpirtrat (ju vë në gjumë) natën duke e ditur ç'keni punuar ditën, pastaj ju zgjon që të plotësoni kohën tuaj të caktuar për të jetuar. (Sure En'am: 60)

Në këto vargje, Allahu thotë se shpirtrat e njerëzve merren gjatë gjumit, por kthehen përsëri deri sa të vijë ora e përcaktuar e vdekjes. Kur ndodhet në gjumë, njeriu e humb pjesërisht ndërgjegjjen për botën e jashtme. Të zgjohesh nga "vdekja" e gjumit dhe të bëhesh i vetëdijshëm dhe kështu me rradhë sot si dje, dhe të jesh i aftë të shohësh, të dëgjosh dhe të ndihesh përsosmërisht mirë është një mrekulli për të cilën duhet të mendojmë thellë. Një njeri që shkon për të fjetur në mbrëmje nuk ka se si të jetë i sigurt që këto bekime të pakrahasueshme do t'i jepen sërish në mëngjes. Dhe nuk mund të jemi të sigurt nëse do të hasim ndonjë fatkeqësi apo do të ngrihemi të shëndetshëm.




Harun Jahja (Adnan Oktar)



Besimtari kur e nis ditën, mendon për këto fakte dhe falenderon Allahun që e ka mbuluar atë me mëshirën dhe mbrojtjen e Tij. Ai e sheh ditën si një mundësi të dhënë nga Allahu për të fituar kënaqësinë e Tij dhe Parajsën. Sapo hap sytë herët në agim, ai i drejton mendimet e tij tek Allahu dhe e fillon ditën me një falje të singertë, faljen e agimit.

Gjatë ditës, ai vepron dhe sillet duke patur parasysh se Allahu gjithmonë e vështron dhe e dëgjon dhe është i kujdesshëm për të fituar kënaqësinë e Tij duke iu bindur urdhërave dhe këshillave të Tij. Ai tashmë ka vendosur një lidhje të fortë me Allahun dhe e ka filluar ditën me faljen e agimit. Në këtë mënyrë, ka pak të ngjarë që të harrojë të fitojë kënaqësinë e Allahut gjatë ditës apo të mos i'u bindet urdhrave të Tij. Ai do të sillet gjatë ditës duke patur parasysh faktin që Allahu e ka vënë në provë në jetën e kësaj bote.



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



Çdokush që i drejton sinqerisht mendimet e tij drejt Allahut do të ndihmohet të vërejë me kujdes mirësitë që i janë dhuruar dhe se, askush tjetër veç Allahut nuk ka fuqi t'ia japë. Në Kur'an, Zoti ynë thotë se njerëzit duhet të mendojnë mbi këto çështje:

Thuaj: "Si mendoni? Nëse Allahu do t'ua merrte të dëgjuarit dhe të parit dhe do të vuloste zemrat tuaja, cili zot përveç Allahut do t'ua kthente sërish ato?" (Sure En'am: 46)

Sigurisht që është Allahu i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur, Ai, i cili e bën gjumin kohë pushimi për njerëzit dhe ua kthen atyre sërish mirësitë në mëngjes. Ata që e dinë këtë fakt, e ndiejnë afërsinë e Allahut që nga momenti që fillojnë ditën dhe janë të kënaqur me mirësitë e pakrahasueshme që gëzojnë.

Ata që nuk e ndjekin fenë dhe refuzojnë të mendojnë mbi këtë realitet nuk mund të jenë krejtësisht të vetëdijshëm për mirësitë që bartin dhe nuk mund ta njohin dhe provojnë gëzimin që përjetojnë besimtarët. Përgjithësisht, për ta është shumë e vështirë të ngrihesh nga një shtrat i ngrohtë ndaj ndihen të shqetësuar që do t'iu duhet të përballen me ditën e re që po lind. Disa janë në ankth dhe të mërzhitur për shkak të rutinës së përditshme. Nuk duan të ngrihen nga shtrati; në mendjet e tyre bëhet luftë, të ngrihen apo të flenë edhe një minutë më tepër. Një dështim moral i hasur shpesh tek këta njerëz është se, kur ngrihen janë të inatosur, të shqetësuar dhe të ngrysur.

Ata që nuk e besojnë Allahun nuk mund të shijojnë kënaqësinë e mirësive të Tij. Qysh nga momenti kur ngrihen në mëngjes ata i rikthehen monotonisë duke bërë çdo ditë të njëjtat gjëra.



Ndërsa, një lloj tjetër njerëzish, që nuk janë të vetëdijshëm se dita e re mund të jetë mundësia e fundit që u ka falur Allahu, përgatiten vrulltazi për të nisur ditën, për të fituar më shumë para, për t'iu mburrur të tjerëve me pasurinë apo paraqitjen e tyre, për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve dhe për të qenë të pëlqyer nga ta.

Ata që i anashkalojnë shenjat që ka shpallur Allahu në Kur'an, mund ta nisin ditën në mënyra nga më të ndryshmet, por, mes tyre shihet një mungesë e përgjithshme mençurie që përkapet në mënyrën si sillen: atyre nuk u bie ndër mend se është Allahu, Ai që i ka krijuar, se kanë përgjegjësi për t'iu bindur Atij dhe për të fituar kënaqësinë e Tij dhe as mendojnë se dita e re që u rri në prag mund të jetë mundësia e fundit në përmbushjen e detyrës që kanë përpara Allahut.

Allahu na tregon për gjendjen e tyre me këto fjalë:

Po u afrohet njerëzve dita për të dhënë llogari, por ata vazhdojnë të jenë të shkujdesur e të shmangur (nga e vërteta).

(Sure Enbija: 1)

Është e qartë se, ata që jetojnë të zhytur në këtë humbje janë duke bërë një gabim të madh. Njeriu nuk duhet të harrojë se, çdo mëngjes mund të jetë fillimi i ditës së fundit të caktuar për të në jetën e kësaj bote. Vdekja mund të vijë në çdo çast, për shkak të një aksidenti me makinë, një sëmundjeje të paparashikueshme apo nga çfarëdolloj shkakut tjetër.

Për këtë arsye, ne duhet t'i japim kuptim ditës së re duke e çmuar si një mundësi më shumë për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Pastrimi



Për ndryshimet që ndodhin në trupin tuaj kur ngriheni në mëngjes, ka disa arsye. Fytyrat tuaja janë paksa të enjtura, flokët janë të pakrehura, trupi ka një aromë të pakëndshme dhe goja ka një shije të padëshirueshme. Fytyra e enjtur që shihni në pasqyrë dhe pamja e parregullt dëshmojnë varësinë tuaj. Çdo njeri duhet të lajë fytyrën në mëngjes, të lajë dhëmbët dhe të pastrohet. Ky fakt e përkujton atë që është i

lidhur me mësimet e Kur'anit se ai nuk është aspak ndryshe nga njerëzit e tjerë dhe se, vetëm Allahu është Ai që nuk ka asnjë të metë.

Për më tepër, kur dikush, që i kthehet Allahut singërisht, shihet në pasqyrë dhe nuk ndihet mirë me atë që sheh, e kupton më mirë se kushdo se nuk ka në dorë asgjë nga bukuria e tij sado ta dëshirojë atë.

Siç shihet, Allahu ka krijuar tek robërit e Tij disa të meta në mënyrë që t'i përkujtojë për varësinë e tyre ndaj Tij. Fakti që



trupi dhe ambienti bëhen pis me kalimin e kohës është një shembull që e dëshmon këtë. Por, Allahu ua ka treguar njerëzve se si mund t'i shmangin ato dhe ka bërë të mundur mirësi të tilla si sapuni dhe detergjentët në mënyrë që ne t'i përdorim. Ai na e tregon këtë në Kur'an:

Vërtet pas vështirësisë vjen lehtësia; Vërtet pas vështirësisë vjen lehtësia. (Sure Inshirah: 5-6)

Harun Jalila (Adnan Oktar)

Por, aftësia për të dalluar këtë sekret të krijimit, të mirësive dhe për të falenderuar Allahun u përket vetëm besimtarëve të pajisur me mençuri.

Kur besimtari pastrohet në mëngjes apo gjatë ditës, e falenderon Allahun që i ka vënë në përdorim të gjitha gjërat për ta kryer këtë. Ai e di se Allahu e do pastërtinë dhe ata që janë të pastër; ndaj e sheh pastrimin si një vepër adhurimi dhe për këtë shpreson të fitojë shpërblimin e Allahut. Ai i bindet me zell asaj që ka urdhëruar Allahu në vargjet 4 dhe 5 të Sures Muddeththir:

Petkat e tua pastroji dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve). (Sure Muddeththir: 4-5)

Në vargun e
m ë p o s h t ë m
të shpallur me rastin
e betejës së Bedrit,
Allahu thotë se Ai
dërgon ujë nga qielli
për njerëzit në
mënyrë që ata të
pastrohen dhe të
plotësojnë nevojat e
tyre.



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Ai bëri që ju të koteni në gjumë të lehtë si shenjë sigurie nga ana e Tij dhe lëshoi nga qielli shi, për t'ju pastruar nëpërmjet tij, për të larguar nga ju ndyrësinë e djallit dhe për t'i forcuar zemrat tuaja dhe këmbët. (Sure Enfal: 11)

Uji është elementi bazë për njerëzit për pastrimin e trupit, të ambientit dhe të shtëpisë. Përveç se pastron papastërtinë e dukshme dhe ndotjen bakteriale të padukshme, uji ka gjithashtu vetinë për të na shlodhur. Kur uji rrjedh nëpër trup shpërndan energjinë elektrike statike, e cila i bën njerëzit të ndihen të lodhur dhe të plogësht. Ne nuk mund ta shohim elektricitetin statik të prodhuar në trupin tonë, por, ai ndonjëherë vihet re kur zhveshim pulovrat dhe ndjejmë një farë korrenti dhe një kërcitje të lehtë, kur prekim diçka apo mund të vihet re nga lëvizjet e flokëve. Kur lahem, ne largojmë gjithë këtë grumbullim të elektricitetit statik dhe trupi ynë ndihet i lehtë dhe i shlodhur. Edhe freskia e ajrit pas shiut vjen gjithashtu nga fakti se uji i tij ka pastruar ajrin nga elektriciteti statik.

Allahu kënaqet me njerëzit që qëndrojnë të pastër dhe të rregullt. Kjo mund të shihet në disa vargje në Kur'an që bëjnë fjalë për pastërtinë fizike të njerëzve në Parajsë.

Allahu thotë se: **"Atje ka të rinj si perla të fshehura."** (Sure Tur: 24), dhe në vargjet e tjera Allahu thotë se atje ka **"gra të pastra"** për njerëzit në Parajsë. (Sure Bekare: 25; Sure Ali Imran: 15; Sure Nisa: 57)



Harun Jalila (Adnan Oktar)

Disa njerëz i kushtojnë vëmendje pastrimit të tyre vetëm kur ndodhen në praninë e të tjerëve apo kur duan të ndihen të pëlqyer; ata nuk kujdesen për pastërtinë e tyre kur janë vetëm. Ta shohësh normale sorollatjen nëpër shtëpi deri në mbrëmje me fytyrë të palarë, me një erë të pakëndshme në



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



gojë, i papastër, me shtratin ende të parregulluar dhe dhomën rrëmujë, buron nga një arsyetim i gabuar.

Sidoqoftë, Allahu i nxit Muslimanët të mbajnë një ambient të mirë dhe të pastër për veten e tyre dhe urdhëron çdokënd që të mbajë pastërti në gjithçka, që nga ushqimi dhe veshja deri tek vendi ku jetojnë.

O ju njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë... (Sure Bekare: 168)

Të pyesin ty se ç'është e lejueshme që të hanë. Thuaju: "Ju lejohet juve çdo gjë që është e dëlirë." (Sure Maide: 4)

(Profeti) i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon nga ato të pakëndshmet " (Sure A'raf: 157)



Kujtoni kur e bëmë Qaben vendgrumbullimi dhe sigurie për njerëzit duke thënë "Bëjeni vendin e Ibrahimit si vend-faljeje!" Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: "Pastrojeni Shtëpinë Time për ata që rrethrotullohen rreth saj, për ata që qëndrojnë aty dhe për ata që falen aty duke u përkulur dhe përlurur." (Sure Bekare: 125)

Kështu pra, Ne i zgjuam që të pyesin njëri-tjetrin. Njëri nga ata tha: "Sa keni ndenjur (në gjumë?)" –U përgjigjën: "Kemi qëndruar një ditë a një pjesë të ditës." Disa thanë: "Zoti juaj e di më së miri se sa keni ndenjur. Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi dhe le të shikojë se cili ushqim është më i pastër dhe t'ua sjellë juve për të ngrënë." (Sure Kehf: 19)


Butësi prej Nesh dhe dëlirësi. Ai (Jahja) ishte besimtar i përkushtuar dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm. (Sure Merjem: 13-14)

Stili i jetës së njerëzve të paditur i bën ata që të krijojnë me duart e tyre një ambient të pashëndetshëm dhe të parehatshëm, ndërsa Muslimanët që

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

përmbushin mësimet e Kur'anit bëjnë një jetë të mirë në këtë botë. Njerëzit e paditur mbajnë ambiente që janë shqetësuese edhe për veten e tyre, por edhe për të tjerët përreth, ndërsa Muslimanët jetojnë në vende të shëndetshme dhe frymëzuese ku secili mund të gjejë rehat dhe paqe shpirtërore.

Përmbledhtazi, themi se me mësimet e Kur'anit besimtarët janë të këshilluar ta mbajnë veten pastër jo sa për sy e faqe, por, sepse kështu dëshiron Allahu dhe sepse natyrshëm kjo është ajo që sjell më shumë rehat. Kur e pastrojnë vendin ku jetojnë, ata ndjejnë një kënaqësi të madhe, sepse krijohet një ambient ku ndihen mirë; për besimtarët mbajtja e pastërtisë nuk mbetet çështje zgjedhjeje – ata bashkëjetojnë me vetëdijen e pastërtisë.



Harun Jahje (Adnan Oktar)



Veshja

Kur një besimtar vendos se çfarë rrobash duhet të veshë gjatë ditës dhe vishet, është i vetëdijshëm për një të vërtetë të rëndësishme: veshjet janë një nga mirësitë e panumërueshme të Allahut dhe se ka një arsye thelbësore për ekzistencën e tyre. Çdokush mund të përfitojë nga kjo mirësi, por, vetëm muslimani që zbaton këshillat e Kur'anit mendon se veshja e bukur është mëshirë prej Allahut dhe e falenderon Atë për të.

Veshja e përkujton besimtarin se gjallesat janë burim i leshit, pambukut dhe mëndafshit. Artikujt e veshjes që përdorim thuhajse çdo moment të jetës sonë, përftohen nga bimët dhe kafshët, të cilët

janë një mrekulli e krijimit.

Me fjalë të tjera, nëse Allahu nuk do të kishte krijuar disa gjallesa me aftësinë për t'i furnizuar njerëzit me lëndë të para për prodhimin e veshjeve, nga ato më të domosdoshmet e deri tek ato luksozet, këto veshje nuk do të ekzistonin.



Hernu Jalija (Adnan Oktar)

Megjithëse disa njerëz e dinë këtë, përsëri nuk e vënë re dhe nuk e vlerësojnë mirësinë që kanë në dorë, sepse atyre u është kthyer veshja në një zakon që prej momentit kur kanë lindur. Ky zakon i pengon ata të kuptojnë se ky është një bekim dhe, rrjedhimisht, i pengon të jenë falenderues. Një nga arsyet pse Allahu krijoi mirësi të panumërta në këtë botë është që ne ta falenderojmë Atë. Le të shohim bashkë arsyet pse Allahu e krijoi veshjen për ne, duke filluar që nga dobitë që kemi prej tyre.

Veshja shërben si një mburojë që e mbron trupin nga të ftohtët, nga rrezet e dëmshme të diellit dhe nga rreziqet më të vogla si prerjet dhe dëmtimet që mund të vijnë nga ambienti që na rrethon. Nëse nuk do të kishim veshje, lëkura e hollë që rrethon trupin do të dëmtohej nga këto ngacmime. Ato janë të dhimshme, kërcënim për shëndetin dhe lëkura do të merrte një



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

pamje me të vërtetë të shëmtuar.

Zoti ynë na shpall në Kur'an edhe një arsye tjetër të krijimit të veshjeve mbrojtëse:

O ju bijtë e Ademit! Ne ju kemi zbritur veshje për të mbuluar pjesët tuaja intime dhe petk zbukurues. (Sure A'raf: 26)

Ashtu siç na tregon edhe ky varg, veshja u jep njerëzve një pamje shumë më të mirë estetike.

Është e qartë se ajo është një nevojë jetike dhe një mirësi tejet e rëndësishme që Allahu ka krijuar dhe na i ka vënë në përdorim. Besimtari që është i vetëdijshëm për këtë tregohet shumë i kujdesshëm dhe i matur në përdorimin e rrobave, dhe kjo shfaq mirënjohjen e tij ndaj Allahut për mirësinë që i është dhuruar.

Një cilësi tjetër që i është falur besimtarit nga vlerat e Kur'anit është maturia në shpenzimin e parave dhe kjo gjen vend edhe



Harru Jalija (Adnan Oktar)



tek harxhimi për rrobat që vesh. Ai blen ato artikuj që ka nevojë, që i shkojnë dhe janë të arsyeshme. Ai nuk hedh para të tepërta në shpenzime të panevojshme. Vargu që vjen më poshtë e tregon qartë këtë fakt:

Edhe ata që, kur shpenzojnë nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes. (Sure Furkan: 67)

Por, kujdesi me të cilin vishet një person që jeton me vargjet e Kur'anit, nuk mbaron këtu. Për shembull, përveç se duhet të përdorë veshje të pastra, besimtari që ka ndjeshmëri mbi vlerat, do të kujdeset të vishet duke iu përshtatur sa më mirë çdo rasti. Ashtu siç tregon edhe Kur'ani, veshja është një kënaqësi për syrin. (Sure A'raf: 26). Ka mjaft shembuj se si vishej Profeti ynë, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, dhe këshillat e tij në lidhje me këtë çështje në hadithet që janë transmetuar deri tek ne:



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

"Hani çfarë të doni dhe pini çfarë të doni, me kusht që të mos kenë dy gjëra: ekstravagancën dhe lavdinë." (Meulana Muhamed Mensur Nu'mani, Ma'ariful Hadith)

Ja tek është një hadith tjetër, i cili na mëson se si vishej Profeti, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të:

Sa herë që vinte një delegacion për të takuar të Dërguarin e Allahut, ai vishte rrobat e tij më të mira dhe i urdhëronte edhe sahabët të vepronin po kështu." (Tabakat Hadith, Volumi 4, Numër 346)

Kur ndonjëri nga sahabët nuk i kushtonte rëndësi pamjes së jashtme dhe dukej i çrregullt, Profeti ynë, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, e këshillonte atë menjëherë. Tek ne ka erdhur edhe një shembull për këtë:

"I Dërguari i Allahut ishte në xhami, kur hyri një njeri me flokë të pakrehura dhe mjekër të shpupuritur. Profeti (s.a.v.s.) ia vuri në dukje këtë dhe ai u largua, u rregullua dhe erdhi sërish. Atëherë Profeti (s.a.v.s.) tha: "A nuk është më mirë kështu se sa të vijë ndonjëri nga ju me flokë të pakrehura?" (Muuatta, Imam Malik, Volumi 2, Numër 949)



Herru Jahja (Adnan Oktar)

Në Kur'an, Allahu thotë se rrobat dhe zbukurimet do të jenë nga mirësitë më të mëdha të Parajsës. Disa nga ato janë përmendur në vargjet në vazhdim:

E, ata që besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu i vendos në kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj, aty stolisen me rrathë të artë e me xhevahirë e petkat e tyre janë të mëndafshta. (Sure Haxh: 23)

Veshin petka nga mëndafshi e kadifeja ulur ballë për ballë. (Sure Duhan: 53)

Kanë të veshura petka mëndafshi të hollë e të gjelbër dhe mëndafsh të trashë, janë të stolisur me byzylykë të argjendtë... (Sure Insan: 21)

Në këto vargje, Zoti ynë flet për petka të mëndafshta dhe zbukurime prej ari, argjendi dhe perla. Bizhuteritë që kemi ne në këtë botë janë të ngjashme me ato të Parajsës dhe kur besimtari i sheh ato, qofshin të tijat ose jo, mediton mbi Parajsën dhe i shtohet edhe më tepër dëshira për të shkuar atje. Besimtari e sheh qëllimin e krijimit të këtyre gjërave dhe e kupton se të gjitha mirësitë e kësaj bote janë kalimtare. Të vetmet mirësi të vërteta janë ato që do të zgjasin përjetësisht në Botën Tjetër.



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që Ne nuk do t'ua humbim shpërblimin punëmirëve. Pikërisht atyre u përket Xhenneti i Adnit, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen atje me byzylykë të artë dhe do të vishen me rroba të gjelbërta prej mëndafshi të hollë e të trashë, duke ndenjur të mbështetur në shtretër në shtretër të lartë. Sa shpërblim i mrekullueshëm dhe sa vendbanim i bukur! (Sure Kehf: 30-31)



Herru Jahija (Adnan Oktar)

Një nga gjërat që duhet të ketë parasysh një njeri që ndjek dritën e Kur'anit dhe të Sunnetit, përsa i përket veshjes është se, pamja e jashtme është shumë e rëndësishme në vendosjen e marrëdhënieve me të tjerët. Për këtë arsye, besimtari duhet t'i kushtojë asaj kujdes të madh kur fton njerëz në pranimin e Islamit. Ai do të përpiqet të veshë rroba të pastra, të thjeshta dhe që i përshtaten. Kjo tregon vëmendjen e tij për të zbatuar urdhërat e Allahut dhe për të respektuar njerëzit e tjerë.

Vetëm ata të cilët udhëzohen nga Fjala e Allahut, janë të ndjeshëm ndaj gjendjes së brendshme të dikujt, të cilit i tregojnë për shpëtimin e përjetshëm, po aq edhe të përgjegjshëm, duke u kujdesur imët edhe për atë që kanë veshur.

Si përfundim, mund të themi se, një njeri i cili merr si shembull Profetin tonë, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, del gjithmonë i pastër, i rregullt dhe me rroba të mira. Ai apo ajo ndjen kënaqësi nga kjo dhe shpreson të fitojë shpërblimin e Allahut prej saj.



Ngrënia e mëngjesit

Çdo besimtar, të cilit Allahu i ka dhënë aftësinë për të menduar dhe për të kuptuar, kur shkon në kuzhinë për të ngrënë mëngjes, e di se të gjitha mirësitë në ushqime dhe pije janë shenja që të çojnë drejt besimit.

Për shembull, zjarri që përdor për të gatuar mund t'i shkaktojë shumë dëm atij, po ashtu edhe sendeve të tjera sepse ai ka aftësinë për të shkatërruar. Por, nxehtësia është një domosdoshmëri për ta bërë ushqimin të ngrënshëm dhe nga kjo pikëpamje është një mirësi e madhe. Me fjalë të tjera, si çdo gjë në tokë edhe zjarri është vendosur në shërbim të njeriut. Në Kur'an, Allahu thotë:

Dhe për ju nënshtroi gjithçka ka në qiej dhe në tokë. (Sure Xhathije: 13)

Përveç kësaj, zjarri në këtë botë, është një përkujtues për



besimtarin, i cili i sjell ndër mend vuajtjet në Ferr. Kur përshkruan në Kur'an ata që do të shkojnë në të, Allahu na përkujton për një zjarr të fortë. Në disa vargje, Ai jep tablonë e dhimbjeve në zjarrin e krijuar për ata që e mohojnë Atë.

Atë Ditë ata do të përcëllohen në Zjarr. (Sure Dharijat: 13)

Zjarri do t'ua djegë fytyrat dhe buzët (aq sa do t'u duken dhëmbët). (Sure Mu'minun: 104)

Kush nuk beson në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, le ta dijë se Ne për mohuesit kemi përgatitur një Zjarr flakërues. (Sure Fet'h: 13)

Kur sjellin ndër mend besimtarët me besim të fortë për këtë Zjarr të tërbuar të Ferrit, iu rritet frika ndaj Allahut, i luten Atij dhe kërkojnë mbrojtje me ndihmën e Tij. Në këtë mënyrë, edhe gjërat e parëndësishme të përditshme shërbejnë si përkujtues për gjëra të tjera më të mëdha dhe kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e praktikës së besimtarit.

Një njeri, i cili mendon singërisht dhe pa paragjykim



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



për ushqimin që ha, do të gjejë shumë përkujtues në të. Shija dhe aroma e bukës, mjaltit, djathit, domateve, çajit, apo lëngut të frutave, vlera e tyre ushqyese dhe ngjyrat e tyre të bukura dhe të shumëllojshme janë të gjitha mirësi prej Allahut. Ato na ushqejnë me proteina, aminoacide, karbohidrate, yndyrna, minerale dhe lëngje, për të cilat ka aq shumë nevojë trupi ynë. Për të bërë një jetë të shëndetshme, ne duhet të ushqehemi rregullisht dhe në mënyrën e duhur, por, kjo nuk është një punë e vështirë për ne; është diçka që ne e bëjmë me kënaqësi. Frutat, perimet, drithërat dhe brumërat plotësojnë të gjitha nevojat e njeriut për ushqim dhe, po ashtu, i japin atij shumë kënaqësi.

Gjithçka kemi përmendur deri këtu, janë me të vërtetë sende të vogla që çdokush i njuh mirë dhe jeton me to përgjatë 24 orëve, qysh se ka lindur.



Harun Jahje (Adnan Oktar)

Megjithatë, shumica e njerëzve nuk i marrin parasysh siç duhet ato që Zoti ynë na ka dhënë për përdorim të përditshëm. Ata i marrin ato si të mirëqëna dhe nuk e kuptojnë se sa të vlefshme janë ato.

Gjithë këto ushqime dhe pije të shijshme kanë vetinë për t'i dhënë shumë dobi trupit tonë dhe secila nga këto është një mrekulli e krijimit. Për shembull, një bletë që peshon vetëm disa gram, prodhon mjaltë. Për vitaminat dhe mineralet që përmban dhe cilësitë e përbërjes, mjetë do të thotë shëndet dhe shërim për njerëzit. Në Kur'an, Allahu thotë se Ai e ka frymëzuar këtë cilësi të mjaltit dhe punën e bletës:

Zoti yt e frymëzoi bletën, (duke thënë): "Ndërto shtëpi në male dhe në drurë dhe në atë (kosheret) që kanë ngritur njerëzit! Ushqehu me gjithfarë lloje frutash dhe ec rrugës së



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



Zotit tënd përulshëm!" Nga barku i tyre del lëng, ngjyrash të ndryshme, në të cilin ka ilaç e shërim për njerëzit. Vërtet që kjo është shenjë për ata që përsiatin. (Sure Nahl: 68-69)

Besimtari, i cili vëren prodhimin e mjaltit, bëhet i vetëdijshëm për mrekullinë e krijimit që ai përmban. Ai përkujton se as lulëzmi i frutave të pemëve, që është materiali bazë për prodhimin e mjaltit, nektari i të cilit kthehet në mjaltë, dhe as vetë mjalti i mrekullueshëm nuk mund të prodhohen rastësisht. Të kuptuarit e gjithë kësaj e afron atë edhe më tepër me Allahun.





Po ashtu, edhe bindja absolute e një blete të vogël ndaj Zotit tonë është edhe një e vërtetë tjetër që të orienton drejt besimit. Besimtari e kupton se, vetëm nëpërmjet frymëzimit të Allahut, bleta, e cila nuk ka as zgjuarsi dhe as vetëdije, në mënyrën që ne i kuptojmë ato, punon pa pushim dhe me një disiplinë të përsosur për të përmbushur detyrat e saj të mrekullueshme.

Rëndësia e mishit, qumështit, djathit, dhe produkteve të tjera që vijnë nga kafshët si mirësi prej Allahut për njerëzimin, përmendet në Kur'an:

Vërtet edhe te bagëtitë për ju ka shenja (për të medituar): Ju pini atë që gjendet në barkun e tyre, hani mishin e tyre e nxirrni shumë dobi të tjera. (Sure Muminun: 21)

Në Kur'an përmendet: "me lëng prej barkut të tyre", dhe Allahu na mëson për të mirat që kemi nga kafshët. Për shembull, ka diçka që mbetet në sistemin tretës, nga ushqimi që ka ngrënë një lopë, nga uji që ka pirë, gjaku që qarkullon nëpër venat e saj dhe organet e saj të brendshme. Është me të vërtetë një mrekulli që një

përzierje si qumështi, me aromë të këndshme, i pastër e i bardhë, i cili është aq i dobishëm për shëndetin, vjen nga një përzierje e tillë. Përveç kësaj, ai prodhohet në kushtet më higjienike, përkundër faktit që



24 OKË NGA JETA E MUSLIMANIT



ndodhet në një zonë që përmban material që duhet nxjerrë jashtë.

Një tregues tjetër i dijes së pafund të Allahut është fakti se, materiali bazë që prodhon qumështin është bari i gjelbër. Po kafshët që prodhojnë qumësht, nga një lëndë e gjelbër dhe e ashpër, krijojnë një lëng të bardhë, falë një sistemi të mrekullueshëm që Allahu ka krijuar në trupin e tyre. Në Kur'an, Allahu na tregon se nga se përbëhet qumështi:

Në fakt, edhe te bagëtitë ju kenë shenja për të mësuar prej tyre. Ne ju japim atë që kanë në barkun e tyre prej ushqimit të përpunuar dhe gjakut: qumësht të pastër dhe të shijshëm për ata që e pinë. (Sure Nahl: 66)

Siç e dimë, qumështi është një ushqim shumë i pasur, i cili përmban disa lëndë për të cilat ka nevojë trupi ynë; ai është një lëng që luan një rol shumë të rëndësishëm edhe në ushqyerjen e fëmijëve dhe të të rriturve.

Një ushqim tjetër që vjen nga kafshët, i vogël në vetvete, por me një vlerë të madhe



ushqyese është veza. Ndërtimi i kësaj magazine proteinash, vitaminash dhe mineralesh është një mrekulli tjetër. Pula prodhon vezë çdo ditë pa vetëdijen më të vogël dhe i mbron ato me një mbështjellëse të habitshme. Të mendosh se si krijohet aq mrekullisht një lëvozhgë veze përreth lëngut që ka brenda, apo si është futur lëngu brenda, ndonëse nuk ka asnjë mbështjellëse, e rrit habinë që ndjen besimtari për mjeshtërinë krijuese të Allahut.

Pije të ndryshme, të cilat merren të mirëqëna nga disa njerëz, duke i parë ato të domosdoshme për mëngjes, vijnë nga bimët.



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



Pasi gjethet e pemëve u janë nënshtruar disa proceseve, bëhen lëngje të ëmbla dhe me aromë të këndshme. Gjithashtu mijëra lloje bimësh të tjera që i rrit e njëjta tokë, shfaqin fuqinë e pamatë, diturinë e lartë dhe mëshirën e Allahut i cili i krijoi ato. Ashtu siç thotë Zoti ynë në Kur'an:

Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë, me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme." (Sure En'am: 141)

Allahu na ka falur mirësi të panumërta që i ka krijuar për t'i shijuar ne. Ai i sprovon njerëzit në jetën e kësaj bote me pasuri dhe varfëri, por, Ai kënaqet me ata të cilët shfaqin cilësi të shkëlqyera morale kur përballen me këto sprova. Ai thotë në Kur'an se këta lloj njerëzish do të shijojnë mirësi të pafundme në Parajsë. Për shembull, disa njerëz hanë një mëngjes të shijshëm dhe të pasur, ndërsa, disa të tjerë

Harun Jahja (Adnan Oktar)

hanë vetëm disa kafshata sa për të mbajtur frymën. Por besimtari, përtej pasurisë apo varfërisë, sillet gjithmonë në atë mënyrë që fiton kënaqësinë e Allahut dhe e falenderon Atë për çdo gjendje. Nëse është i pasur nuk lëvdohet dhe nuk bëhet kryelartë. Nëse është i varfër, nuk ndihet në ankth dhe as nuk i vjen keq për veten.

Besimtari është i vetëdijshëm se Allahu po e sprovon dhe se çdo gjë në këtë jetë është kalimtare. Në Kur'an, Ai thotë se do t'i sprovojë njerëzit me të mira dhe me të këqija. **"Ne ju sprovojmë me të mira dhe me të këqija dhe ju do të ktheheni tek Ne."** (Sure Enbija': 35)

Për këtë arsye, një person që ve në jetë fjalët e Kur'anit e di se shpërblimin e Allahut nuk do t'ia sjellin mirësitë që ka marrë, por

qëndrimi i tij ndaj këtyre

mirësive. Edhe pse nuk është i pasur, ai e falenderon singerisht Allahun. Në Kur'an, Ai thotë se do t'ua



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



shtojë mirësitë atyre që
falenderojnë duke qenë të
sinqertë dhe të durueshëm
dhe i paralajmëron
mosmirënjohësit se
dhimbjet e Ferrit janë të
tmerrshme:

(Kujtoje) kur Zoti juaj kumtoi: "Nëse
tregoheni mirënjohës, Unë do t'ua shtoj
edhe më shumë begatitë e Mia; por, nëse ju
mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i
rëndë. (Sure Ibrahim: 7)

Kur dikush mediton mbi provat e krijimit të përsosur rrotull
tij, po ashtu edhe arsyet e krijimit të ushqimit, do të shohë qëllimin
që fshihet prapa në ndërtimin dhe punën e gojës së krijuar për t'i
ngrënë këto gjëra me lehtësi. Që të hajë njeriu, duhet që: ushqimi,
buzët, dhëmbët, nofullat, gjendrat e pështymës, dhe miliona qeliza
të punojnë në një harmoni të përsosur. Dhe kjo është krijuar kaq
përsosmërisht sa, të tilla veprime mund të kryhen në të njëjtën kohë
në mënyrë harmonike, pa më të voglën pengesë. Dhëmbët e
përtypin ushqimin në pjesëza të vogla, ndërsa gjuha e

shtyn atë midis dhëmbëve për ta përtypur. Me muskujt e tyre të fortë, nofullat ndihmojnë dhëmbët për ta përtypur, në kohën që njeriu e lëviz gjuhën siç duhet. Buzët shërbejnë si një derë e mbyllur mirë për ta penguar ushqimin të bjerë nga goja.

Përveç kësaj, pjesët që i përbëjnë këto organe, punojnë së bashku në një harmoni të përkryer. Për shembull, sipas vendndodhjes dhe ndërtimit të tyre, e ndajnë ushqimin në copa dhe e bluajnë atë. Të gjithë dhëmbët janë vendosur me rregull nëpër vendet e tyre sipas detyrës që kanë; secili prej tyre rritet deri në një farë gjatësie me qëllim që të punojë në bashkëpunim me dhëmbin tjetër që ndodhet përballë tij. Sigurisht që, këto organe nuk kanë as vetëdije dhe as inteligjencë; ato nuk mund të vendosin bashkarisht në mënyrë që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Ky rregullim i shkëlqyer i përshkruar shkurtimisht më lart, nuk mund të ndodhë rastësisht. Çdo pjesë e tij është ndërtuar ashtu siç duhet për të përmbushur një qëllim të caktuar. Nuk ka dyshim se, ky

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

projektim i mrekullueshëm është krijuar nga Zoti ynë, i Cili **"krijoi gjithçka dhe e përcaktoi atë."** (Sure Furkan: 2). Allahu ka krijuar gjithë këto gjëra me qëllim që t'ua lehtësojë njerëzve ushqyerjen, dobinë dhe kënaqësinë që vjen prej saj.

Diçka tjetër e rëndësishme mbi të cilën mund të thellohet besimtari është se, ai mund të ndjejë aromën e ushqimeve në kuzhinë dhe e bën këtë pa ndonjë mundim. Kjo bëhet e mundur për shkak të aftësive të tij mrekullueshme. Shqisat e shijes dhe nuhatjes, të cilat nuk rreshtin së vepruari gjatë gjithë jetës, punojnë për mrekulli pa asnjë sforcim prej tij; ato nuk kanë bërë ndonjë stërvitje për të punuar në mënyrë kaq frytdhënëse dhe vetë ato nuk janë të vetëdijshme për punën e tyre.

Nëse njeriu nuk do ta kishte shqisën e të shijuarit, shijet e ndryshme të mishit, perimeve, supërave, sallatave, frutave, pijeve dhe reçelit nuk do të kishin kuptim për të. Veç kësaj, shija e këtyre ushqimeve nuk do të ishte e mirë; ato mund të ishin pa shije, të njëtrajtshme



Harun Jahja (Adnan Oktar)

dhe ngacmuese për stomakun. S'ka dyshim se, shijet dhe aftësia për t'i ndier ato janë krijuar posaçërisht për njerëzit. Do të ishte një gabim i madh të jemi indiferentë ndaj këtij fakti, për shkak të pakujdesisë apo pandjeshmërisë së fituar, si pasojë e zakonit.

Kur'ani na tregon se, Allahu krijoi ushqim të mirë dhe të pastër:

Allahu është Ai që ua bëri tokën vendbanim e qiellin kulm, ju ka dhënë formë e jua ka përsosur atë dhe ju ka furnizuar me ushqime të mira. Ja, ky është Allahu, Zoti juaj. Qoftë i lartësuar Allahu, Zot i botëve! (Sure Gafir: 64)

Sigurisht që, për njerëzit që mendojnë thellë, çdo lloj shije është një mënyrë për ta lartësuar Allahun ashtu siç e meriton, për ta përkujtuar Atë me mirënjohje, ta lavdërojmë dhe ta falenderojmë. Besimtari, i cili e di se të gjitha llojet e ushqimeve dhe pijeve vijnë nga Allahu, mendon për këtë sa herë që ulet në tavolinë për të ngrënë dhe e falenderon Zotin tonë. Ai thotë në Kur'an:



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Shenjë për ata është toka e vdekur; Ne e ringjallim atë dhe nga ajo nxjerrim drithëra, me të cilat ushqehen. Ne kemi krijuar në tokë kopshte hurmash dhe vreshta e kemi bërë të shpërthejnë në të burime uji, që ata t'i hanë frutat e tyre. Këto nuk i bënë duart e tyre; ndaj përse ata nuk duan të jenë mirënjohës? (Sure Ja Sin: 33-35)

Vallë, a nuk e shohin ata se, ndër gjërat që Duart Tona kanë krijuar për ta, janë bagëtitë që ata zotërojnë?! Ne bëmë që ato t'u nënshtohen atyre, kështu që disa i shalojnë e prej disave ushqehen, prej disave pinë dhe nxjerrin dobi të tjera. Vallë, si të mos falenderojnë! (Sure Ja Sin: 71-73)

Disa njerëz mendojnë se, nuk është e rëndësishme të reflektojnë mbi disa shenja shumë të rëndësishme, edhe pse hanë ushqime të shijshme dhe me aromë të këndshme dhe i



kanë plotësuar nevojat e tyre gjatë gjithë jetës. Ata nuk e marrin parasysh faktin se, Allahu i ka krijuar për ta këto mirësi të pakrahasueshme dhe se duhet ta falenderojnë Atë që i ka pajisur me to. Ky është një qëndrim i gabuar; ndaj, ata nuk duhet të harrojnë se do të pyeten në botën tjetër nëse kanë qenë falenderues ndaj Allahut apo jo.

Besimtari është i vetëdijshëm se Allahu ia ka dhënë trupin si një amanet dhe ai është përgjegjës për t'u kujdesur sa më mirë për këtë mirësi të madhe dhe për këtë ai duhet të ushqehet në një mënyrë të shëndetshme. Ai e di se për të kryer vepra të mira ai duhet të jetë i shëndetshëm, ndaj duhet të ushqehet me një dietë të balancuar. Ai e di se trupi duhet të marrë gjithë ushimin që ka nevojë për zhvillimin e 100 trilion qelizave në mënyrë që ato të rigjallërohen dhe të



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

punojnë ashtu siç duhet. Kështu që edhe për mëngjes ose në çdo kohë të ditës ai do të hajë ushqime natyrale dhe të shëndetshme dhe do të shmangë ushqimet e dëmshme, sado tërheqëse dhe të shijshme që mund të duken në pamjen e jashtme. Ai nuk është as dembel dhe as i pakujdesëm në këtë drejtim. Për shembull, ai e di se puna e organeve të trupit, aftësia që ka trupi i tij për t'u pastruar nga lëndët toksike dhe kapaciteti i tij për ta mposhtur ankthin dhe lodhjen, të gjitha këto varen nga uji (të cilin shumë njerëz e neglizhojnë ta pinë rregullisht) dhe ai do të jetë i kujdesshëm që të pijë një sasi të mjaftueshme gjatë ditës. Profeti, paqja

Harun Jahje (Adnan Oktar)

dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, në disa raste na tërheq vëmendjen për rëndësinë e ujit.

Për shembull, gjatë një udhëtimi ai u ul diku dhe kërkoi ujë nga ata që kishte pranë.

Pasi lau duart dhe fytyrën dhe piu pak prej tij, u tha sahabëve: Hidhni pak ujë në fytyrë dhe në kraharonin tuaj." (Sahihul-Buhari)

Profeti ynë paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë pasi piu ujë:

"Falenderimi i takon Allahut, i Cili e ka bërë atë të shijshëm dhe të ëmbël me madhështinë e Tij dhe nuk e ka bërë as të kripur as të hidhur."

(Ihja Ulumud-Din,
Imam Ghazali)




Në Rrugë

Njerëzit, të cilët kanë mbaruar mëngjesin janë bërë gati për të përballuar përgjegjësitë e ndryshme në vendet e tyre të punës, shkollat apo vende të tjera, para mbarimit të ditës. Allahu e përshkruan këtë situatë në Kur'an:

Vërtet ti gjatë ditës ke angazhim të gjatë (të madh). (Sure Muzzemmil: 7)

Ai ua bëri ditën për gjallërim. (Sure Furkan: 47)

Besimtari e sheh ditën që ka përpara, si një mundësi për të fituar dashurinë e Allahut, kënaqësinë e Tij dhe Parajsën, duke kryer vepra të mira. Pavarësisht se sa i zënë mund të jetë me punë, ai është i kujdesshëm për të



mos harruar të kënaqë Zotin e tij. Ai merr si shembull lutjen e Sulejmanit, ashtu siç përmendet në vargun e 19-të të Sures Neml, duke dëshiruar që Zoti i tij ta frymëzojë në veprat që do të kryejë gjatë ditës:


"Zoti im, Më mundëso që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano me mëshirën Tënde në gjirin e robërve të Tu të devotshëm. " (Sure Neml: 19)

Gjithkush që largohet nga shtëpia për në shkollë apo në punë ndesh shumë njerëz, objekte dhe ngjarje mbi të cilat mund të mendojë. Gjithçka që sheh një person ekziston në dijen e Allahut dhe ka ardhur



në ekzistencë me vullnetin e Tij dhe ndodh për një arsye të caktuar. Kështu, kur besimtari vështron qiellin duke patur parasysh këtë fakt në mendje, ai sheh se ata janë krijuar në mënyrë të mrekullueshme. Ai gjen të shpalosur para syve të vërtetën e vargut të shpallur: **"Ne e bëmë qiellin kulm të mbrojtur dhe të ruajtur."** (Sure Enbija: 32)

Funksioni i qiellit si një **"çati e mbrojtur"** vjen nga atmosfera e tij dhe kjo atmosferë rrethon globin dhe kryen funksionin e saj jetësor në mënyrë që të mbijetojnë njerëzit nën të. Atmosfera filtron rrezet që vijnë nga hapësira, të cilat janë të rrezikshme për gjallesat; ajo neutralizon meteorët e mëdhenj dhe të vegjël që i afrohen tokës dhe i pengon ata që të mos kërcënojnë botën





dhe krijesat në të. Gjithashtu, ajo e mbron tokën nga ngrica, afërsisht minus 270 Celcius e hapësirës. Edhe pse disa njerëz nuk e vlerësojnë këtë fakt si duhet, Allahu ka krijuar një ambient ideal për ne dhe na mbron nga kërcënimet që mund të vijnë nga qielli.

Në Kur'an, Allahu shpall se besimtari që vëren qiellin i kupton shpejt provat se ai është një krijim i përkryer dhe në harmoni.

Ai ka krijuar shtatë qiej njëri mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e Mëshiruesit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërisht vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur. (Sure Mulk: 3-4)

Allahu thotë në Kur'an se, për njerëzit që i studiojnë ata të mbushur me besim, në krijimin e qiejve dhe të tokës ka shenja.

A nuk e shohin ata qiellin që qëndron sipër tyre, si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar, pa pasur kurrfarë plasaritje në të? Ndërsa Tokën e kemi shtruar dhe në të kemi shpërndarë male të palëvizshme dhe kemi bërë, që nga ajo të mbijnë gjithfarëlloj bimësh të bukura, si mjet ndriçimi të mendjes dhe përkujtesë për çdo rob që i drejtohet Zotit të vet. (Sure Kaf: 6-8)

Muslimani që e kthen vështrimin e tij nga qielli në tokë do të shohë një provë tjetër të krijimit. Nën tokën mbi të cilën ecën me

Ai është Allahu, i Cili krijoi
natën dhe ditën, diellin
dhe hënën; e të gjitha këto
lundrojnë në gjithësi.

(Sure Enbija: 32)

Ai është që për ju ka krijuar çdo
gjë që ka në Tokë. Pastaj, i është
drejtuar qiellit dhe e ka rregulluar,
duke e bërë atë shtatë qiej.
Ai është i Dijshëm për çdo gjë.
(Sure Bekare: 29)

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



kaq siguri ndodhet një shtresë shkëmbinjsh të shkrirë, pabesueshmërisht të nxehtë, e quajtur "magma". Në krahasim me këtë, korja e tokës është shumë e hollë, çka do të thotë se ky shkëmb i shkrirë ndodhet pothuajse nën këmbët tona. Kështu, që trashësia e kores së tokës krahasuar me vetë tokën mund të përngjasohet me trashësinë e lëkurës së mollës, krahasuar me gjithë mollën. Një besimtar, i cili i merr parasysht këto çështje, do ta kuptojë edhe një herë se bota dhe gjithë qeniet e gjalla në të ekzistojnë për shkak të ekuilibrit të përsosur që Allahu ka vendosur me vullnetin e Tij dhe se çdo krijesë vazhdon të jetojë në siguri dhe mbrojtje në sajë të vullnetit të Allahut.

Besimtari, i cili sheh me syrin meditues do të verë re bukurinë që e rrethon dhe mrekkullitë e krijimit. Për shembull, zogjtë në qiell, frutat që dekorojnë vitrinën e një dyqani me ngjyrat e tyre tërheqëse, aroma e mirë që vjen nga pastiçeria, duan të thonë diçka për besimtarin, atë që njerëzit e tjerë nuk mund ta kapin: ato janë mirësi nga Allahu.

Besimtari, i cili thellohet gjithashtu mbi provat e panumërta dhe të ndryshme që has ndërsa është duke ecur në rrugë, do të jetë i kujdesshëm për mënyrën se si sillet. Për shembull, ai do të ecë pa e tepruar apo pa u lavdëruar ndaj njerëzve, sepse Allahu shpall në një varg në Kur'an: **"Bëju i matur në ecjen tënde..." (Lukman: 19)** Njeriu i përlurur i bindet urdhrat të Allahut dhe, si në çdo aktivitet



tjetër, ai mban një rrugë të mesme edhe në mënyrën se si ai ecën. Kjo është e pranueshme edhe përpara Allahut, edhe përpara besimtarëve. Ata e dinë se Allahu i krijoi qeniet njerëzore dhe i pajisi ata me të gjitha cilësitë e tyre. Kurse ata që nuk pasojnë vlerat e Kur'anit nuk e vlerësojnë këtë të vërtetë dhe mendojnë se të gjitha cilësitë që kanë u përkasin atyre. Ata njerëz të cilët mendojnë se bukuria e tyre, pasuria, dituria dhe suksesi kanë ardhur si rezultat i vetvetes, bëhen krenarë dhe mendjemëdhenj dhe për shkak të mendjemadhësisë ata duan të tregojnë epërsinë e tyre duke u ngritur mbi të tjerët. Ky qëndrim



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT


dallohet edhe në mënyrën se si ata ecin, po ashtu edhe në atë se çfarë thonë dhe veprojnë. Sidoqoftë, çdo njeri është i pafuqishëm përpara fuqisë dhe diturisë së Allahut dhe ne kemi nevojë për Të në çdo moment të jetës. Në Kur'an, Allahu na paralajmëron për këtë dhe na ndalon që të lavdërohem:

Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët! (Sure Lukman: 18)

Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, as nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve. (Sure Isra': 37)

Çdo njeri që praktikon këshillat e Kur'anit është i vetëdijshëm se është i pafuqishëm, se jeton sipas vullnetit të Allahut dhe se është Ai i vetmi i adhuruar në Univers, i Cili i ka falur gjithçka që posedon. Besimtari, i cili jeton me këtë vetëdije, e kupton gjithçka që ndodh përreth sipas fjalëve të Kur'anit.

Një njeri nuk mund të ecë në këmbë shumë gjatë ditës, ndërsa për të ecur pak është e lehtë. Aftësia për të ecur është një mirësi e madhe nga Allahu. Po njerëzit nuk mund t'ia dalin duke ecur gjatë; trupi lodhet dhe



këmbët nuk mund të ecin më. Ai e njeh këtë dobësi të robërve të Tij, ndaj ka krijuar kafshë dhe mjete për t'i bartur ata dhe e ka lehtësuar këtë transport. Ja tek janë disa vargje nga Kur'ani në lidhje me këtë mirësi të madhe nga Allahu që tregon mëshirën, dhembshurinë dhe bujarinë kundrejt robërve të Tij:

Ato (kafshët) bartin barrët tuaja deri në vende të largëta, tek të cilat ju do të arrinit me mundim të madh; me të vërtetë Zoti juaj është i Butë dhe Mëshirëplotë. (Ai ka krijuar) edhe kuajt, mushkat edhe gomerët, që ju t'i shaloni dhe t'i mbani për bukuri. Ai krijon edhe gjëra që ju nuk i dini. (Sure Nahl: 7-8)

Ai, që ka krijuar çifte për çdo lloj krijese, që ka bërë anije e kafshë që t'i shaloni. (Sure Zuhruf: 12)



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

A nuk e sheh ti, se Allahu ka vënë në shërbimin tuaj gjithçka ka në tokë dhe anijet që lundrojnë në det me urdhrin e Tij?! Është Ai që e mban qiellin të mos bierë në tokë; kjo mund të ndodhë vetëm me lejen e Tij. Vërtet Allahu është i Butë, dhe i Mëshirshëm me njerëzit. (Sure Haxh: 65)

Po të mendojmë, do ta vëmë re se Ai krijoi minerale të tilla si hekuri dhe çeliku me kapacitete të tilla dhe i frymëzoi njerëzit për t'i përdoruar ato për të prodhuar automjete të ndryshme. Vetëm me vullnetin e Allahut njerëzit kanë ndërtuar automjete të tilla si: makinat, autobusat, trenat, anijet dhe aeroplanët. Kështu Ai e lehtësoi për ne udhëtimin, çka ne nuk do të kishim kurrë mundësi. Ajo që ne duhet të bëjmë në përgjigje të këtyre mirësive është ta përkujtojmë Allahun kur hipim në këto automjete, ta lavdërojmë emrin e Tij dhe ta falenderojmë. Allahu na tregon për këtë në Kur'an:

"E të mbaheni fort mbi to, e pastaj t'i kujtoni dhuntitë e Zotit tuaj dhe të thoni: "qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për neve, se vetë ne këto nuk do t'i kishim nën pushtet ." (Sure Zuhruf: 13)



Transporti në ditët e sotme është shumë më i shpejtë, më i lehtë dhe më i rehatshëm se ç'ishte në të kaluarën. Për një njeri që jeton i udhëhequr nga drita e Kur'anit, të menduarit për këtë mirësi është një rrugë e rëndësishme për t'iu afruar Allahut dhe për ta falenderuar Atë me sinqeritet për bekimet që na ka dhuruar.

Besimtari e përkujton Allahun kur është në udhëtim. Personi që ndodhet anash tij duke drejtuar makinën, modeli dhe ngjyra e makinës, njerëzit rreth tij, lëvizjet e tyre, shkrimi në xhamin e pasëm të automjetit që ndodhet përpara, rradha e ndërtesave përgjatë rrugës, format dhe dritaret e tyre, reklamat dhe shkrimet mbi to janë krijuar të gjitha nga Allahu me vullnetin e Tij. Ai ua shpall këtë të vërtetë njerëzve në vargun e mëposhtëm:

Ne kemi krijuar gjithçka me masë të caktuar. (Sure Kamer: 49)

Allahu ka krijuar gjithçka që ne hasim në çdo moment të jetës tonë, jo vetëm për një individ të vetëm, por për bilionët e njerëzve mbi tokë. Për dikë që jeton sipas vlerave të Kur'anit, të mendosh për këtë është një mënyrë për të ditur se Allahu është gjithmonë pranë,



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



se Ai sheh çdo lëvizje dhe veprim. Për shkak se është i vetëdijshëm për këtë të vërtetë përgjatë gjithë ditës, as ngecja e makinave në trafik, as një makinë që dredhon para tij dhe asnjë vështirësi tjetër që mund të përjetojë ai, nuk mund t'ia ndyshojnë qëndrimin e tij të nënshtruar ndaj Allahut.

Disa njerëz i shohin madje edhe pengesat e vogla si fatkeqësi të mëdha; ata në këto raste bëhen kaq të paduruar dhe ndonjëherë e humbin fare kontrollin duke u sjellë në një mënyrë të pahijshme. Trafiku i rënduar apo një shofer i pavëmendshëm shpejt i nxeh dhe ata fillojnë të flasin me vete apo t'u bërtasin të tjerëve. Nuk kanë aspak durim kur mbeten në trafik dhe e tregojnë këtë duke u rënë borive pandërprerë dhe duke shqetësuar të tjerët. Arësyeja që fshihet pas kësaj sjellje është se ata kanë harruar se gjithçka është nën kontrollin e Allahut.

Për dikë që ia ka kthyer shpinën Allahut, transporti nuk është një mirësi, por përkundrazi një mërzi dhe shqetësim. Për shembull, gropat në rrugë, trafiku i madh, një stuhi e papritur, dhe shumë gjëra të tjera ia turbullojnë mendjen gjithë ditën. Por, këto mendime të pavlera nuk janë të dobishme për të as në këtë botë dhe as në botën tjetër. Disa njerëz pretendojnë se ajo që i pengon ata të mendojnë thellë për këto gjëra është lufta që duhet të bëjnë në këtë botë. Në

përpjekjen për të siguruar ushqim, strehim dhe shëndet të mirë, ata



pretendojnë se nuk kanë kohë për të menduar për Allahun apo për të vërtetat që të çojnë drejt besimit. Por, kjo nuk është asgjë tjetër veçse shmangie nga përgjegjësia. Detyrat familjare të një njeriu dhe pozicioni në të cilin gjendet nuk kanë të bëjnë aspak me të menduarit. Një njeri, i cili me qëllim që të fitojë kënaqësinë e Allahut, mendon për shenjat që të udhëzojnë drejt besimit, si kaderin (përcaktimin) e Allahut, botën tjetër, vdekjen dhe përsiat mbi mirësitë që na ka dhënë Allahu në këtë jetë, - do ta gjejë ndihmën e Allahut gjithmonë pranë. Ai do të shohë se mjaft nga problemet e tij zgjidhen lehtësisht dhe ka më tepër kohë për të menduar.



Besimtari kurrë nuk harron se Allahu ka krijuar çdo situatë në të cilën ai e gjen veten gjatë ditës. Qëllimi i krijimit të këtyre gjërave është që ne të mësojmë të bëhemi të duruar apo të vemë në punë mendjen për t'u përpjekur për të zgjidhur problemet në atë mënyrë që e kënaq Allahun. Nëse ka ndonjë vështirësi që nuk mund të zgjidhet me përpjekje personale, atëherë gjëja e vetme e cila na mbetet të bëjmë është të tregojmë durim. Të inatosesh, të fillosh të ulërish dhe të grindesh ashtu siç veprojnë disa njerëz, është e gabuar dhe e palogjikshme, sepse mund të jetë e rrezikshme, qoftë për ne, qoftë për të tjerët.

Për njerëzit, është e gabuar që të presin sprova me dhimbje të



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



mëdha apo tragjedi, si prova të durimit tonë, për arsye se Allahu i provon njerëzit gjatë gjithë ditës me sprova të ndryshme të mëdha dhe të vogla.

Kështu, gjërat e mërzitshme si ngecjet në trafik, apo vonesa për të mbëritur diku dhe pengesat e vogla janë sprova për njerëzit. Po, në këtë situatë, ata që venë në jetë këshillat e Kur'anit nuk ndjejnë mërzë dhe e ruajnë baraspeshën pa u ankuar. Në Kur'an, Allahu shpall se është cilësi e besimtarëve që të tregohen durimtarë në sprovat në të cilat gjenden:

Atyre, zemrat e të cilëve frikësohen kur përmendet Allahu, që janë të durueshëm për gjithçka që i godet, të cilët rregullisht i falin namazet dhe që cilët ndajnë nga ajo që Ne ua kemi dhënë. (Sure Haxh: 35)





Nëse pësojnë ndonjë aksident në trafik, besimarët e ruajnë gjakftohtësinë, jo në një kuptim pasiv, por duke pranuar realisht atë që Allahu ka caktuar për ta. Në një situatë të tillë ata sillen në mënyrë të arsyeshme duke ditur se Allahu ka krijuar gjithçka që u ka ndodhur dhe përpiqen të bëjnë diçka për të shpëtuar të dëmtuarit, thërrasin për ndihmë dhe e kufizojnë dëmin. Ata e dinë se janë përgjegjës çdo moment të jetës së tyre për t'u sjellë në një mënyrë e cila e kënaq Allahun.

Në suren Mulk, Allahu shpall qëllimin e krijimit të njeriut dhe përgjegjësinë që na është dhënë:

Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se cili prej jush do të veprojë më mirë. Ai është Ngadhënyyesi, Falësi i Madh. (Sure

Mulk: 2)

Besimtari, i cili e jeton çdo çast të jetës në këtë botë sipas vargjeve të Kur'anit, nuk e le mendjen e tij të mbytet me mendime të pakuptimta dhe të



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT



paqëllimta gjatë
udhëtimit; ai e drejton
vëmendjen drejt gjërave dhe
ngjarjeve për të cilat mund të mendojë
thellë. Për shembull, për ata njerëz që janë
larg Kur'anit, zogjtë që fluturojnë në qiell
janë një ndodhi mëse e zakonshme. Për
besimtarin, janë shenjë edhe zogjtë,
të cilët mbahen të varur në ajër dhe
kryejnë akrobacira me krahët e
tyre delikate. Krahët e tyre janë
projektuar në mënyrë që ata të
fluturojnë, dhe t'i kryejnë këto
lëvizje me shpejtësi. Sqepat e tyre janë

ndërtuar posaçërisht për një ushqyerje të përshtashme, teknikat e tyre të fluturimit, strukturat e veçanta të skeletit, sistemet e frymëmarrjes, nervore dhe të tjera, struktura aerodinamike e puplave të tyre, teknikat e ndërtimit të foleve, tingujt e ndryshëm që lëshojnë në varësi të situatave të ndryshme, dhe sistemet e studiuara tek zogjtë janë mrekulli të krijimit. Të gjitha këto janë prova të ekzistencës së Allahut, fuqisë dhe diturisë së pafund. Ai na tërheq vëmendjen për këtë në Kur'an: **"A nuk i kanë parë ata shpendët përmbi kokat e tyre, krahëhapur dhe kur krahët i palosin? Askush nuk i mban ata, përveç të Gjithëmëshirshmit; Ai, me të vërtetë sheh çdo gjë."** (Sure Mulk: 19)

Kur besimtarët ecin në rrugë, vënë re mrekullitë e krijimit që i rrethojnë dhe janë në çdo çast dëshmitarë të fuqisë së pamatë të Allahut.

Në punë

Shumica e të rriturve ia kushtojnë punës pjesën më të madhe të ditës. Por, ata që sillen në pajtim me këshillat e Kur'anit janë krejt ndryshe nga kolegët e tyre, me të cilët kanë një moral të përbashkët. Për besimtarin, pavarësisht se sa urgjente mund të jetë një punë gjatë ditës, ai do të falet dhe ta adhurojë Allahun. Për të kjo është më e rëndësishme se gjithçka tjetër. Allahu e shpreh këtë në Kur'an:

"Thuaj: "Ajo që është tek Allahu është shumë më e mirë se dëfrimi dhe tregëtia, e Allahu është Furnizuesi më i mirë. "
(Sure Xhumu'a: 11)

Besimtari është i vetëdijshëm për këtë dhe asnjë punë nuk e pengon atë për ta përmendur Allahun apo për ta adhuruar Atë; ai nuk i le pas dore apo t'i braktisë detyrimet fetare për hir të përfitimit material. Zoti ynë na e tërheq vëmendjen për këtë në një varg në Kur'an:

Në xhamitë që Allahu ka urdhëruar të ngrihen, e të përmendet aty emri i Tij, Atë e lavdërojnë mëngjes e mbrëmje, njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për ta përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin dhe japin zekatin, dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kijametit), kur zemrat dhe shikimet do të tronditen. (Sure Nur: 36-37)

Arsyeja pse tërhiqet vëmendja

posaçërisht për tregëtinë në këtë varg, është sepse dëshira për përfitim material është një nga dobësitë më të mëdha tek njerëzit. Disa njerëz lenë pas dore urdhëresat e besimit për hir të fitimit të sa më tepër parave, sigurimit të sa më shumë pasurive apo të fitimit të pushtetit. Për shembull, ata nuk falen dhe nuk përmbushin detyrimet e tjera fetare e nuk shfaqin cilësi të mira të karakterit, ndonëse i kanë mundësitë për të vepruar kështu.

Ka disa gjëra që këta njerëz presin, në këmbim të punës së tyre. Ata duan një jetë të mirë në këtë botë, të jenë të pasur, të fitojnë pozitë në shoqëri dhe respekt nga të tjerët dhe të nderohen, të kenë një martesë të mirë dhe fëmijë të vyeshëm... Këto janë vetëm disa zgjedhje në këmbim të botës tjetër, për njerëzit që e kanë ndarë veten e tyre nga vlerat e Kur'anit. Në të vërtetë, këto janë disa nga mirësitë e natyrshme, të cilat çdo njeri që kërkon të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe jetën e lumtur në botën tjetër, me të drejtë synon t'i arrijë. Edhe besimtarët dëshirojnë të kenë të njëjtat mirësi: punësim dobiprurës, të fitojnë para dhe të kenë pasuri. Por, ata kanë disa cilësi që i veçojnë nga njerëzit e tjerë: punojnë që të fitojnë kënaqësinë e Allahut, i harxhojnë paratë e tyre në mënyrat me të cilat na ka këshilluar Allahu dhe në biznesin e tyre si në çdo gjë tjetër, ata i binden urdhërave të Allahut me kujdes të madh.

Në një varg në Kur'an, Allahu në tërheq vëmendjen nga rreziku i vlerësimit të tregëtisë mbi fenë:

Thuaj: "Në qoftë se etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia, për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë, shtëpitë ku e ndjeni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë prisni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur." (Sure Teube: 24)

Besimtari me besim të rrënjësor do të bëjë çdo përpjekje për t'iu shmangur rënies në këtë grackë të pasionit. Nga besimtarët, Allahu pret një karakter fisnik, të cilin ata e shfaqin në çfarëdo lloj pune që angazhohen. Në tregëti ata janë të ndershëm, të singertë, vetësakrifikues, punëtorë, të drejtë dhe të thjeshtë. E gjithë vëmendja e tyre përqendrohet në fitimin e kënaqësisë së Allahut dhe në ruajtjen e kufijve që Ai ka vënë midis asaj që është e lejuar dhe asaj që është e ndaluar. Allahu i ka urdhëruar besimtarët që në tregëti të mos shkelin të drejtën e asnjë njeriu. Ata duhet të masin dhe të peshojnë me drejtësi dhe të mos ia zvogëlojnë vlerën e mallrave blerësve. (Sure Hud: 85)

Në disa vargje Allahu ka shpallur rëndësinë e të qenit i drejtë në biznes, e trajtimit me drejtësi të njerëzve dhe njëkohësisht,



duke shfaqur cilësi të mira për të
fituar kënaqësinë e Tij:

Saktësojeni matjen kur
matni dhe peshoni me
peshore të rregullt. Kjo
është e mira që çon në
përfundimin më të bukur.
(Sure Isra: 35)



Prandaj matni drejt e mos hani
në peshë. (Sure Rrahman: 9)

Në Kur'an, Allahu shpjegon se si njerëzit duhet të angazhohen në tregëti dhe zanate. Në rradhë të parë, Allahu ka ndaluar qartazi kamatën: **"Po Allahu e ka lejuar tregëtinë dhe ka ndaluar kamatën."** (Sure Bekare: 275) Diçka tjetër që Allahu ka shpallur është se si të administrojmë tregëtinë dhe borxhet. Ai ka urdhëruar që: në biznes, një njeri, i cili merr borxh për një afat kohor të përcaktuar, duhet ta shkruajë atë (ta dokumentojë). E nëse personi i cili merr borxh është i dobët apo i paaftë të diktojë, atëherë për të, duhet të diktojë kujdestari i tij në mënyrë të drejtë dhe dy burra duhet të shërbejnë si dëshmitarë.

O besimtarë! Shkruajeni huan që ia jepni njëri-tjetrit për një afat të caktuar. Le ta shënojë atë me drejtësi një shkruer ndërmjet jush; asnjë shkruer të mos ngurrojë ta shkruajë ashtu siç e ka mësuar Allahu. Ai le të shënojë, kurse borxhliu le të diktojë dhe le t'i frikësohet Allahut, Zotit të botërave. (Sure Bekare: 282)

Diçka tjetër për të cilën duhet të jenë të kujdesshëm besimtarët në punën e tyre është konsultimi me të tjerët, marrja parasysh e mendimeve të të tjerëve në marrjen e vendimeve, kur fillojnë një biznes apo kur përmirësojnë punën e tyre. Allahu thotë në Kur'an se kjo është cilësi e besimtarit.

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Si në çdo sferë të jetës, ashtu edhe në tregëti, Kur'ani sjell atë që është më e mirë, më e lehtë dhe më e vërtetë në jetën njerëzore. Në këtë mënyrë, ai i ndihmon njerëzit të jenë larg ankthit dhe dëshpërimit dhe u mundëson atyre të punojnë në një ambient të shëndetshëm dhe të paqtë, ku mund t'i nënshtrohen Allahut, të marrin vendime të drejta dhe të konsultohen me të tjerët për to.

Përveç kësaj, besimtari është një njeri me mendje të hapur si në jetën ashtu edhe në punë, i cili bën plane afatshkurtra dhe afatgjata dhe planifikon fazat e ndryshme të punës. Pasi ka filluar punë, ai patjetër llogarit fazat e mëvonshme, çfarë masash do t'i sigurojnë atij suksesin në vazhdimësi dhe të gjitha mundësitë e tjera të realizueshme. Ndaj, do të marrë të gjitha masat e nevojshme që Allahu ka dhënë në Kur'an për t'u siguruar se një investim që ai e mendon si të dobishëm sot, të mos dalë i dështuar më vonë. Në kohën që është i angazhuar me punë, ai i lutet vazhdimisht Allahut nga thellësia e zemrës, dhe i kërkon Atij t'ia lehtësojë përpjekjen me bindjen se asgjë nuk ka sukses pa ndihmën e Allahut. Ai shpreson se puna që kryen do të jetë një mënyrë për të fituar kënaqësinë e Allahut.



Harun Jahja (Adnan Oktar)

Në epokën në të cilën po jetojmë, janë shfaqur mjaft zbulime dhe zhvillime shkencore, të cilat njerëzit në të kaluarën as që i kishin imagjinuar. Fjalët e Kur'anit, na thonë që ne duhet të falenderojmë për këto mundësi të pakrahasueshme. Për shembull, shkenca, teknologjia, transporti modern, dhe komunikimi kanë arritur një nivel të lartë përparimi në ditët e sotme. Falë teknologjisë së kompjuterave dhe internetit, njerëzit në çdo skaj të botës mund të shihen me njëri-tjetrin vetëm brenda disa sekondave, të shkëmbejnë informacion dhe të vendosin lidhje mes tyre. Sigurisht që, këto janë mirësi për të cilat ne duhet të mendojmë shumë thellë. Profetët, të cilët Allahu i ka dhënë si shembuj në Kur'an, gjithmonë i afroreshin Allahut në mënyrë të sinqertë dhe gjithmonë e kishin Atë në mendje dhe e falenderonin kur ishin të zënë në punën e tyre. Në suren Sebe, Allahu thotë:

Ata punonin për të çfarë dëshironte: faltore dhe statuja, enë të gjera si puse, dhe kuzhinë të mëdhenj të palëvizshëm. "O familje e Daudit! Bëni falenderim (për Allahun)!" Megjithatë, pak nga robërit e Mi janë falenderues. (Sure Sebe': 13)



Në treg

Sot, blerja është një aktivitet shumë i rëndësishëm për shumë njerëz. Për shembull, shumë njerëz shpenzojnë orë, madje ditë të tëra duke vizituar dyqane për të blerë rroba, me të cilat t'u krenohen shokëve të tyre. Ata harxhojnë shumë para për veshje, të cilat do t'i veshin vetëm disa herë në jetën e tyre dhe, ndonëse, dollapin mund ta kenë plot, ende vazhdojnë të blejnë me etje të shfrenuar. Për këta njerëz, të blerit ka shkuar përtej plotësimit të nevojave dhe është bërë një pjesë e rëndësishme e jetës së tyre. Ata e humbasin veten duke blerë, dhe shumë shpesh blejnë sende për të cilat më vonë pendohen.

Sigurisht, bërja e pazarit është e domosdoshme për çdo njeri dhe madje mund të jetë një punë e këndshme. Por, gabimi në të qëndron, se ajo mund të rrënjosë dëshirat e pangopura për këtë botë dhe t'i bëjë njerëzit tërësisht të pavetëdijshëm për botën tjetër. Ata në këtë mënyrë ia dedikojnë gjithë jetën, mendimet dhe planet e tyre këtij aktiviteti dhe, në vend që të kërkojnë mënyra se si ta kënaqin Allahun, i cili i krijoi, ata përpiqen të gjejnë kënaqësi në punë të vogla si blerja.

Harun Jahja (Adnan Oktar)

Si në çdo sferë të jetës, një njeri që e drejton jetën e tij sipas mësimëve të Kur'anit, edhe në këtë sferë ai do të përpiqet të shohë tek blerja si aktivitet, të mirën që ka krijuar Allahu dhe kuptimin që fshihet përtej gjërave që ndodhin. Për të, blerja nuk është një sorrollatje e paqëllimtë, por një mundësi që i jepet atij për të furnizuar atë dhe familjen e tij me ato sende për të cilat kanë nevojë. Sigurisht që, ky aktivitet nuk do ta largojë atë nga adhurimi i Allahut. Ai i urdhëron besimtarët në Kur'an:



Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët) duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e, që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi. (Sure Kehf: 28)

Muslimani, i cili del për të bërë pazar do të ketë parasysh se: Allahu ka krijuar ushqime të ndryshme, po ashtu dhe veshje dhe shumë mirësi të tjera për besimtarët. Në shumë vende, për shkak të papunësisë, varfërisë apo luftimeve, njerëzit mezi e sigurojnë bukën e gojës. Ndonëse jetojnë në vende të pasura me burime natyrore, ka njerëz të cilët janë shumë të varfër për të blerë ato sende për të cilat kanë nevojë. Këta të gjithë janë nën mbikqyrjen e Allahut dhe ka një arsye që fshihet prapa sasisë së furnizimit që Allahu u lëshon njerëzve. Ai na



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

tërheq vëmendjen për këtë në Kur'an në vargun e mëposhtëm:

A nuk e dinë ata se Allahu ia shton apo ia pakëson rrizkun kujt të dojë?! Vërtet në këtë ka shenja për njerëzit që besojnë. (Sure Zumer: 52)



Allahu ka krijuar rrethana të ndryshme për t'i vënë në provë njerëzit. Kështu, muslimani nuk do të rreshtë së falenderuari për atë që i është dhënë, pa marrë paraysh se në çfarë gjendje ndodhet. Ai është i vetëdijshëm se sprova dhe rrethanat, në të cilat gjendet, janë kalimtare. Për këtë arsye, dëshiron të sillet në çdo moment në mënyrë të tillë që Allahu të kënaqet prej tij. Ai e falenderon Allahun thellë në zemër për mirësitë që i ka falur në fjalët dhe në veprat e tij. Nga ajo që i është dhënë, ai shpenzon për të kryer vepra të mira dhe, nëse Allahu e sprovon duke ia pakësuar furnizimin, ai tregohet durimtar dhe vazhdon ta falenderojë Atë me sinqeritet. Ai e di se tashmë po provohet me varfëri dhe i lutet Allahut t'i japë durim. Në çdo rrethanë, besimtari është i kënaqur me Zotin e tij dhe shpreson se edhe Ai do të jetë i kënaqur me të.

Ata, të cilët ndjekin traditat, zakonet dhe vlerat e një shoqërie e cila nuk jeton sipas mësimave të Kur'anit, menjëherë e humbin ndjenjën e tyre të falenderimit kur hasin edhe vështirësinë më të vogël.



Allahu i dënon ata në Kur'an, për shkak se ata dështuan në të kuptuarit se pasuria dhe shëndeti i tyre janë një sprovë e njëjtë me përvojën e tyre të varfërisë dhe nevojës:

Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: "Zoti im më ka nderuar."

Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: "Zoti im më ka poshtëruar." (Sure Fexhr: 15-16)

Allahu ka krijuar mirësi të panumërta mbi tokë, por njerëzit, të cilët nuk e kuptojnë këtë, harrojnë se kjo ndodh sipas vullnetit të Allahut dhe vetëm me lejen e Tij ata mund të blejnë ushqimin dhe veshjet. Ata nuk e falenderojnë Allahun, por, vazhdimisht veprojnë nën kontrollin e dëshirave të tyre egoiste. Gjithçka që synojnë kur janë duke blerë është: si t'u bëjnë përshtypje shokëve me veshjen tyre. Ata shqetësohen vazhdimisht ku të gjejnë modën më të fundit dhe më tërheqëse me ngjyrat dhe cilësinë që e dëshirojnë. Janë gjithmonë në merak për atë që kanë njerëzit e tjerë dhe ndjejnë zili për ta dhe nuk mund të durojnë të qenit pa pasuri dhe bollëk material. Ata ndjejnë dëshirë të madhe për të pasur pasuri dhe prona. Krahatojnë atë që u është dhënë atyre me atë që u është dhënë njerëzve të tjerë dhe bëhen të paduruar duke menduar se ata janë trajtuar padrejtësisht dhe nuk falenderojnë. Në Kur'an, Allahu na zbulon mosmirënjohjen e atyre të cilët nuk janë të kënaqur me atë që kanë dhe gjithmonë lakmojnë më tepër:

Në të vërtetë, Zoti yt është Bamirës i madh i njerëzve, por





shumica e tyre nuk janë mirënjohës.

(Sure Neml: 73)

Besimtari, i cili udhëhiqet nga drita e Kur'anit, e di se mirësitë që e rrethojnë janë dhuratë prej Allahut dhe tregohet i kujdesshëm për

të mos shpenzuar para me tepri. Ai është i kujdesshëm për të mos shpenzuar shumë para dhe kohë me blerjet. Ai vepron ashtu siç thotë Allahu në Kur'an: **"Hani e pini, por mos e teproni. Ai nuk i do ata që e teprojnë."** (Sure A'raf: 31) Besimtari nuk harron, se ata njerëz që shpenzojnë në mënyrë të shfrenuar, Allahu i quan **"vëllezër të djallit"** (Sure Isra': 27)

Ashtu siç na kërkohet nga Kur'ani, që të mos shpenzojmë para me tepri kur bëjmë pazar apo kur blejmë gjëra të tjera, po ashtu na kërkohet që të jemi bujarë. Allahu e shpall këtë në Suren Furkan: **Dhe ata që kur shpenzojnë nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes.** (Sure Furkan: 67)

Ky varg përmbledh mençurinë që tregon besimtari në mënyrën se si kryen çdo blerje.





Ushtrimet dhe stërvitja fizike

Çdo njeri me besim e di se trupi i tij i është besuar për një kohë të shkurtër në jetën e kësaj bote; ai ka përgjegjësi për t'u kujdesur për të në mënyrën më të mirë, prandaj tregohet i kujdesshëm për shëndetin. Për këtë arsye, gjatë aktivitetit të tij ditor ai i kushton një kohë të caktuar ushtrimeve apo stërvitjes fizike. Ushtrimet dhe stërvitja fizike ndihmojnë në forcimin e trupit, i japin atij qëndrueshmëri dhe e aftësojnë të funksionojë në një mënyrë të rregullt dhe të shëndetshme, po aq sa i mundësojnë të punojë edhe më mirë për të kënaqur Allahun dhe për të kryer vepra të mira.

Metabolizmi i qenieve njerëzore nuk pajtohet me plogështinë, ai është krijuar për të ndihmuar lëvizjen. Në ditët e sotme është bërë e njohur se ushtrimet kanë dobi të shumta: ato forcojnë sistemin imunitar, atë të frymëmarrjes dhe atë nervor; ato e bëjnë trupi rezistent ndaj viruseve dhe sëmundjeve; mundësojnë funksionin e rregullt të sistemit hormonal, zemrës dhe arterieve, forcojnë muskujt, arikulacionet dhe tendinat, përmirësojnë gjendjen e organizmit dhe i sjellin fuqi;

ndihmojnë në mbajtjen në
ekuilibër të sheqerit



në gjak, ulin nivelin e kolesterolit "të keq" dhe ngrenë nivelin e kolesterolit të "mirë".

Një arsye tjetër pse njerëzit me besim bëjnë përpjekje në këtë drejtim është se shëndeti fizik është një cilësi për të cilën Allahu na tërheq vëmendjen në Kur'an. Për shembull, kjo mund të shihet në vargun 144 të Sure A'raf, në të cilën Allahu i flet Musait (as), duke e zgjedhur atë të udhëheqë Bijtë e Izraelit, ku ai tregon për forcën e tij fizike. Një varg tjetër, gjithashtu, flet për forcën fizike të Talutit

(as) i cili u dërgua të sundojë njerëzit e tij:

Profeti i tyre u tha: "Allahu ka dërguar Talutin si mbretin tuaj." Ata thanë: "Si mund të bëhet ai mbreti ynë, kur ne kemi më tepër merita se ai për të sunduar?! Përveç kësaj, ai nuk ka ndonjë pasuri të madhe." Ai u përgjigj: Allahu e ka zgjedhur atë për mbretin tuaj dhe e ka pajisur me dijeni të gjerë dhe fuqi trupore. Allahu ia jep pushtetin e Vet kujt të dojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshtëm." (Sure Bekare: 247)


Kjo është një arsye tjetër pse besimtarët duhet të jenë të kujdesshëm në kryerjen e ushtrimeve: nëse një njeri, i cili u mëson të tjerëve Fjalën e Allahut

duket fizikisht i fortë dhe tërheqës ai do të ketë ndikim mbi të tjerët; pamja e tij e jashtme fisnike dhe tërheqëse do të lerë përshtypje të mirë tek njerëzit me të cilët flet.

Për këtë arsye, besimtarët duhet të përpiqen gjithmonë për të mbajtur një trup të fortë dhe të shëndetshëm. Ata nuk mund të jenë përtacë, të shkujdesur apo moskokëçarës në këtë drejtim.



Harun Jahja (Adnan Oktar)



Falja e namazit

Vargu 56 i Sures Dharijat, i cili thotë se: **"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, veçse të më adhurojnë"** shpall se Allahu i ka krijuar qeniet njerëzore që ta adhurojnë. Me fjalë të tjera, qëllimi i krijimit të njeriut është, siç thotë Allahu në Kur'an, t'i shërbejë Zotit tonë, i Cili ka krijuar gjithçka. Pra, ata të cilët e marrin Kur'anin si udhërrëfyesin e tyre dhe e vendosin adhurimin e Allahut mbi gjithçka tjetër dhe e kalojnë jetën e tyre të shkurtër – vetëm 70 vjet, nëse do t'u jepej edhe aq,- me synimin për të fituar botën tjetër dhe për të fituar kënaqësinë e Allahut, adhurimi i tyre spikat në çdo çast të jetës në këtë botë.

Muslimani është i vetëdijshëm se mësimet e Kur'anit nuk gjejnë vend vetëm për një drejtim të jetës së tij në këtë botë, apo në momente dhe faza të caktuara në të, por në të gjithë jetën. Ai u bindet urdhërave të Allahut me të gjitha mundësitë e tij dhe kryen aq vepra të mira sa i lejojnë mundësitë. E kalon kohën në vepra adhurimi të cilat Allahu i ka shpallur në Kur'an dhe kur mbaron një vepër të mirë vazhdon me një tjetër. Për arsye se Allahu thotë në vargun 162 të Sures En'am: **"Thuaj: "Namazi im dhe kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e botërave"**, ai ndjek atë që është e mirë dhe e dobishme dhe në përpjekjet e tij nuk ka pushim, ndalim apo kufij. Për besimtarin, fillimi i një pune të re pasi është mbaruar e mëparshmja është i domosdoshëm, sepse ai e di se duhet të kalojë çdo sekondë që i është dhuruar në këtë jetë duke punuar për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe se do të japë llogarri në botën tjetër për çdo moment të kaluar



Herrin Jahje (Adnan Oktar)

në këtë botë. Për këtë arsye, kalon çdo minutë duke shpresuar të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe vazhdon të kryejë ato gjëra për të cilat ai shpreson se Allahu i do. Në Kur'an, Allahu u thotë besimtarëve të bëjnë përpjekje në këtë drejtim:

Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim). (Sure Inshirah: 7)

Veprat e besimtarit për të fituar kënaqësinë e Allahut janë të pandërprera nga dita në ditë. Kjo duket edhe në vargun 76 të Sures Merjem: Veprat e mira që mbesin, janë të shpërblyera më mirë te Zoti yt dhe kanë përfundimin më të mirë. (Sure Merjem: 76)


Dhe, në një varg tjetër, Zoti ynë shpall se Ai dëshiron që njerëzit të këmbëngulin në adhurim:

Ai është Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje që është midis tyre, prandaj, vetëm Atë adhuroje dhe bëhu i qëndrueshëm në adhurimin e Tij. A njeh ti ndokënd që ka emrin e Tij? (Sure Merjem: 65)

Logjika e çoroditur e disa njerëzve të paditur i bën të dyshojnë jetën tjetër. Ata kryejnë disa vepra adhurimi kokë pas kohe.

Disa njerëz të tjerë bëjnë gabimin e madh në përpjekjen për të fituar vetëm të mirat e kësaj bote, të cilat ia kanë vënë vetes si qëllim; ata bëjnë gjithçka për t'u bërë të pasur, për të fituar grada në shoqëri dhe për të fituar gjithçka që dëshirojnë. Brenda një kohe të shkurtër ata përfshihen në një garë të paparë për hir të "një vlere të vogël" (Sure Teube: 9) të cilën shpejt e humbin. Ndërsa besimtari, që ka për qëllim të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe rrugën e Parajsës, përpiket vetëm për hir të Allahut. Kjo cilësi e besimtarit përshkruhet në Kur'an kështu:

Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiket për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet. (Sure Isra': 19)



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Besimtari, i cili e kalon gjithë ditën duke kërkuar të fitojë kënaqësinë e Allahut, është i vendosur dhe i zellshëm në kryerjen e namazit (faljes). Ai e kujton Allahun përgjatë gjithë ditës, në zemër e në aktivitetet e tij dhe mediton thellë mbi fuqinë, inteligjencën, diturinë, mjeshtërinë artistike dhe cilësitë e tjera të Tij. Ky qëndrim është zbatimi në jetën e vërtetë të urdhërit kuranor që jepet në vargjet e mëposhtme.

Përkujtoje Zotin tënd shumë dhe madhëroje Atë mëngjes e mbrëmje. (Sure Ali Imran: 41)

Përkujtoje Zotin tënd në vetvete me frikë dhe me përlulesi, jo me zë të lartë, në mëngjes dhe në mbrëmje." (Sure A'raf: 205)

Në vargun 28 të Sures Ra'd, Zoti ynë thotë se zemrat gjejnë qetësi vetëm me përkujtimin e Tij:

Ata që besojnë, zemrat e të cilëve qetësohen me përkujtimin e Allahut. (Sure Ra'd: 28)

Një njeri që ve në jetë urdhërat e Kur'anit do të jetë i kujdesshëm në kryerjen e veprave të adhurimit si psh, falja e pesë namazeve, agjërimi dhe pastrimi para faljes (abdesi) ashtu siç ka urdhëruar Allahu. Për shembull, falja e namazit në kohën e tij është një çështje shumë e rëndësishme. Ai nuk lejon që punët e kësaj bote t'i ndërhyjnë në faljen e namazit dhe ta pengojnë atë prej tij. Sa herë që falet, ai qëndron me përlulesi, gëzim dhe zell duke shpresuar që t'i afrohet Allahu.

Ata njerëz, të cilët nuk i afrohen Allahut me ngazëllim të vërtetë, por sa për t'u dukur nga frika e

Herua Jahje (Adnan Oktar)

njerëzve, duke patur parasysh çfarë do të thonë të tjerët për ta, nuk mund të përjetojnë gëzim në adhurimin e Allahut. Kur falen, atyre as që u shkon ndër mend se kjo mund t'i afrojë tek Allahu. Mendjet e tyre janë shumë të zëna me punët e përditshme, për ta përkujtuar Allahun dhe për ta lavdëruar Atë. Në Kur'an, Allahu i paralajmëron ata të cilët e lenë pas dore faljen e tyre:

Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet, të cilët duan vetëm që të duken. (Sure Ma'un: 4-6)

Kjo do të thotë se ata e vonojnë faljen jashtë kohës së saj ose e lenë atë fare. Megjithatë, ndonëse kjo sure nuk i referohet asaj, njerëzit e mençur këshillohen dhe frikësohen nga të vepruarit me pakujdesi në namaz.

Njerëzit e humbur, duke menduar se po bëjnë diçka për hir të Allahut pa iu frikësuar Atij, bëjnë gabim të madh, duke menduar për Të, por pa ndier praninë apo afërsinë e Tij. Vepra që e sjell njeriun afër Allahut është sinjeriteti në kryerjen e namazit, frika ndaj Tij, bindja dhe përlësia para Tij.

Disa njerëz kanë një të kuptuar shumë të ngushtë të namazit duke menduar se kaq mjafton për t'ju bindur disa prej urdhrave të Allahut përgjatë ditës. Por, sipas Kur'anit, adhurimi nuk kufizohet vetëm me detyra fetare si: namazi, agjërimi, haxhi dhe zekati.

Adhurim do të thotë robërim. Kjo do të thotë se ai përbëhet prej botëkuptimit dhe gjendjes mendore të

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

njeriut dhe gjithçkaje tjetër që ai kryen apo flet si rob i Allahut. Pa zbehur rëndësinë e namazit si një vepër adhurimi për njeriun, po ashtu vlera fisnike janë edhe përmbajtja e zemërimit, përdorimi i gjuhës së zgjedhur, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, të paturit besim tek Muslimanët e tjerë dhe lënia e grindjeve. Të gjitha këto përmbledhen në adhurim. (Për dije më të hollësishme shih *Ligjet më të Anashkaluara të Kur'anit* nga Harun Jahja) Për këtë arsye, sjellja e mirë është prej atyre çështjeve të cilat duhet të zbatohen dhe të praktikohen po aq me kujdes dhe me vendosmëri sa edhe ritet e adhurimit.

Krahas kësaj, Muslimanët duhet të njohin llojet e ndryshme të këmbimeve në botë; si blerja dhe shitja, marrja hua, martesë dhe divorci të cilat janë të pranueshme

dhe mënyrat e drejta për t'i kryer ato. Shkurtimisht, besimtarët në çdo çast të jetës së tyre tregojnë kujdes të madh për të gjitha urdhërat e Allahut të shprehura në Kur'an, gjithashtu edhe për

Herua Jahja (Adnan Oktar)

urdhërat, ndalesat dhe këshillat e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të.

Një nga veprat më të rëndësishme të adhurimit që mund të kryejë besimtari gjatë ditës është komunikimi i këtij mesazhi, që do të thotë ftesa e njerëzve për të ndjekur rrugën e drejtë, urdhërimi i tyre për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, ftesa e tyre për të shtuar dijet rreth Islamit, Imanit (besimit) dhe Ihsanit (mirësisë) si dhe në leximin e Kur'anit. Ky adhurim është pjesë e rëndësishme e ditës së besimtarit. Në çdo sekondë ai është i përgjegjshëm për të qenë mëkëmbës i Allahut midis krijesave të Tij duke shpallur fenë e Allahut me fjalët, sjelljen dhe natyrën e tij si njeri. Kjo përgjegjësi nuk kufizohet vetëm me ritet e adhurimit; besimtari përpiket të jetë shembull për ata që e rrethojnë duke u sjellë në mënyrën më të mirë të mundshme. Zoti ynë flet për këtë në Kur'an:

Besimtarët dhe besimtares janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë që do t'i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. (Sure Teube: 71)



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Besimtari bën çmos për të thirrur njerëzit e tjerë në besimin tek Allahu dhe ecja në rrugën e Tij. Kështu, ai u flet atyre për Të, për Njeshmërinë dhe cilësitë e Tij, për qëllimin e krijimit të njeriut, për sjelljen dhe qëndrimin e mirë, mënyrën e jetesës që e kënaq Allahun, për të mirën dhe të keqen, të drejtën dhe të padrejtën sipas Kur'anit, për Ditën e Gjykimit, Zjarrin dhe Parajsën dhe shumë tema të tjera. Ai u tregon atyre për Profetin Muhamed, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, në atë mënyrë që ata të afrohen tek ai duke ndjekur shembullin e tij dhe duke e nderuar siç e meriton.

Biseda që besimtarët bëjnë midis tyre është një këshillim i ndërsjellë. Ata e ftojnë njëri-tjetrin për t'ju bindur urdhrave të Allahut dhe për të vënë në jetë Sunnetin (Traditën) e të Dërguarit të Tij, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të dhe për të përvehtësuar në jetë vlerat islame. E thënë thjesht, mënyra e jetesës së një besimtari është përkujtim dhe këshillë.

Besimtarët përdorin njëkohësisht këshillën bisedore dhe atë të shkruar, shfrytëzojnë mjetet bashkëkohore më të zhvilluara të komunikimit masiv. Në ftesën e njerëzve drejt mësimave të Kur'anit, ata përfitojnë nga dobitë e televizionit, radios, librave, revistave, gazetave, internetit dhe mjeteve të tjera të komunikimit.

Po aq e rëndësishme sa ftesa e përditshme e besimtarëve, të cilët praktikojnë këshillat e Kur'anit, është edhe koha që duhet për të përgatitur këtë ftesë. Në Kur'an, Allahu thotë se, ata që dëshirojnë të ndërmarrin betejën e ideve në rrugën e Tij, së pari, duhet të përgatiten për të. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që njeriu të përgatitet në çdo lloj mënyre të mundshme për këtë vepër. Allahu thotë:

Sikur të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur...
(Sure Teube: 46)

Për të transmetuar mesazhin e Allahut, një nga gjërat që duhet të bëjë besimtari i zgjedhur për këtë, është ngritja e nivelit të tij duke përvetësuar çfarëdo lloj diturie të dobishme me qëllim përhapjen e

fesë së Allahut. Kjo do të thotë se, ai duhet ta përgatisë veten si nga ana shpirtërore, ashtu edhe nga ana intelektuale. Ai duhet të bëjë çdo përpjekje për të folur dhe për të shkruar si duhet, në mënyrë që të godasë në shenjë dhe të mos dalë nga tema, të jetë bindës, frytdhënës dhe të kënaqë dëgjuesit me mençurinë e mësuar nga feja e Allahut. Detyrë kryesore për besimtarin është të mësojë fenë Islame, të dijë kuptimin e vargjeve Kur'anore dhe t'i mbështetet sjelljes dhe thënieve të Profetit tonë, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Në këtë mënyrë, të gjitha këto përgatitje dhe përpjekje zënë një vend të veçantë në jetën e përditshme të besimtarit, i cili është i specializuar dhe i autorizuar për t'i ftuar njerëzit tek Allahu dhe i Dërguari i Tij.



Shkuarja për në shtrat

Për të gjithë njerëzit e mençur, ka shumë çështje mbi të cilat mund të reflektojmë përsa i përket krijimit të natës. Zoti ynë ua ka shpallur këtë njerëzve në vargun e mëposhtëm në Kur'an: "Një shenjë tjetër për ta është nata prej së cilës Ne e largojmë ditën dhe atëherë ata mbeten në errësirë." (Sure Ja Sin: 37) Në tretjen graduale të dritës ka diçka të fshehtë. Për shkak të këtij kalimi të ngadalshëm, qeniet e gjalla përshtaten lehtësisht ndaj ndryshimit të dritës dhe temperaturës midis ditës dhe natës dhe nuk kalojnë asnjë lloj vështirësie. Allahu, me diturinë dhe fuqinë e Tij të pamatë tregon mëshirë për robërit e Tij dhe po ashtu, për të gjithë qeniet e gjalla. Ai ua jep këtë mirësi të gjithë njerëzve, por shumica prej tyre nuk mendojnë për të as edhe njëherë të vetme gjatë jetës.

Kur besimtari, i cili jeton sipas vlerave të

Harun Jahja (Adnan Oktar)

Kur'anit, i vëren këto çështje, sheh edhe një provë të asaj që ka shpallur Allahu në vargun 92 të Sures Jusuf:

"Ai është më Mëshiruesi i Mëshiruesve."

Nuk ka dyshim se në ndërimin e ditës dhe të natës është një nga mirësitë e panumërta që ka dhuruar Allahu për njerëzit. Me qëllim që ta kuptojmë më mirë, Zoti ynë na tërheq vëmëndjen për këtë në Kur'an:

Thuaj: "Sikur Allahu t'ua bënte natën të përhershme deri në Ditën e Kijametit, ç'mendoni, cili Zot pos Allahut do t'u sillte juve dritë? A nuk merrni vesh?"

Thuaj: "Më tregoni, nëse Allahu ua bën ditën të vazhdueshme deri në Ditën e Kijametit, cili zot pos Allahut do t'ju sjellë natë që të pushoni në të? A nuk shihni? (sa po gaboni) (Sure Kasas: 71-72)

Allahu krijoi kushtet, ekuilibrat dhe sistemet e domosdoshme për ditën dhe natën, e në mungesë të ndonjërit pre tyre, vetëm Allahu mund të ndihmojë. Nëse Allahu do të kishte dashur, Ai do të kishte krijuar ditë apo natë të vazhdueshme, por, qeniet e gjalla nuk mund të mbijetonin nën të tilla kushte. E nëse do të krijoheshin ndonjëherë kushte të tilla, jeta në tokë do të merrte fund. Nuk ka dyshim se, është Allahu Ai që krijon ditën dhe natën me një rend të përsosur, duke siguruar një ambient në të cilin mbijetojnë të gjitha qeniet e gjalla. Kjo është një shenjë e mëshirës dhe dhembshurisë së Tij të pafund. Në vargun që pason, Zoti ynë thotë:

Po nga mëshira e Tij Ai iu bëri juve natën dhe ditën për të pushuar në të dhe për të përfituar nga begatitë e Tij, prandaj të jeni mirënjohës! (Sure Kasas: 73)

Por vetëm ata, të cilët venë në punë mendjen duke vërtetuar krijimin e Allahut, i frikësohen Atij; ata të cilët përsiatin mbi arsyet për ndërrimin e rregullt të ditës dhe të natës. Allahu e shpreh këtë në disa vargje:

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndryshimin e ditës dhe të natës ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. (Sure Ali Imran: 190)

Në ndërrimin e natës dhe të ditës dhe në çka krijoi Allahu në qiej e në tokë, vërtet ka fakte për njerëzit që kanë droje. (Sure Junus: 6)

Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t'u sjellë dobi njerëzve, në ujin që zbret Allahu prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në qarkullimin e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit dhe tokës, pra, (në të gjitha këto) sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt. (Sure Bekare: 164)

Allahu e ka krijuar metabolizmin e njeriut të tillë, që ka nevojë të pushojë gjatë natës dhe Ai e shpreh këtë në vargjet e mëposhtme:

Ai jua krijoi natën për të pushuar në të, kurse ditën për të parë dhe këtu ka shenja (argumente) për njerëzit që ua vënë veshin. (Sure Junus: 67)

Allahu e ka bërë natën që ju të pushoni, ndërsa ditën të ndritshme për të parë. Vërtet Allahu

Harun Jahja (Adnan Oktar)

është dhurues i madh ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës. (Sure Gafir: 61)

Përveç se është një kohë për pushim, nata ka edhe një cilësi tjetër të veçantë. Një nga arsyet për krijimin e natës është se, këto orë të paqes dhe qetësisë në botë, janë shumë frytdhënëse për disa vepra adhurimi. Po ta krahasojmë me kohën ditore aktive, koha e natës është më shtytëse për të menduar, lexuar dhe për t'u falur. Allahu e shpall këtë në Kur'an:

Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse, ngaqë ti ditën je vërtet shumë i zënë. Prandaj përmende emrin e Zotit tënd dhe përkushtoj krejtësisht Atij! (Sure Muzzemmil: 6-8)

Natën është më e lehtë të përqendrohesh për t'u thelluar rreth krijimit të Allahut, për të lexuar Kur'an dhe për t'u lutur. Një besimtar, i cili është i vetëdijshëm për këtë, nuk do ta kalojë gjithë natën në gjumë. Ai do t'i kthehet i vetëm Allahut në qetësi, për t'iu lutur për nevojat e tij dhe për t'i kërkuar falje për gabimet dhe të metat. Ai do ta rikthejë edhe një herë në mend ditën që kaloi, do rishikojë gabimet që bëri në të, do të pendohet dhe do të kërkojë falje. Ai do ta kalojë këtë kohë në një mënyrë me të cilën Allahu është i kënaqur, do ta përkujtojë Atë dhe do të afrohet te Ai. Gjithashtu, do të mendojë për shumë gjëra të tilla si: ekzistenca e Allahut dhe madhështia e Tij, Kur'ani, krijimi i jashtëzakonshëm i universit, gjallesat mbi tokë me sistemet e tyre të përsosura, mirësitë që Allahu krijon pandërprerë, Parajsa, Zjarri dhe përjetësia. Kjo sjellje e besimtarit, i cili falet natën, lavdërohet në disa vargje në Kur'an:

Dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë. (Sure Furkan: 64)

Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë dhe shpresë... (Sure Sexhde: 16)

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

A mund të krahasohet ai që falet natën duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?! Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!" (Sure Zumer: 9)

Në këtë mënyrë, besimtarët kanë vënë në praktikë Sunnetin e të Dërguarit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili kalonte një pjesë të natës në falje, meditim dhe adhurim. Kjo përmendet në një varg ku thuhet:

Natyrisht, Zoti yt e di se ti (o Muhamed) falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose të tretën e saj, si dhe sisa prej atyre që janë me ty... (Sure Muzzemmil: 20)

Hadithet e Profetit tonë, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, që kanë ardhur deri tek ne, thonë se ai lutej që Allahu t'i jepte karakter dhe sjellje të mirë; transmetohet se ai lutej me këto fjalë:

"O Allah, ma bëj trupin tim dhe sjelljen time të mirë. O Allah, më ruaj nga karakteri dhe sjellja e keqe." (Ihja Ulum-Id-Din nga Imam Gazali)


Nuk duhet të harrojmë se, siç e përmendëm më lart, gjumi i ngjan vdekjes dhe, nëse Allahu dëshiron, njeriu nuk ka mundësi të ngrihet më prej tij. Për këtë arsye, minutat e fundit para se të biem në gjumë, mund të jenë rasti i fundit për njeriun, që të kërkojë falje. Allahu e shpreh këtë në Kur'an:

Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj Ai ndal shpirtin e atij të cilit i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar. Me të vërtetë këto janë shenja për njerëzit që mendojnë. (Sure Zumer: 42)

Besimtari që zbaton këshillat e Kur'anit, e di vlerën e kësaj mundësie që i është dhuruar atij, ndoshta kjo edhe e fundit, para

Harun Jahja (Adnan Oktar)

se të bjerë në gjumë. Ai e mban këtë në mendje dhe afrohet tek Allahu singerisht; kërkon falje për gabimet, i lutet Allahut për ndihmë në të gjitha çështjet dhe vetëm Atij i drejtohet në qetësinë e natës.



Kapitulli 2

KËNDVËSHTRIMI KUR'ANOR I BESIMTARIT

Sjellja ndaj familjes dhe shokëve

Besimtari e falenderon Allahun kur sjell ndër mend krijimin e prindërve të tij, të cilët kanë kaluar aq shumë kohë dhe punë, duke u përkujdesur për të që në çastin kur hapi sytë dhe pa për herë të parë këtë botë. Një njeri që ve në jetë këshillat e Kur'anit, përpiket gjithmonë që të jetë i vetëdijshëm, se Allahu krijoi prindërit e tij dhe u fali atyre mëshirë dhe dhembshuri, e i frymëzoi ata me dashuri për fëmijët e tyre. Allahu ka krijuar lidhje dashurie midis prindërve dhe fëmijëve, të cilët ata i rrisin, nga foshnjëria e pafuqishme derisa bëhen të rritur të pavarur. Nga kjo lidhje dashurie, prindërit kurrë nuk lodhen dhe as u shterr kënaqësia e rritjes së fëmijëve, duke i parë ata të rriten. Allahu thekson rëndësinë e familjes në jetën e njeriut në vargun që vijon:

Ne e kemi urdhëruar njeriun që t'i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: "Bëju falenderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë. (Sure Lukman: 14)

Zoti ynë urdhëron në Kur'an që ne të sillemi mirë ndaj prindërve:


Thua ju: "Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëuar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit... (Sure En'am: 151)

Njeriun e kemi porositur të jetë e sjellshëm ndaj prindërve të vet. (Sure Ahkaf: 15)

Sipas këtyre vargjeve, besimtari duhet të tregojë mirënjohje dhe t'i trajtojë ata me respekt, me dashuri të thellë; i gëzon dhe përpiqet që t'ua fitojë zemrat gjithmonë me fjalë të buta e të mençura. Përsëri në Kur'an, Allahu na tregon se duhet të jemi të ndjeshëm kundrejt prindërve:

Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Tij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as "uh!", mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti. (Sure Isra': 23)

Në këtë varg, Allahu na jep të kuptojmë masën e mëshirës që duhet të tregohet ndaj prindërve. Me fjalët "mos u thuaj atyre as "uh!", mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti", Allahu i ka ndaluar besimtarët nga vepra më e vogël e mosrespektimit apo i lënies së tyre pas dore. Për këtë arsye, besimtarët sillen me kujdes ndaj prindërve, duke i respektuar dhe falur.



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Ata bëjnë ç'është e mundur për t'i rehatuar ata dhe përpiqen fort të mos mungojnë në respekt dhe vëmendje ndaj prindërve. Besimtarët mbajnë në mendje vështirësitë dhe shqetësimet e moshës së thyer dhe bëjnë të gjitha përpjekjet për t'u plotësuar çdo nevojë. Ata bëjnë gjithçka që kanë mundësi për t'u siguruar se prindërit e tyre janë rehat dhe i kanë të gjitha kushtet të plotësuar, si nga ana mendore ashtu edhe nga ajo fizike. Në çfarëdo lloj rrethane ata nuk rreshtin së trajtuari prindërit me respekt të thellë.

Ja tek është një situatë tjetër që mund të hasin besimtarët në marrëdhënie me prindërit. Një njeri besimtar mund të ketë prindër, të cilët kanë zgjedhur rrugën e mosbesimit. Në rastin e këtij dallimi në besim, besimtari i fton ata me po të njëjtin qëndrim të sjellshëm, përplot respekt, për të ndjekur rrugën e drejtë. Fjalët e Profetit Ibrahim (a.s.) ndaj babait të tij idhujtar, na tregojnë këtë mënyrë të sjelluri që duhet të shfaqim në të tilla rrethana:

O babai im, mua më ka ardhur prej diturisë çfarë s'të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë!

O babai im, mos adhuro djallin sepse ai është gjithmonë i pabindur ndaj të Gjithmëshirshmit. (Sure Merjem: 43-44)

Ka disa njerëz, të cilët kur i shohin prindërit e tyre të mplanten dhe të bëhen të pafuqishëm, u kthejnë shpinën kur ata kanë nevojë më shumë se kurrë për ndihmë dhe përkujdesje. Nuk është e vështirë të kuptohet, se një qëndrim i tillë është mjaft i përhapur në ditët e sotme. Shpesh hasim njerëz të moshuar, të cilët ndodhen në një situatë mjaft të vështirë shpirtërore dhe ekonomike, të harruar në vetmi në shtëpitë e tyre. Nëse do të mendoheshim pak për këtë gjendje, do të kuptonim se arsyeja fshihet në braktisjen e Fjalës së Allahut.

Ai që e pranon Kur'anin si udhërrëfyes, sillet ndaj prindërve, anëtarëve të tjerë të familjes dhe kujdo qoftë rreth tij, me mëshirë

dhe dhembshuri. Ai i fton të afërmit e tij, shokët dhe të njohurit e tjerë që edhe ata të përvehtësojnë vargjet e Kur'anit, sepse Allahu i urdhëron ata që besuan, që të fillojnë t'i ftojnë në Islam të afërmit e tyre:

Paralajmëroje farefisnin tënd më të afërm.

(Sure Esh-Shu'ara': 214)

Lumturi dhe gëzim, ka gjithmonë në një familje, që jeton sipas vlerave të Kur'anit, ashtu siç shprehet në Sunnetin e të Dërguarit, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Të bërtiturat, sharjet dhe grindjet që shohim sot në familjet e përçara, nuk mund të ndodhin kurrë në një bashkësi besimtarësh. Në një komunitet të tillë, secili e ka kënaqësi kur kalon kohën me familjen e tij. Fëmijët i trajtojnë prindërit me respekt dhe i duan me gjithë zemër. Prindërit i shohin fëmijët

si amanet nga Allahu dhe kujdesen për ta. Kur shqiptojmë fjalën familje, ngrohtësia, dashuria, siguria dhe mbështetja e ndërsjellë na vijnë menjëherë në mendje. Por, është e dobishme të theksojmë edhe njëherë, se kjo situatë e shkëlqyer mund të arrihet vetëm duke ju përmbajtur rrugës Islame, me besim të plotë dhe vendosmëri, duke iu frikësuar Allahut dhe me shpresë tek Ai.



Sjellja ndaj mirësive

Besimtarët, të cilët vërejnë me vëmendje ambientin që i rrethon, e kuptojnë se çdo gjë që shohin me sytë e tyre është mirësi prej Allahut. Ata e kuptojnë se gjithçka, nisur që nga sytë, veshët, trupi, llojet e ndryshme të ushqimit që hanë, ajri i pastër që thithin, shtëpitë, mallrat dhe pasuritë, sendet që disponojnë dhe madje që nga mikroorganizmat e deri tek yjet, gjithçka është vënë në shërbim të tyre. E këto mirësi janë shumë të mëdha për t'u numëruar. Ashtu siç thotë Zoti ynë në vargun e mëposhtëm, madje, nuk është e mundur të klasifikohen dhe të numërohen të gjitha këto mirësi:

Nëse do të përpiqeshit t'i numëronit mirësitë e Allahut nuk do të mundeshit. Allahu është Falës, Mëshirues. (Sure Nahl: 18)

Besimtari i ka të lejuara të gjitha mirësitë që i janë dhënë në këtë botë, por ai kurrë nuk mashtrohet nga to dhe si pasojë e kësaj, të jetojë larg nga Allahu, të mos e kujtojë botën tjetër apo të mos përfillë Librin e Allahut. Nuk ka rëndësi se sa shumë prona ka, pasuri, para', apo fuqi, etj. Këto të fundit, kurrë nuk e shtyjnë që ai të bëhet arrogant apo kryelartë; ato asnjëherë nuk mund ta çojnë atë

drejt braktisjes
së mësimeve
kur'anore. Ai është i
vetëdijshtëm se të gjitha
këto gjëra që ai ka në dorë janë
bekim prej Allahut dhe, nëse Ai dëshiron mund
t'ia marrë sërish, ashtu siç ia fali. Ai është gjithmonë i
ndërgjegjshëm se mirësitë e kësaj bote janë të
përkohshme dhe të kufizuara. Ato s'janë gjë tjetër, veçse
një sprovë ku ai provohet. Përtej kësaj, këto mirësi janë

gjurmë të imëta të mirësive të vërteta në
Parajsë.

Për dikë, i cili praktikon
urdhërat e
Kur'anit,

mirësitë e kësaj
bote si pasuria, pronat
dhe pozita janë vetëm mjete për t'u afruar
tek Allahu dhe për ta falenderuar Atë. Për këtë
arsye, qëllimi i tij nuk është shtënia në dorë e
pasurive të kësaj bote, të cilat ai e di se do t'i gëzojë
vetëm për një kohë të kufizuar. Për shembull- një nga
mirësitë që zgjatin më tepër, e cila shfrytëzohet në jetën e
kësaj bote është shtëpia, po edhe ajo i hyn në punë vetëm
për disa dekada. Kur jetës së tij në këtë botë i vjen fundi, ai
largohet duke lënë shtëpinë që donte dhe kishte punuar aq
shumë për ta patur, gjatë gjithë jetës së tij. Nuk ka dyshim se vdekja
shënon ndarjen përfundimtare midis njeriut dhe mirësive të tij të
kësaj bote.

Besimtari e di se Allahu është Zotëruesi i vërtetë i mirësive që i
janë falur dhe se ato vijnë vetëm prej Tij. Ai bën ç'është e mundur
për ta falenderuar dhe shprehur mirënjohje ndaj Zotit, i Cili krijoi
këto mirësi. Si mirënjohje për mirësitë e tij të panumërta, besimtari
përpiket gjithmonë për ta falenderuar me fjalët dhe veprat e tij, për

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

t'i përkujtuar mirësitë e Allahut, për t'i pasur ato gjithmonë në mendje dhe për t'u treguar edhe të tjerëve për to. Ja disa vargje që bëjnë fjalë për këtë:

E, sigurisht që Zoti do të të japë ty sa të jesh i kënaqur. A nuk ishte jetim e Ai të dha strehë? A nuk të gjeti të paditur e të udhëzoi? A nuk ishte ti nevojtar e të bëri mos ia kishe nevojën askujt? Prndaj mos e shtyp jetimin, lypësin mos e shty me ashpërsi. Dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd! (Sure Duha: 5-11)

A po çuditëni që këshilla e Zotit tuaj t'ju vijë nëpërmjet një njeriu prej jush, i cili ju tërheq vërejtjen? Kujtoni që Ai ju bëri zëvendës pas popullit të Nuhut dhe ju dha trup dhe fuqi të madhe. Kujtoni dhuntitë e Allahut në mënyrë që të keni sukses. (Sure A'raf: 69)

Ka disa njerëz, të cilët presin që t'u vijë ndonjë mirësi e veçantë apo t'u zgjidhet ndonjë problem i madh që kanë, e pastaj të falenderojnë. Po, nëse do të ndaleshin dhe të mendonin për një çast, do ta kuptonin se çdo moment i jetës së tyre është i mbushur me mirësi. Vazhdimisht, pandërprerë, mirësi të panumërta na falen;

jeta, shëndeti i mirë, zgjuarsia, mendja, ndërgjegjja, të pesë shqisat dhe ajri që thithim. Ndaj për secilën nga këto mirësi, ne duhet të shprehim falenderim. Njerëzit, të cilët janë të pakujdesshëm në përkujtimin e Allahut dhe përkujtimin e fakteve të krijimit të Tij, nuk e kuptojnë vlerën e mirësive që u janë dhuruar në kohën kur i kanë ato; ata nuk falenderojnë për të shprehur mirënjohje

për to, por e kuptojnë vlerën e tyre vetëm kur u merren.

Ndryshe ndodh me besimtarët. Ata e kuptojnë se sa të pafuqishëm janë dhe sa në nevojë për këto mirësi, ndaj gjithmonë e falenderojnë Allahun për to. Besimtarët nuk e falenderojnë Allahun vetëm për shëndetin, pasurinë dhe pronat; por, duke e ditur se Allahu është Pronari i vërtetë dhe Mbizotërues mbi gjithçka, ata e falenderojnë Zotin e tyre për shëndetin, pamjen e tyre të bukur, diturinë që kanë fituar, zgjuarsinë, për dashurinë që kanë për besimin e tyre dhe urrejtjen ndaj mosbesimit, për qenien e tyre në rrugë të drejtë, për shoqërinë me besimtarët e singertë, për të kuptuarit e tyre, perceptimin dhe depërtimin në thellësi të gjërave dhe për forcën e tyre shpirtërore dhe fizike. Kur shohin ndonjë pamje të bukur, ata menjëherë e falenderojnë Allahun, apo kur kryejnë mirë punën, kur marrin diçka të cilën e kanë dashur, kur dëgjojnë një fjalë të mirë apo kur shohin shfaqje dashurie dhe respekti dhe të tjera mirësi të ngjashme, të cilat janë të shumta për t'u përmendur. Ata e përkujtojnë Atë si Mëshiruesin, Mëshirëbërësin.

Nëse besimtari me mirënjohjen që shpreh, tregon se mirësitë që i janë dhuruar nuk e bëjnë atë aspak të pangopur, mendjemadh apo arrogant, Allahu ia shton ato. Fjala e Allahut në Kur'an flet për këtë:

(Kujtoje) kur Zoti juaj kumtoi: "Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t'ua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia; por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia

(atëherë) dijeni se dënimi Im është i rëndë". (Sure Ibrahim: 7)



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Po ashtu, të gjitha mirësitë që ka njeriu janë pjesë e sprovës së tij në këtë botë. Për këtë arsye, njerëzit që kanë besim, krahas falenderimit që shprehin, i përdorin mirësitë e dhuruara sa të kenë mundësi, në kryerjen e veprave të mira; ata nuk dëshirojnë të jenë kopracë dhe as magazinë pasurie. Kjo për arsye se, grumbullimi dhe mos ndarja e pasurisë janë cilësi e njerëzve të Zjarrit. Zoti ynë na tërheq vërejtje për këtë në Kur'an:

Por, jo (fajtori do të hidhet në zjarr)! Ai është zjarr flakërues, që e shkul (dhe e djeg krejtësisht) skalpin e kokës. Ai thërret këdo që (i) ka kthyer shpinën e (i) është larguar (besimit), dhe që ka grumbulluar (pasuri) dhe e ka fshehur. Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm: kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort, por, kur i bie e mira, ai bëhet koprrac. (Sure Mearixh: 15-21)

Si përgjigje për pyetjen se çfarë duhet të japin njerëzit, Allahu thotë që njeriu të falë **"atë pjesë të pasurisë që i tejkalon nevojat"** (Sure Bekare: 219) Është urdhër i Kur'anit, që besimtarët të lenë mënjanë një pjesë të fitimeve të tyre që i tejkalon nevojat, për t'u përdorur për vepra të mira ashtu si na udhëzon Allahu. Minimumi ligjor i kësaj pjese është zekati i detyrueshëm, i cili mbidhet nga sunduesi apo udhëheqësi i komunitetit për t'iu shpërndarë të varfërve dhe nevojtarëve dhe atyre, të cilët Allahu i përmend në

vargun kur'anor për zekatin. Të japësh tej kësaj shume nuk është e detyrueshme, por është shumë e lavdërueshme.

Sigurisht që, mënyra e falenderimit të besimtarëve për mirësitë që kanë, do të jetë përdorimi i tyre për të fituar kënaqësinë e Allahut. Muslimani është

përgjegjës për shfrytëzimin e asaj që i është dhënë në kryerjen e veprave të mira, të cilat i ka urdhëruar Allahu. Krahas shfrytëzimit të mjeteve materiale që i ka falur Allahu, ai e vë në punë trupin e tij, për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe për të punuar në rrugën e Tij, e në këtë mënyrë, shpreson të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe mëshirën e Tij; shpreson të fitojë mirësitë e pashtershme të Parajsës:

Allahu ka blerë prej besimtarëve shpirtat e tyre dhe pasurinë e tyre me Xhennet. (Sure Teube: 111)

Një komunitet individësh, të cilët zbatojnë urdhërat e Kur'anit dhe Sunnetit të Krijesës më të mirë, pagja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, me pagesën e tyre të zekatit dhe lëmoshave të tjera vullnetare, do të largojnë dhunën, vjedhjen e vepra të tjera kriminale dhe të shëmtuara, të shkaktuara prej varfërisë, urisë, skamjes dhe prej problemeve të tjera të këtij lloji. Në këtë mënyrë, në dashtë Allahu, do të mbretërojë qetësia shpirtërore dhe mirëqenia.

Sjellja ndaj bukurisë

Për faktin se pasuria, shkëlqimi dhe bukuria janë cilësi të Parajsës, imitimi i tyre në këtë botë ua sjell ndër mend atë. Kjo e shton dëshirën dhe padurimin e besimtarëve për ta arritur atë; përkundrazi, mosbesimtarët i vihen me gjithë shpirt përfitimit të saj në këtë botë dhe nuk i kushtojnë vëmendje jetës tjetër.

Gjithçka - që nga lumenjtë e pashterrshëm, vendet me bukuri të rrallë, bukuria njerëzore,

kompozimet estetike dhe veprat mahnitëse të artit, të gjitha janë mirësi dhe bekime që Allahu ua fal njerëzve. Në secilën nga këto mirësi në jetën e kësaj bote ka nga një shenjës të krijimit të Allahut. Besimtari e sheh gjithë bukurinë e kësaj bote si një pasqyrim të një origjinali, si një model dhe si paralajmërim të një sihariqi:

Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshtet e xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që atyre u jepet si ushqim ndonjë frut i kopshteve, ata do të thonë: "Këtë e kemi ngrënë edhe përpara". Por atyre do t'u jepen vetën fruta të ngjashme me ato të tokës. Në Xhenet ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe atje do të jetojnë përgjithmonë.
(Sure Bekare: 25)

Shumë nga bukuritë e jetës tjetër u ngjajnë atyre që janë në këtë botë; ato janë shumë më të përsosura se mirësitë e tokës dhe janë të përfjetshme, të pashtershme. Allahu ka krijuar një Parajsë të përkryer, të veshur me mirësi të panumërta. Një njeri që mbart në vetvete vlerat e mësuara nga Kur'ani do të meditojë thellë mbi krijimin dhe përsosmërinë e Parajsës në gjithçka që i ze syri. Kur hedh vështrimin në qiell, ai do të mendojë për "një Kopësht të gjerë sa qiejt dhe toka" (Sure Ali Imran: 133); kur sheh shtëpitë e bukura, ai do të mendojë për "dhomat e larta në Parajsë me lumenj që rrjedhin poshtë tyre,"

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

(Sure Ankebut:58); kur sheh gurët e çmuar me ndriçim verbues do t'i shkojë mendja për zbukurimet e Parajsës **"byzylykë prej ari dhe perla"** (Sure Fatir: 33); kur shikon rroba të bukura dhe të hijshme, atij do t'i vijnë ndër mend rrobat e Parajsës **"prej mëndafshi të hollë dhe të trashë"** (Kehf:31); kur të shijojë ushqimet dhe pijet e ndryshme do të mendojë për **"lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar..."** (Muhamed: 15); kur të vështrojë kopshtet e gjelbëruara do t'i vijë ndër sy Parajsa **"me ngjyrë të gjelbër e mbyllur në të zi"** (Sure Rrahman:64); kur të shohë mobilje tërheqëse do t'i vijnë ndër mend **"divane të stolisura me ar e gurë të çmuar..."** (Sure Uakia: 15) në Parajsë.

Arsyeja që frymëzon këtë ndërmendje është se, të gjitha gjërat e bukura në këtë botë, për besimtarin, janë burim kënaqësie të pamatë dhe njëkohësisht edhe një rast për të shprehur mirënjohje, i pati apo ajo. Po aq, ato janë një burim i pashtershëm kënaqësie që

do t'ia rrisin padurimin për të parë Parajsën, duke shtuar përpjekjet për ta fituar atë.

Besimtari që mbart në shpirt këshillat e Kur'anit, nuk bëhet ziliqar apo rrebel ndaj dikujt që është më i pasur apo më tërheqës se ai. Për shembull, ndryshe nga shumë njerëz, atij nuk do t'i vijë keq nëse nuk ka shtëpi të bukur sepse një nga qëllimet e jetës së tij është të arrijë bukurinë e përjetshme, jo atë kalimtare; shtëpia e tij e vërtetë është Parajsa. Allahu na tërheq vëmendjen për këtë në Kur'an:

Thuaj: "Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu; Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët!" (Sure Teube: 51)

Ata, të cilët i shmangen Fjalës së Kur'anit, e shumëzojnë me zero të vërtetën se shtëpia e tyre e vërtetë është Parajsa, kësisoj, tërhiqen të etshëm ndaj kënaqësive të kësaj bote. Qëllimet e tyre kryesore janë që njerëzit të flasin mirë për ta, të respektohen dhe t'u



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

jepet rëndësi në të drejtën e tyre, të shtojnë sa më shumë pasurinë dhe të bëjnë një jetë të begatë. Gjatë gjithë jetës vrapojnë pas gjërave kalimtare, të parëndësishme dhe mashtruese të kësaj bote. Kur shohin gjëra të bukura që nuk i kanë në dorë, vetëm sa u shtohet zilia, grykësia dhe dëshpërimi. Ata e kanë vështirë të gjejnë kënaqësi kur ndodhen në një shtëpi të bukur, por që nuk u përket. Mendjet e tyre turbullohen nga pyetje si: "Pse nuk jam unë kaq i pasur?" dhe "Pse të mos kem edhe unë një shtëpi kaq të bukur sa kjo?" Për të tillë njerëz, gjërat e bukura në këtë botë janë vetëm një burim shqetësimi, me vramendjen si të kenë më shumë.

Ndodh ndryshe me njerëzit, të cilët udhëhiqen nga busulla e Kur'anit. Ata dinë t'i vlerësojnë gjërat e bukura, pavarësisht nëse i kanë apo jo. Për shembull, një person me besim, mund të mos jetojë në një lagje të pasur e ndoshta mund të mos ketë parë kurrë një të tillë. Por, ai e kupton se pas gjendjes së tij fshihet një arsye hyjnore. Besimtari nuk ka nevojë të shkojë t'i shohë vende të tilla, për të parë bukuritë e krijimit të Allahut. Me perceptimin dhe të kuptuarit e tij të veçantë, besimtari arrin t'i shquajë bukuritë e pashembullta të Tij në çdo vend dhe në çdo kohë.

Shkëlqimi i yjeve natën dhe bukuria e pashoqe e tyre, ngjyra dhe forma e një trëndafili, janë vetëm dy shembuj, të cilët çdokush mund t'i shohë dhe t'i vlerësojë përditë.

Siç thamë më sipër, malli që ndjejnë besimtarët për Parajsën, i bën ata t'i shndërrojnë ambientet e tyre në vende që ua sjellin ndër mend atë. Parajsa është vendi i një pune arti më të lartë se ç'mund të imagjinohet, e peisazheve të përsosura dhe bukurive, të cilat asnjëri mbi tokë nuk mund t'i përfytyrojë. Muslimani, i cili ndjek këshillat e Kur'anit, do të përdorë të gjitha mundësitë për ta zbukuruar ambientin e tij. Ne mësojmë nga Kur'ani, se kopshti i Sulejmanit a.s. ishte i shtruar me xham (Sure Neml: 44) dhe shtëpia e tij ishte dekoruar me harqe të mëdha dhe statuja, enë të gjera si puse dhe kazanë të mëdhenj të palëvizshëm (Sure Sebe:13). Në Kuran, Allahu thotë se familjes së Ibrahimit (a.s.) i ishte dhënë një mbretëri e madhe (Sure Nisa:54).

Megjithë pozicionin e lartë që kishin dhe, ndonjëherë, edhe pronat e shumta e fuqinë që u ishte dhënë, të dërguarit e Allahut i përdornin këto mirësi ashtu siç u ishte urdhëruar nga Allahu dhe sipas vullnetit të Tij. Për këtë arsye, ata lavdërohen në Kuran.

Besimtarët i marrin të gjithë profetët si shembuj dhe kujdesen, ashtu siç bëjnë edhe Eulijatë (miqtë e ngushtë të Allahut) për ta shfrytëzuar çdo mirësi që u vjen për të arritur kënaqësinë e Tij.

Reagimi kundrejt ndodhive në dukje negative

Njeriut mund t'i ndodhin vështirësi të ndryshme përgjatë ditës. Çfarëdo lloj vështirësish që të hasë, besimtari i mbështetet Allahut dhe mendon: "Allahu na sprovon ne në gjithçka që bëjmë dhe mendojmë në jetën e kësaj bote. Kjo është një e vërtetë shumë e rëndësishme, të cilën duhet ta kemi gjithmonë parasysh. Ndaj, kur të hasim vështirësi në diçka që bëjmë, apo kur mendojmë se gjërat nuk po shkojnë ashtu si presim, nuk duhet të harrojmë se Zoti ynë na i ka vendosur këto vështirësi në rrugën tonë, për të provuar sjelljen tonë."

Në Kuran, Allahu thotë se çdo vështirësi që has njeriu vjen prej Tij.


Thuaj: "Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu; Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët. (Sure Teube: 51)

Gjithçka që hasim në përvojën tonë është vendosur nga Allahu dhe është e mirë për besimtarin në këtë botë edhe në tjetrën; kjo është e qartë për çdo njeri i cili sheh me syrin e besimit (Për detaje më të hollësishme shih: Në Gjithçka Ka Mirësi, nga Harun Jahja, Islamic Book Service 2003). Për shembull, një përkujtim i mirë është edhe kur një besimtar humb ndonjë pjesë prej pasurisë së tij të dashur. Nga pamja e jashtme kjo duket se është një fatkeqësi, por ky mund të jetë mjeti me anë të të cilit ai mund të dallojë gabimet e tij, të pastrojë ndërgjegjjen e tij dhe të kuptojë se duhet të marrë masa në disa çështje. Një anë tjetër e dobishme e kësaj lloj fatkeqësie është se, ajo e përkujton njeriun se ai nuk posedon asgjë; pronari i vërtetë i të gjitha gjërave është Allahu.

Kjo vlen për çdo gjë, të madhe apo të vogël, që ndodh gjatë

jetës së përditshme. Për shembull, si pasojë e një keqkuptimi apo moskokëçarjes së njeriut, një pagesë mund të bëhet gabimisht; një punë e zgjatur para një kompjuteri, mund të humbë në një çast, prej mungesës së energjisë elektrike; një student i ri mund të sëmuret dhe mund të mos hyjë në provimin e universitetit, për të cilin ai kishte kaluar aq shumë kohë për t'u përgatitur; një njeri mund të presë në rradhë për ditë të tëra për shkak të zvarritjeve burokratike, pa i plotësuar dot dokumentat; një njeri që ka një punë urgjente diku, mund të humbasë autobusin apo aeroplanin... Këto janë disa lloj ngjarjesh që mund të ndodhin në jetën e çdo njeriu dhe duken si pengesa të vështira, në pamje të parë.

Pikërisht, në këto ngjarje ka këshilla për dikë që ka besim. Mbi të gjitha, besimtari mban në mendje faktin, se Allahu e provon sjelljen dhe durimin e tij. Ai ndërmend se një ditë do të vdesë dhe është pa peshë për të, të ndalet gjatë në këto vështirësi - ai do të përgjigjet përpara Allahut në jetën tjetër. E di se çdo gjë që i ndodh e ka me vete një shirit të argjendtë, ndaj nuk e lëshon zemra kurrë, por i lutet Allahut që t'ia lehtësojë punën dhe t'ia kthejë gjithçka për së mbari. Dhe kur



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

vjen lehtësimi pas vështirësisë, e falenderon Allahun që ia ka pranuar dhe i është përgjigjur lutjes së tij.

Një njeri që e fillon ditën me këtë përkujtim, çfarëdo që t'i ndodhë, - rrallë mund ta humbasë shpresën, apo të bëhet ankthioz, i frikësuar, a i dëshpëruar. Edhe nëse harron për një çast, kujtohet dhe i kthehet Allahut. Ai e di se Allahu i ka krijuar këto gjëra për një qëllim të mirë dhe dobiprurës. Nuk do të mendojë në këtë mënyrë vetëm kur t'i ndodhë diçka e rëndë, por, siç e përmendëm më sipër, në gjithçka - të madhe apo të vogël, që i ndodh në jetën e përditshme.

Imagjinoni një njeri, i cili nuk arrin përparimin e duhur në një punë të rëndësishme; në minutën e fundit kur ai sapo bëhej gati ta mbaronte, has një problem serioz. Atëherë ai shpërthen në inat, mbërthehet nga ankthi, ndihet faktkeq dhe shfaq sjellje të tjera negative.

Ndërsa muslimani që beson se në çdo gjë ka mirësi, do të përpiket të zbulojë se çfarë po i tregon Allahu me këtë që i



ndodhi. Ai mund të mendojë se Allahu ia tërhoqi vërejtjen, që ai të ndryshojë diçka. Kësisoj, do të bëjë gjithë përgatitjet e nevojshme dhe do të falenderojë Allahun, që ndoshta e ka mbrojtur me këtë që i dha, nga ndonjë e keqe më e madhe.

Nëse atij i ikën autobusi kur do të shkojë diku, do të mendojë se duke u vonuar apo duke mos hipur në atë autobus ai mund të ketë shpëtuar nga një aksident apo ndonjë fatkeqësi tjetër. Këto janë vetëm disa shembuj, të cilët mund të shumëfishohen në jetën e një njeriu. Mbetet e rëndësishme të ruhet vetëdija se planet e njeriut mund të mos shkojnë ashtu siç i do ai. Çdokush mund ta gjejë veten në një mjedis krejt tjetër nga ai që kishte planifikuar, por kjo kthehet në dobi për dikë që ia dorëzohet Allahut dhe, kështu, përpiqet të gjejë një arsye hyjnore për gjithçka që i ndodh. Në Kur'an, Allahu shpall vargun që vijon:

Por, mund ta urreni një gjë ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini. (Sure Bekare: 216)



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Ashtu siç thotë Allahu, ne nuk dimë se çfarë është e dobishme dhe çfarë është e dëmshme - Zoti e di. Prandaj njeriu duhet t'i afrohet Allahut dhe t'i dorëzohet Atij, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.

Në jetën e tij e tij në këtë botë, njeriu mund të humbë brenda një çasti gjithçka që zotëronte. Mund t'i digjet shtëpia, investimet e tij mund të gjenden në krizë ekonomike, apo mund të humbë pasurinë për shkak të një aksidenti. Allahu thotë në Kur'an se njerëzit do t'i provojnë këto lloj sprovash:

Sigurisht që Ne do t'ju sprovojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave. Prandaj, përgëzoji të duruarit. (Sure Bekare:155)

Ai u tregon njerëzve se ata do t'i nënshtrohen sprovave të ndryshme dhe do të marrin shpërblim të madh për durimin e tyre

në situata të vështira. Për shembull, një

njeri humb diçka, të cilën nuk mund

ta gjejë më; durimi që përshkruan

Allahu në Kur'an, quhet kur një

njeri e vendos plotësisht

vetveten në duart e Allahut

prej momentit që mëson se

pronat e tij qofshin të vogla

apo të mëdha, kanë

humbur. Ai nuk e heq nga

mendja faktin se Allahu ka

krijuar gjithçka dhe për këtë

arsye, nuk lejon që sjellja

apo qëndrimi i tij të

çrregullohen.

Njeriu mund

të pësojë edhe

humbje më të



Unë mbështetem te Zoti
im dhe Zoti juaj.
S'ka asnjë gjallesë që të mos
jetë në pushtetin e Tij.
Me të vërtetë, Zoti im është
në rrugë të drejtë.
(Sure Hud: 56)

mëdha gjatë një dite. Nëse dikush humb të ardhurat e një dite, për të cilat kishte harxhuar gjithë ditën në mënyrë që të plotësonte nevojat,- kjo është e vështirë për dikë që beson se e ardhmja e tij varet nga kjo. Shumë njerëz ushqehen që nga fëmijëria me qëllimin e e arritjes së një vendi pune të mirë. Ata kalojnë çdo moment të jetës së tyre duke dashur një punë më të mirë apo përparim në punën që kanë. Kështu, nëse ata humbin punën, ditët e tyre mbushen me dëshpërim, ankth dhe jeta e tyre kthehet, siç thonë ata, përmbys.

Nga ana tjetër, besimtari e di se është Allahu Ai, i Cili i jep atij ushqimin e përditshëm dhe këto të ardhura ditore janë vetëm për këtë qëllim. Me fjalë të tjera, për besimtarin, mirësitë që i ka dhënë Allahu janë vetëm një mjet. Për këtë arsye, nëse një njeri me besim humb burimin e të ardhurave të tij, do ta pranojë këtë fakt me durim dhe nënshtrim. Në rrethana të tilla, ai do të tregohet i duruar dhe do të lutet dhe do t'i nënshtrohet Allahut. Ai kurrë nuk harron se është Allahu, Ai që ia jep ushqimin e përditshëm dhe Ai mund t'ia marrë kur të dëshirojë.

Një njeri që e merr Kur'anin si udhërrëfyesin e tij, menjëherë do të kontrollojë mendimet dhe veprimet nëse i ndodh diçka e

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

tillë, apo ndodhet në vuajtje për diçka, a nuk mund të studiojë në shkollën që donte e rrethana të tjera të ngjashme. Ai do të ndalet të shikojë me vëmendje sjelljen e tij, a e kënaq Allahun dhe në kokë mund t'i vërshej këto pyetje:

-A isha falenderues sa duhet për pasurinë që humba?

-A isha mosmirënjohës për mirësinë që më ishte falur?

-A e harrova Allahun dhe botën tjetër duke qenë shumë i lidhur me pasurinë dhe pronat e mia?

-Mos u tregova mendjemadh apo kryelartë për shkak të pasurisë sime dhe dola nga rruga e Allahut dhe nga urdhërat e Kur'anit?

-Mos po përpiquesha të fitoja admirimin e të tjerëve në vend që të kërkoja kënaqësinë e Allahut, apo kërkoja të kënaqja dëshirat dhe ëndrrat e mia?

Muslimani këtyre pyetjeve u jep një përgjigje të sinqertë. Sipas këtyre pyetjeve ai do të përpiket ta përmirësojë sjelljen e tij, e cila nuk e kënaq Allahun dhe do t'i lutet Atij ta lehtësojë në këtë. Do t'i afrohet Allahut me sinqeritet të plotë, do të gjejë strehë tek Ai, prej gjithë të këqijave që ka vepruar për shkak të harresës apo sjelljes së gabuar. Në Kur'an, Allahu e përshkruan si luten këta besimtarë:

Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që

punon. Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu siç i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!" (Sure Bekare: 286)

Duke u sprovuar, një njeri mund të pësojë shumë humbje njëra pas tjetrës. Por, një person me besim të thellë e di se për atë që po vuan, ka një arsye. Një nga arsyet më të rëndësishme është strëvitja shpirtërore me vështirësitë:

Kur ju morët malin dhe nuk i vinit vesh askujt, të Dërguarin e kishit prapa e ju thërriste, Allahu ju dënoi me dëshpërim pas dëshpërimit, që të mos pikëlloheni as për atë që ju doli duarsh, as për atë që ju goditi. Allahu di gjithçka që punoni ju. (Sure Ali imran: 153)

S'ka fatkeqësi që e godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në libër (Leuhi Mahfudh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Sure Hadid: 22-23)

Për besimtarin, situatat e vështira që ndodhin njëra pas tjetrës gjatë ditës, janë mjet me anë të të cilit ai kupton se ndodhet në sprovë për t'ju afruar Allahut, për t'u pjekur dhe për të përqafuar vlerat e Kur'anit. Ai është i vetëdijshëm se Allahu po e stërvit atë në këtë mënyrë dhe po e përgatit për mirësitë e përvetshme në jetën që vjen pas kësaj.

Qëndrimi gjatë sëmundjes

Një njeri i vetëdijshëm për besimin e tij do të tregohet i durueshëm dhe do t'i nënshtrohet Allahut kurdoherë që sëmuret, sepse ai e kupton se sëmundja e tij është vetëm një sprovë nga Allahu, ashtu siç e kupton se edhe shëndeti është sprovë prej Tij. Ai e ka të qartë se sprovat dhe fatkeqësitë janë test nga Allahu ashtu siç është shëndeti i mirë, pasuria dhe rehatia dhe, me të vërtetë, këto të fundit janë ndoshta më të rënda, më serioze dhe më të vështira. Për këtë arsye, sado në vështirësi që të ndihet, do të tregohet i patundur dhe do të vazhdojë t'i lutet Allahut me sinqeritet. Ai e di se është Allahu, Ai që e ka krijuar sëmundjen dhe, po ashtu, është Allahu Ai, i Cili e sjell shërimin. Në Kur'an, Allahu e lavdëron durimin e besimtarit gjatë sëmundjes dhe e ve atë mes cilësive të "devotshmërisë së vërtetë":

E, atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun. (Sure Bekare:177)

Ndërsa e përjeton sëmundjen me durim, ai do të marrë edhe mjekimin e nevojshëm për shërim. Ai nuk preket dhe nuk e ngre zërin me ankesë për të tërhequr vëmendjen e atyre që ka përreth, por merr me kujdes trajtimin dhe ilaçet e nevojshme për sëmundjen që ka. Kjo sjellje është si lutje drejtuar Allahut. Për arsye se ai jeton sipas këshillave të Kur'anit, lutet vazhdimisht që Allahu ta ndihmojë dhe ta lehtësojë. Në Kuran, Allahu na jep Ejjubin (a.s.) si shembull të kësaj sjelljeje që buron vetëm nga besimi:

(Kujtoje) Ejjubin, kur ju lut Zotit të vet: "Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!" (Sure Enbija:83)

Duhet të shtojmë këtu se, të gjitha ilaçet që merren janë mjet që të çojnë drejt shërimit. Nëse Allahu dëshiron, Ai do ta bëjë trajtimin me to, mjet shërimi. Është Ai, i Cili ka krijuar mjetet mjekësore të

terapive – mikroorganizmat, materialet me prejardhje bimore dhe shtazore të përdorura në përbërjen e ilaçeve. Shkurtimisht, është Ai, i Cili sjell shërimin. Në Kur'an, Allahu na tërheq vërejtjen për këtë me fjalët e Ibrahimit (a.s.):

(Zoti im) I Cili kur sëmurem më shëron. (Sure Shuara:80)

Përkundrazi, ata që i përkasin një shoqërie pa besim, menjëherë rebelohen kur sëmuren. Ata sillen plotësisht në kundërshtim me realitetin e vendimit të Allahut kur thonë: "Po pse më ndodhi pikërisht mua kjo gjë?" Një njeri që mendon në këtë mënyrë nuk mund t'i dorëzohet Allahut gjatë sëmundjes apo ta shohë atë si mirësi.

Besimtarët reflektojnë për arsyen e sëmundjes së tyre dhe e shohin atë si një mundësi të mirë për t'iu afruar Allahut. Edhe një herë ata përkujtojnë se sa bekim i madh është shëndeti i mirë dhe sa të pafuqishëm janë njerëzit. Edhe një sëmundje e lehtë si gripi, mund ta shtrijë një njeri të fortë në shtrat. Në këtë gjendje, sado të fuqishëm, të respektuar apo të pasur të jemi, bëhemi të pafuqishëm dhe na duhet të pushojmë dhe të marrim ilaçet. Në këto rrethana, ne na vjen ndër mend edhe një herë sa shumë nevojë kemi për Allahun dhe sëmundja është një mjet për ta përmendur emrin e Allahut dhe për t'iu afruar Atij. Për besimtarin, çdo sëmundje është një paralajmërim se kjo botë është e përkohshme dhe se vdekja dhe bota tjetër janë afër.



Qëndrimi i shfaqur në situata të vështira dhe të pafavorshme

Kohë pas kohe njeriu mund ta gjejë veten në situata të papërshtatshme, si për shembull në një qoshe rruge ku mbeturinat janë bërë mal, në një kuzhinë me erë të keqe apo në vende të ngushta, të errëta dhe plot lagështi. Për besimtarin, edhe vendet e pisëta dhe shqetësuese kanë qëllimin e tyre në krijim. Këto lloj vendesh e përkutojnë besimtarin për Zjarrin dhe vuajtjet në atë vend, pislleku i të cilit ia kalon edhe më të madhit në këtë botë. Në Kur'an, Allahu shpall se Zjarri është vendi i errësirës, pisllekut dhe ndyrësisë:

E ai është vendbanim dhe vendstrehim i keq. (Sure Furkan: 66)

Po njerëzit e së majtës – sa të poshtëruar janë fatkeqët! Ata do të jenë në afshin përcëllues të zjarrit dhe ujit të valuar dhe nën hijen e një tymi të zi, e cila nuk do të jetë as e freskët e as e këndshme. (Sure Uakia:41-44)


E kur të hidhen në një vend të ngushtë të tij, të lidhur duarsh, do të luten për shkatërrimin (e vet). "Mos e kërkonti sot shkatërrimin vetëm një herë, por kërkojeni shumë herë!" (Sure Furkan: 13-14)

Një njeri që sjell ndër mendje këto vargje, menjëherë do të lutet që Zoti ta shpëtojë atë nga dhimbjet e Zjarrit dhe do të kërkojë falje për gjërat ku ka gabuar.

Ashtu siç e përshkruan Allahu në Kuran, Zjarri është një vend që kundërmon erë të keqe, i ngushtë, i zhurmshëm, i errët, i zi, i zhytur në lagështi dhe i mbushur me tym. Në të ka vende edhe më të rrezikshme dhe një nxehtësi përvëluese që depërton çdo qelizë të trupit. Zjarri ka ushqimin dhe pijen më të

Harun Jahja (Adnan Oktar)

pështirë. Rrobat në të janë prej zjarri dhe të gjitha dhimbjet në të janë të padurueshme. Ai është një vend ku digjet lëkura, një vend ku njerëzit luten me përgjërime që të dalin prej andej, madje edhe të vdesin për t'i shpëtuar dhimbjeve, ndonëse tashmë kanë vdekur njëherë e nuk mund të vdesin më. Në disa drejtime, zjarri mund të krahasohet me këtë botë, siç paraqitet në filmat që përshkruajnë luftën atomike. Por, errësira që përshkruhet në ato filma nuk mund të krahasohet me pisllekun e tejskajshëm dhe ambientin tmerrues të Zjarrit. Ky është vetëm një krahasim, sepse Zjarri është shumë më i keq, më i tmerrshëm se çdo vend i keq që mund të imagjinojmë në këtë botë.



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Vendet e ndryshme në këtë botë, që janë të ngushta të pisëta, të errëta dhe të nxehta janë shumë të vështira për t'u provuar nga njerëzit. Në Zjarr, atmosfera e frikës është shumë më e keqe. Ata njerëz që kanë shpikur metoda për mbrojtje nga nxehtësia do të mbeten të pafuqishëm në Zjarr. Ai është më i nxehtë se sa shkretëtira më e nxehtë, më shqetësues dhe më i pistë se sa pusi më i errët dhe vendi më ngulfatës që mund të imagjinohet. Ashtu siç na tregon Zoti ynë në Kur'an, nxehtësia e tij depërton çdo qelizë të trupit. Për ata që kanë kryer vepra të këqija, nuk ka mbrojtje apo shpëtim nga nxehtësia përcëlluese. Po ashtu, në Zjarr shqisat janë shumë më të forta se në këtë botë. Këtu, shumica e dhimbjeve dobësohen pas pak, plagët shërohen, madje edhe shenjat e lëna nga një djegie shumë e madhe dhe e dhimbshme shërohen me kalimin e kohës. Ndërsa një njeri në Zjarr i ndjen sëmbimet e tij vazhdimisht dhe shumë dhembshëm dhe kjo është një torturë që nuk mbaron, derisa të dëshirojë Allahu.

Në shembujt që përmendëm më lart, mund të tregojmë edhe një reflektim tjetër që mund të na vijë ndër mend në vende të pisëta, ku asnjëri nuk kujdeset për to: një vend mund të jetë i ndotur për shkak të harresës apo moskokëçarjes së njeriut. Sapo e vë re besimtari këtë papastërti, e kupton se sa i mëshirshëm është Allahu kundrejt tij dhe sa keq është sjellë ai; ai e kupton se Allahu i ka dhënë një vend ideal për të jetuar dhe ai është mysafir në këtë vend. Për këtë arsye, e kupton se duhet të mbrojë dhe të ruajë me kujdes çdo mirësi që i është falur dhe t'i shprehë mirënjohje Allahut në punën që bën. Besimtari, i cili është i vetëdijshëm për këtë, do ta kuptojë menjëherë ku gaboi dhe do të kthehet tek Allahu; ai do të bëjë pastrimin që nevojitet, do t'i korrigjojë gabimet dhe nuk do të bjerë në të njëjtin gabim përsëri.

Harun Jahja (Adnan Oktar)



Kapitulli 3

CILËSITË E LARTA TË KARAKTERIT TË BESIMTARIT

Vigjilenca ndaj kurtheve të djallit

Ashtu siç thotë Allahu në Kur'an, djalli përpiqet gjithmonë për t'i larguar njerëzit nga rruga e drejtë, për t'i larguar ata nga feja e Allahut dhe mësimet e Kur'anit. Ai vazhdon punën e tij njëzet e katër orë në ditë - pa bërë dallim midis të pasurve dhe të varfërve, të rinjve dhe të vjetërve, njerëzve të bukur a të shëmtuar dhe përpiqet shumë, për t'i devijuar të gjithë. Ai ndjen inat kundrejt çdokujt, kushdo qoftë ai apo ajo.

Që në krijimin e qenies së parë njerëzore, ai u mbush me zemërim. Pasi Allahu krijoi Ademin, Ai e urdhëroi djallin t'i përkulej atij, por, ai ishte i mbushur me krenari dhe xheloz; nuk iu bind Allahut dhe refuzoi të përkulej. Si pasojë e rebelimit dhe paturpësisë së tij, u dëbua nga prezenca e Allahut. Zoti ynë na tregon për këtë në Kur'an:

Ne ju krijuam e pastaj ju dhamë formën; e u thamë ëngjëjve: "Përlujuni në sexhde Ademit!" – Të gjithë ju përlën, përveç Iblisit. Ai nuk ishte nga ata që ju përlën. Allahu tha: Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe kur të urdhërova?" Ai u

përgjigj: "Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta". Allahu i tha: "Atëherë, zbrit prej andej (Xhennetit)! Shporru, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve". (Sure A'raf: 11-13)

Allahu na tregon në Kur'an, se djalli i fajësoi njerëzit për gjendjen e tij të shkatërruar dhe i kërkoi Allahut një periudhë kohe – e cila zgjat deri në Ditën e Gjykimit - në të cilën ai të përpiket për ta larguar njeriun nga rruga e drejtë.

Iblisi tha: "Më jep afat deri në ditën kur ringjallen njerëzit!" Allahu i tha: "Ti je nga ata që u është dhënë afati." Ai tha: "Për shkak se Ti më flake tej, unë do t'u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë e do t'u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!" (Sure A'raf: 14-18)

Shënjestra e djallit është gjithë njerëzimi duke filluar që nga besimtarët, të cilët e kanë përqaftuar fort fenë e Allahut. Dëshira e tij është që të tërheqë sa më shumë njerëz me vete në Zjarr. Ai përpiket t'i pengojë njerëzit nga adhurimi i Allahut, t'i largojë ata nga feja e Tij dhe nga Kur'ani dhe si pasojë t'i tërheqë ata drejt dënimit të përfundimtar.

Ata që kanë besim, janë të vetëdijshëm se armiku i tyre më i madh, djalli është gjithmonë duke punuar kundër tyre; kur ata përpiqen me sa kanë mundësi për t'iu bindur Allahut sa më shumë, janë gjithmonë syçelët kundrejt lojrave dhe rrengjeve që iu punon djalli. Ata qëndrojnë zgjuar ndaj shqetësimeve dhe frikërave të kota që u shkakton ai dhe ndaj cytjeve të tij për t'u sjellë në kundërshtim me mësimet e Kur'anit, për ta lënë atë mënjanë, për ta harruar dhe për t'u larguar nga rruga e Allahut. Një shembull që tregon dhelpërimet që djalli u fut në mendje njerëzve, gjendet në vargun 268 të Sures Bekare:

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Djalli ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme. Kurse Allahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij. Allahu është Mirëbërës i Madh dhe i Gjithëdijshtëm. (Sure Bekare: 268)

Ashtu siç thotë edhe ky varg, djalli përpiqet ta bëjë një njeri që është i papunë, të harrojë se, është Allahu Ai që ia jep furnizimin çdo njeriu dhe e frikëson atë se nuk do të jetë i aftë për të siguruar para dhe kështu do të mbetet i uritur. Duke futur këtë lloj frike dhe duke sajuar edhe lloje të tjera prapaskenash, ai përpiqet t'i tërheqë njerëzit me vete. Në Kur'an, Allahu u tregon njerëzve se si të veprojnë për t'u mbrojtur nga këto cytje të mbrapshta që na provokon djalli.

Nëse djalli përpiqet të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka.
(Sure A'raf: 200-201)



Gjëja më e rëndësishme që mund të bëjë muslimani për t'u mbrojtur nga cytjet e djallit është të kërkojë mbrojtje tek Allahu. Ai nuk duhet të harrojë se edhe djalli është nën sundimin e Allahut dhe nuk ka fuqi të bëjë asgjë, vetëm nëse dëshiron Allahu. Në Kur'an, Allahu na urdhëron të themi këtë lutje me qëllim që të gjejmë strehë tek Ai prej djallit:

Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve), dhe nga sheri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)

e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!" (Sure Nas: 1-6)

Njeriu që mbart në vetvete cilësitë e përvehtësuara nga Kur'ani, do të kërkojë gjithmonë mbrojtje tek Allahu prej djallit dhe do të jetë në gjendje të dallojë pëshpëritjet që i shkakton ai në mendje sikur të ishin të vetat, nga mendimet që i përshtaten urdhërave të Kur'anit. Ai është në çdo moment vigjilent dhe nuk ua vë veshin cytjeve të tij. Ai nuk e lë atë t'i ndërhyjë në asgjë që mendon apo kryen. Për shembull, kur është i zënë me punën e tij, apo kur ndodhet vetëm, kur flet me dikë, apo kur i ndodh diçka apo ndonjë vështirësi, ai gjithmonë sillet me vetëdijen se djalli është në pritë duke e shtyrë atë për të folur dhe për t'u sjellë në atë mënyrë që e zemëron Allahun. Në këtë dhe në çdo situatë tjetër, ai do të flasë dhe do të veprojë sipas urdhërave të Allahut. Në këtë mënyrë, besimtari nuk bie nën ndikimin e dredhive të tij. Zoti ynë na tregon për këtë në Kur'an:

Sepse, në të vërtetë, djalli nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre. Pushteti i djallit është vetëm mbi ata që i binden atij dhe adhurojnë zota të tjerë veç Allahut. (Sure Nahl: 99-100)



Mirëkuptimi, toleranca dhe falja

Sipas urdhërit të Allahut: "Silluni mirë ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve, fqinjëve të afërt dhe të largët, atij që keni pranë, udhëtarit (që ka mbetur ngushtë) dhe atyre që janë robër nën pushtetin tuaj ..." në vargun 36 të Sures Nisa, besimtarët duhet të sillen mirë me njerëzit që i rrethojnë. Ata nuk janë kurrë grindavecë, kundërshtues, kokëfortë, apo mohues, por sillen mirë dhe drejt me njerëzit. Për arsye se jetojnë sipas këshillave të Kur'anit, ata shfaqin një karakter i cili është pajtues dhe i hapur për komunikim. Ata e dinë se inati, grindjet dhe debati i atyre të cilët jetojnë pa fe, nuk kanë vend në rrugën e tyre të ndriçuar nga Kur'ani. Prandaj ata janë falës, tolerantë dhe përpiqen të shohin të mirën tek tjetri. Në Libër, Allahu na tërheq vëmendjen për këtë si shprehje e një karakteri të lartë:

Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme. (Sure Esh-shura': 43)

Allahu na urdhëron të jemi të mirëkuptueshëm, tolerantë dhe falës me të tjerët. Ai e shpreh këtë në vargun më poshtë:

Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t'i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t'ju falë Allahu? Allahu është Falës, e Mëshirëplotë. (Sure Nur: 22)

Prandaj, besimtari tregohet i kujdesshëm dhe e trajton çdo besimtar tjetër, me të cilin ka të bëjë në jetën e përditshme, me mirëkuptim dhe falje. Ai do të jetë mirëkuptues kundrejt një besimtari i cili bën zhurmë dhe e zgjon atë në mëngjes. Ai e di se tjetri po sillet vetëm me urdhërin e Allahut; Allahu dëshironte ta zgjonte në atë moment dhe personi që e bëri atë zhurmë ishte instrumenti i Tij. Ky është një këndvështim i mundshëm për ta parë situatën. Për disa njerëz të tjerë, ky mund të ishte një rast për irritim

dhe grindje. Muslimani tregohet i kujdesshëm për t'u sjellë mirë me besimtarët e tjerë, të cilët i shkaktojnë bezdi pa dashje. Sado serioze të jetë situata, ai nuk nxehet, nuk e humb vetëpërmbajtjen apo të shqetësojë të tjerët rreth tij. Ndaj, edhe kur ai vetë bën ndonjë gabim, shpreson prej të tjerëve të njëjtin lloj mirëkuptimi. Ashtu siç thamë më lart, ai shpreson se Allahu me mëshirën e Tij të pamatë do ta falë për veprat e tij të gabuara. Nëse ai nuk përpiqet të jetë shembull tolerant në sjelljen e tij, e di se ky qëndrim do ta shtyjë në vepra që janë në kundërshtim me mësimet e Kur'anit.

Një njeri i cili praktikon në jetë vargjet e Kur'anit, do të vishet me cilësi të larta të karakterit. Për shkak të pjekurisë që tregon ai përgjatë gjithë ditës, qoftë në shtëpi, në shkollë, apo në punë, i ve pritë çdo tensioni apo ankthi. Për më tepër, sjellja e besimtarit është shembull për të tjerët. Ajo që është më e rëndësishme është se, kjo sjellje lavdërohet në Kur'an, ndaj ai sillet në atë mënyrë që është e kënaqshme në sytë e Allahut.

Nga dijet që mbledhi prej dijetarëve Imam Gazaliu shkroi fjalët më poshtë në lidhje me sjelljen shembullore të Profetit (paqja



24 OKË NGA JETA E MUSLIMANIT

dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ndaj njerëzve: "...Ai i përshëndeste i pari njerëzit që takonte. Nuk ngrihej dhe nuk ulej në asnjë vend pa e përmendur Allahun..."

"...Ai e kishte zakon t'u drejtohej sahabëve me titujt e tyre të nderimit për t'i respektuar ata dhe e kishte zakon t'i jepte tituj, atyre që nuk kishin."

"...Ai ishte shumë i dashur dhe i sjellshëm në marrëdhënie me njerëzit."
(Ihja Ulumid-Din, Imam Gazali)

Sigurisht, ajo që duhet të përpiqemi të arrijmë është karakteri fisnik i Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Ata që përvehtësojnë vlerat e Kur'anit dhe ndjekin Sunnetin e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), mund të shpresojnë se do të jetojnë një jetë të mirë në këtë botë dhe do të marrin një mirësi të madhe nga Allahu në Botën Tjetër.





Harun Jahja (Adnan Oktar)

Në të Dërguarin e Allahut ka
një shembull të mrekullueshëm
për atë që shpreson tek Allahu
dhe Dita e Fundit dhe e
përmend shumë Allahun.
(Sure Ahzab: 21)

Durimi

Thua jse në të gjitha shoqëritë ka njerëz të cilët nuk janë besimtarë, por që jetojnë pak a shumë, duke mbartur vlera të cilat Allahu i përshkruan në Kur'an. Kur është e nevojshme, këta njerëz bëhen të dobishëm, të sjellshëm dhe vetëmohues, të mëshirshëm dhe të drejtë. Por, sado të pretendojnë t'i kenë këto cilësi, ata patjetër përjetojnë çaste kur nuk qëndrojnë dot në këtë loj sjelljeje me durim. Për shembull, nëse dikush ka një provim me rëndësi për shkollimin e tij - ngrihet vonë në mëngjes për shkak se ora me zile është prishur; kur ngrihet, nxiton për në shkollë dhe mbetet i kapur në rradhën e gjatë të trafikut; do të telefonojë shkollën për t'u bërë të ditur se do të vonohet pak, por të gjitha linjat janë të zëna. Nëse një shok ulur afër tij i drejton një pyetje, ai mund të përgjigjet me një ton zëri që tregon zemërim apo vetëm sa t'i hedhë një vështrim nga koka te këmbët pa i dhënë përgjigje. Ky njeri e mendon veten si të dobishëm dhe mirëkuptues, por, në një situatë si kjo mund të themi se durimi i tij ka mbaruar dhe ai sillet në një mënyrë të padobishme.

Në çdo rrethanë dhe situatë besimtari është i vendosur të sillet duke shfaqur vlerat e Kur'anit në mënyrën se si jeton. Ai tregohet i duruar me të tjerët, të cilët

Harun Jahja (Adnan Oktar)

flasin apo bëjnë gjëra të cilat janë të gabuara apo të pakëndshme. (Për dije më të hollësishme mund të shihni "Rëndësia e Durimit në Kuran" nga Harun Jahja).

Për shembull, dikush e shtyn atë që të hipë i pari në autobus, një shok mund t'i flasë me fjalë të ashpra dhe t'i drejtohet i mbushur me inat. Një shofer i pakujdesshëm mund ta spërkatë me baltë nga koka te këmbët duke ecur rrugës. Shembuj të tillë ka mjaft. Por një person që ka përqafuar vlerat e Kur'anit, e kupton se të gjitha këto gjëra kanë ardhur siç janë në fatin e tij, ndaj kurrë nuk sillet në mënyrë të pahijshme, të nxituar apo të grindur. Patjetër, ai do të përpiqet që këto të mos ndodhin tjetër herë dhe do të bëjë ç'mos për të shmangur gjëra që sjellin nervozizëm. Sipas vlerave që na mësohen nga Kur'ani, madje edhe kur ndodh diçka që na bën dëm, besimtari duhet të tregohet i durueshëm me të tjerët dhe nëse është e mundur, sjelljen e keqe që mori nga të tjerët t'ia kthejë me më të mirë. Në Kur'an, Allahu na tërheq vëmendjen ndaj faktit se nëpërmjet durimit të tyre, besimtarët mund t'i mbulojnë në mënyrë të këndshme veprat e këqija:

Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë. (Sure Fussilet: 34-35)

Fjala e mirë

Disa njerëz, edhe pse ndërgjegjja u thotë të jenë falës ndaj dikujt që u ka bërë padrejtësi, apo t'i flasin në mënyrë të sjellshme dikujt që u ka folur ashpër, preferojnë të mos falin dhe t'i përgjigjen fyerjes me një tjetër më të madhe. Sipas kësaj mënyre të shtrembëruar të të menduarit, të flasësh me zemërim, të tallësh tjetrin me fjalë arrogante dhe fyese dhe t'i përgjigjesh me mosrespekt, tregon vërtet një shenjë epërsie.

Sigurisht, që këto ide bien në kundërshtim me Kur'anin. Në të, Allahu na jep shembujt e mëposhtëm se sa e bekuar është gjuha e sjellshme dhe se si ajo u sjell gjithmonë dobi njerëzve:

Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t'ua vënë veshin. Fjala e keqe është si pema e keqe, me rrënjë të shkulura, e paqëndrueshme për ekzistencë. Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse



keqbërësit i shpie në humbje; Allahu vepron si të dojë. (Sure Ibrahim: 24-27)

Siç e shohim nga ky varg, një njeri që flet fjalë të zgjedhura të një morali të lartë dhe jeton në përputhje me to, do të gjejë bukuri të madhe dhe bekime të panumërta edhe në këtë botë edhe në botën tjetër. Nga ana tjetër, një njeri që përdor fjalë të pahijshme dhe jeton sipas tyre, është duke ecur përgjatë një rruge të errët e cila mbaron në Zjarr.

Besimtari flet fjalë të mira dhe të mençura me këdo që takon gjatë ditës. Kudo që të jetë u flet njerëzve për fenë e Allahut, u jep këshilla nga Kur'ani, flet fjalë të cilat e përkujtojnë Allahun dhe karakterin e mirë të të Dërguarit të Tij (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) dhe u drejtohet njerëzve me respekt. Me qëllim që t'i nxitë shokët, ai i lavdëron cilësitë e tyre të mira, të cilat pajtohen me mësimet e Kur'anit dhe Sunnetin dhe flet në mënyrë të tillë që t'i ndihmojë njerëzit të vazhdojnë ditën me gëzim dhe gjallëri. Këtë



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

sjellje të besimtarëve mund ta krahasojmë me frutin e ëmbël të pemës në vargun më lart.

Megjithatë, disa njerëz zgjedhin të mos flasin për cilësitë e mira të të tjerëve, por duan t'i përulin ata, duke u vënë në dukje vetëm gabimet dhe të metat e tyre. Ashtu siç theksuam në vargjet e Sures Ibrahim, Zoti ynë na tërheq vëmendjen për këtë dhe e krahason këtë lloj gjuhe me një pemë të kalbur, e cila nuk mund të prodhojë asnjë lloj fruti. Një fjalë pa vend mund të shkatërrojë një marrëdhënie, apo të ndrydhë zellin e palës tjetër, duke u bërë shkas për dhimbje dhe keqardhje.

Kur besimtari flet me dikë dhe e këshillon se si të shërojë të metat dhe gabimet, tregon kujdes të madh për të zgjedhur fjalët më të mira. Kur vepron kështu, ai plotëson urdhërin e Allahut si më poshtë:

Thuaju robërve të Mi, që të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapët i tyre. (Sure Isra: 53)

Ashtu siç thotë Allahu në këtë varg, djalli përpiqet t'i bëjë njerëzit të mos thonë fjalë të mira shoqi-shoqit dhe në këtë mënyrë, t'i bëjë ata armiq të njëri-tjetrit. Kur nxirret nga goja një fjalë e keqe, djalli pa humbur kohë, fillon të hedhë dyshime në mënyrë që t'i përçajë. Një njeri që nuk ndihet rehat prej fjalëve të pahijshme që i janë thënë, do të ndikohet nga kurthet e tij dhe do t'i përgjigjet

kundërshtarit me të njëjtën monedhë. Kjo do ta dëmtonte dhe madje do ta shkatërronte miqësinë e tyre. Përkundrazi, një fjalë e mirë do ta pengonte djallin për t'i tërhequr njerëzit në gabim. Për këtë arsye, besimtarët përpiqen me gjithë zemër për t'iu drejtuar njëri-tjetrit me fjalët më të mira të mundshme, në mënyrë që ai të mos ketë rastin për t'u futur mes tyre. Një sjellje e tillë do të forcojë lidhjen e tyre vëllazërore. Profeti ynë (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) i ka urdhëruar besimtarët të praktikojnë gjithmonë sjelljen dhe fjalën e mirë:

"Mos e kini zili njëri-tjetrin; mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit; mos e prisni në besë njëri-tjetrin, por bëjuni vëllezër, o robërit e Allahut." (Transmeton Muslimi)

"Të përshëndesësh një njeri është sadaka. Të veprosësh me drejtësi është sadaka. Fjala e mirë është sadaka." (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

"Asgjë nuk rëndon më shumë në peshore se sa karakteri i mirë." (Transmeton Imam Ahmedi dhe Ebu Daudi)



Urtësia

Në një shoqëri ku nuk mbretërojnë vlerat e Kur'anit, ka njerëz të cilët janë të vrazhdë, të ashpër, të pasjellshëm, mendjeshkurtër dhe mosrespektues. Besimtarët i shmangen me kujdes këtyre zakoneve dhe sjelljeve; ata kanë një cilësi të karakterit e cila është e paqortueshme, e sjellshme, e ndjeshme dhe e urtë. Këto janë gjithashtu cilësi të të Dërguarve të Allahut. Në Kur'an na tregohet për mënyrën e mprehtë të të menduarit të Musait (paqja qoftë mbi të):

Kur arriti tek pusi i Medjenit, ndeshi rreth tij shumë njerëz që u jepnin ujë kafshëve. Përveç tyre, ai vuri re dy vasha që po mbanin kafshët e veta. Ai tha: "Si e keni hallin ju?" Ato thanë: "Ne nuk u japim ujë, pa u larguar barinjtë. Babai ynë është shumë plak". Kështu, Musai u dha ujë kafshëve të tyre e pastaj u kthye te një hije dhe tha: "Zoti im, çfarëdo që të më japësh, unë jam nevojtari!" (Sure Kasas: 23-24)

Duke qenë njeri i ndjeshëm, Musai (paqja qoftë mbi të), menjëherë vuri re se gratë që takoi kishin nevojë për ndihmë dhe i ndihmoi ato pa humbur kohë. Ky tipar i Musait (paqja qoftë mbi të) lavdërohet në Kur'an dhe njerëzit me besim e marrin atë si shembull në jetën e përditshme. Kur shohin dikë, i cili ndodhet në një gjendje të vështirë apo të shqetësuar, menjëherë përpiqen për t'i ardhur në ndihmë. Përveç kësaj, ata përpiqen të krijojnë një atmosferë të lumtur dhe të këndshme; ata sillen me fisnikëri që t'i bëjnë të tjerët të kënaqur.

Të sillesh në mënyrë të tillë që të mos i bësh njerëzit të ndihen keq, është tipar urtësie. Një njeri në shtëpi, i cili i mban sendet dhe dhomat e përbashkëta me rregull dhe pastërti, nuk flet me zë të lartë apo nuk shikon televizorin me zërin në kupë të

qiellit, që vëren nëse i afërmi me të cilin dëshiron të flasë është i lirë apo jo për të folur në atë çast, dhe nuk pengon dikë, i cili nxiton duke u përpjekur të bëjë diçka është një shembull urtësie që shpesh e hasim në jetën e përditshme.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i urtësisë është dhënia përparësi e të tjerëve para vetes. Në një bisedë mes dy njerëzve, për një temë rreth së cilës të dy kanë dituri dhe njëri prej tyre ia le rradhën tjetrit për të folur, apo dikush, i cili e ndan me tjetrin edhe kafshatën e gojës, janë shembuj të kësaj natyre. Përveç kësaj, lëshimi i vendit në autobus për dikë që ka nevojë, apo lejimi i dikujt tjetër për të dalë para jush tek banaku për të paguar pasi keni bërë pazarin, janë mënyra me anë të të cilave njerëzit mund të afrohen dhe të vendosin marrëdhënie të mira. Njerëzit, të cilët janë të urtë kundrejt të tjerëve hedhin themele për marrëdhënie të shëndosha të mbështetura mbi dashuri e respekt. Po ashtu, ata shkojnë mirë me fqinjët e tyre dhe kënaqen sa herë që e shohin njëri-tjetrin.

Ndryshe ndodh në një ambient ku secili përpiqet vetëm për epërsinë dhe përfitimin e tij; shoqëria e vërtetë nuk mund të lulëzojë në të.

Bisedat e këqija dhe sjellja me dy fytyra e pengojnë shoqërinë të formohet. Biseda e zbrazët dhe talljet krijojnë një atmosferë të tensionuar, ku asnjëri nuk do të dëshironte të ndodhej. Në të tilla vende emri i Allahut nuk përmendet fare.



Mikpritja

Kur'ani na tregon si të bëhemi mikpritës në vargjet ku përshkruhet kujdesi i Ibrahimit (a.s.) për mysafirët e tij:

A e ke dëgjuar historinë e mysafirëve të nderuar të Ibrahimit? Ata hynë tek ai e i thanë: "Paqe!" – dhe ai u tha: "Paqe, o njerëz të panjohur!" E pa u vënë re, ai shkoi te njerëzit e shtëpisë dhe solli një viç të majmë. Pastaj ua afroi atyre e u tha: "A nuk po hani?" (Sure-Dharijat: 24-27)

Besimtarët, të cilët e marrin si shembull mikpritjen e Ibrahimit (a.s.) i përshëndesin me gëzim miqtë me një mirëseardhje të ngrohtë dhe i bëjnë ata të ndihen mirë duke shfaqur respekt dhe dashuri. Më pas, atyre u vjen në mendje se për çfarë mund të kenë nevojë miqtë e tyre dhe ua plotësojnë atë pa pritur që mysafirët ta përmendin. Për më tepër, ata përpiqen t'i servirin këto gjëra pa vonesë, sepse është traditë e muslimanëve bazuar në shembullin e të Dërguarit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), ku mikut i serviret ushqimi më i mirë që ndodhet në shtëpi.

Disa njerëz nuk ua hapin derën miqve kur vijnë, edhe pse i njohin mirë. I presin ata sa për forcë zakoni apo për ndonjë interes që mund të kenë. Sjellja e tyre ndryshon sipas pozitës së mikut: nëse presin për mik një të varfër ata e kalojnë rradhën pa ofruar asgjë të veçantë. Nëse miku i tyre është i pasur dhe me ndikim te të tjerët, ata përpiqen t'i nxjerrin ushqimin më të mirë në shtëpi me shërbimin më të mirë të mundshëm.

Kur i zoti i shtëpisë i pret ftohtë miqtë dhe nuk e vret mendjen aspak për ndjenjat e tyre, sigurisht që i bën ata të mos ndihen rehat dhe të rrinë si në gjemba. Kjo gjendje bën që secila palë të kërkojë t'i japë fund kësaj historie sa më shpejt. Mikut i vjen keq që ka ardhur dhe të zotit të shtëpisë i vjen keq që i ka shërbyer ushqim dhe e ka humbur kohën me të.

Harun Jahja (Adnan Oktar)

Si përfundim, vetëm duke vënë në jetë vargjet e Kur'anit dhe duke marrë shembull sjelljen fisnike dhe bujare të të Dërguarit të fundit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe të muslimanëve të drejtë deri në ditët e sotme, midis njerëzve mund të lulëzojnë vëllazërimi dhe bashkëpunimi, fjala e mirë dhe mikpritja.



Paqja dhe respekti i ndërsjelltë

Kur besimtarët takohen gjatë ditës përshëndeten me përshëndetjen më të mirë dhe më të përzemërt "Selam Alejkum", me fjalë të tjera, ata i urojnë njëri-tjetrit paqe. Duke vepruar kështu, kanë përmbushur fjalën e Allahut: "**Kur përshëndeteni me një përshëndetje kthejeni me një të njëjtë ose më të mirë se ajo...**" (Sure Nisa: 86). Në një varg tjetër, Allahu i këshillon besimtarët t'i përshëndesin njerëzit e shtëpisë me përshëndetjen e paqes kur hyjnë në to:

Kur të hyni në shtëpi, të përshëndetni njëri-tjetrin me një përshëndetje të mirë e të bukur nga Allahu. Kështu jua shpjegon Allahu juve shpalljet që të kuptoni. (Sure Nur: 61)

Kur largohet nga shtëpia, besimtari përshëndet miqësisht fqinjët që takon dhe u uron atyre një ditë të mbarë dhe paqen e mëshirën e Allahut. Ai përshëndet njerëzit në rrugë pa përjashtim, pret përshëndetjet e tyre dhe ua kthen me më të mirë. Kjo sjellje është një nga gjërat e vlera, të sjella nga Kur'ani dhe Sunneti për marrëdhëniet shoqërore. Duke shqiptuar përshëndetjen e paqes largohet atmosfera e ftohtë dhe e tendosur midis dy njerëzve të panjohur. Kështu, njerëzit afrohen dhe midis tyre krijohet një ambient i ngrohtë edhe pse ata mund të mos e njohin njëri-tjetrin.

Në një shoqëri ku mungon besimi, përshëndetja e paqes thuhet sa për forcë zakoni. Disa njerëz përshëndesin vetëm ata prej të cilëve përfitojnë apo shpresojnë se mund të përfitojnë. Ndonjëherë, ata nuk ua kthejnë përshëndetjen njerëzve, të cilët i trajtojnë si inferiorë apo më pozitivë më të ulët se ata dhe bëjnë gjoja sikur nuk e kanë dëgjuar atë, me qëllim për t'i poshtëruar. Por, ç'është më e keqja, një sjellje e tillë shikohet si normale në disa rrethe njerëzish.

Harun Jahja (Adnan Oktar)

Allahu i thërret njerëzit
në shtëpinë e shpëtimit
(Parajsë) dhe udhëzon kë
të dojë në rrugën e drejtë.
(Sure Junus: 25-26)



Shmangia e inatit dhe grindjes

Grindjet i ndajnë njerëzit nga njëri-tjetri, i çojnë në mosmarrëveshje, në luftra dhe konflikte. Nëse midis dy shokëve zhvillohet një debat i vogël, inati mund t'ia zerë vendin gjithë ndienjave pozitive. Në vargun 54 të Sures Kehf, Allahu na tërheq vëmendjen për këtë cilësi negative dhe thotë se qeniet njerëzore, mbi të gjitha, janë kundërshtues. Prandaj, besimtarët me çdo kusht, duhet të shmangin çdo lloj grindje që mund të dobësojë apo të shkatërrojë unitetin e tyre dhe vëllazërimin. Allahu qartas e ka ndaluar këtë lloj sjelljeje:

Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lerë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit. (Sure Enfal: 46)

Grindjet ua humbin forcën besimtarëve, nuk japin zgjidhje për asnjë problem, nuk janë të dobishme dhe ndodhin me anë të cytjeve të djallit. Një njeri me moral të mirë

mund t'i shohë grindjet dhe zënkat si të shëmtuara dhe të papranueshme, e megjithatë, vetja mund ta shtyjë drejt grindjes dhe konfliktit. Për këtë arsye, ai që e merr Kur'anin si udhërrëfyes dhe sillet gjithmonë duke dëgjuar zërin e ndërgjegjjes, kurrë nuk do të lejojë që të shpërthejnë grindje. Edhe nëse plas një debat si pasojë e një momenti pakujdesie, ai do ta mbledhë veten

sakaq, do të kujtojë urdhërin e Allahut, do ta kuptojë se ajo çka veproi nuk e kënaq Allahun dhe do ta braktisë këtë lloj sjellje.

Muslimani mund të hasë lloje të ndryshme njerëzish përgjatë ditës, por, me çdo kusht do ta lerë mënjane debatin. Për shembull, kur bën pazar, nuk zihet me pronarin e dyqanit për çmimin e mallit, apo me shoferin e autobusit për shkak të vonesës së autobusit, apo me ndonjë zyrtar të ngathët, kur është duke pritur në rradhë. Nëse gjendet në një situatë ku i bëhet padrejtësi, ai nuk do të nxehet dhe të fillojë debatin, por do të zgjedhë ta çlirojë situatën duke u sjellë mirë dhe me zgjuarsi. Në Kur'an, Allahu thotë se besimtari nuk duhet të inatoset:

Të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqënie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit. (Sure Ali Imran: 134)

Kjo ishte gjithashtu edhe këshilla e të Dërguarit (Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) kur u pyet nga një njeri për ta këshilluar dhe ai i tha thjesht: "Mos u inatos." (40 Hadithet, Imam Neveviu)

Ai që ve në jetë fjalët e Kur'anit, nuk e ndërron sjelljen sipas personit që takon. Dikush mund të tallet me të, të përdorë gjuhë të pakëndshme, ta fyejë, madje edhe të përdorë dhunë, por sjellja e mirë e besimtarit, thjeshtësia, mëshira dhe fisnikëria kurrë nuk ndryshojnë. Ai kurrë nuk fyen një njeri që e fyen i pari, apo t'ia kthejë përqeshjen me përqeshje, inatin për inat. Ai mbetet i qetë dhe e vë veten në kontroll nëse dikush inatoset me të dhe sillet ashtu siç na ka këshilluar Profeti ynë (Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) në hadithin e tij:

"Frikësoju Allahut kudo që të jesh, veprën e keqe mbuloje me të mirë, ajo do ta fshijë të keqen dhe sillu mirë me njerëzit." (40 Hadithet, Imam Neveviu)

Një besimtar e di, se çdo moment dhe çdo gjë është krijuar për ta vënë atë në provë. Për këtë arsye, në vend që të bëjë fjalë me dikë, ai përdor gjuhë të zgjedhur dhe durim për të mposhtur inatin e drejtuar ndaj tij. Ai e di se kjo është sjellja, e cila e kënaq Allahun, kënaqësinë e të Cilit kërkon të fitojë.

Thuaji "JO!" lakmisë

Një nga cilësitë negative në natyrën e njeriut është lakmia dhe Allahu na tregon në Kur'an se duhet ta shmangim atë:

...Njerëzit janë të prirur nga kopracia. Por në qoftë se ju silleni mirë dhe ruheni prej të këqijave, Allahu e di mirë çfarë veproni. (Sure Nisa: 128)

Lakmia e disa njerëzve shfaqet si zili, pse të tjerët janë më lart se ata nga ana materiale apo shpirtërore, apo kanë diçka që ata nuk e kanë. Për shembull, kur ata shohin dikë më të bukur apo më tërheqës, bëhen ziliqarë. Të tjerë janë ziliqarë për njerëzit të cilët janë të pasur, të suksesshëm, të ditur, të kulturuar, të zellshëm në punë apo kanë shtëpi të bukura. Prestigji, fama apo pozita mund të jenë shkaqe për lindjen e zilisë. Sidoqoftë, është një fakt shumë i rëndësishëm, të cilin njerëzit ziliqarë nuk e marrin parasysh dhe Allahu na përkujton për të në Kur'an:

A mos kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar Allahu nga të mirat e Veta? (Sure Nisa: 54)

Zoti ynë, Allahu, është Pronari i gjithçkaje. Ai furnizon atë që dëshiron dhe aq sa dëshiron Ai. Njeriu nuk ka në dorë asgjë për atë që i jepet. Pronari absolut i bukurisë, pasurisë, pronave dhe madhështisë është Allahu. Besimtari është i vetëdijshëm për këtë; kështu që çfarëdo që të hasë gjatë ditës, ai nuk bëhet ziliqar. Nëse sheh dikë më të bukur se vetja, ai kujton Allahun, Pronarin e vërtetë të bukurisë dhe pasurisë. Ai e di se Allahu zgjedh çfarë dëshiron dhe për kë e dëshiron, u jep mirësi atyre që do Ai dhe se zgjedhja dhe vendimi i përkasin vetëm Atij. Besimtari sillet në mënyrë të tillë, që e njeh Allahun si krijuesin e gjithçkaje në mënyrën më të mirë dhe më të dobishme dhe se të gjitha mirësitë e shumëllojshme në këtë botë u janë dhënë njerëzve vetëm si sprovë dhe se jeta e vërtetë është ajo që do të vijë, po ashtu, vlerat në sytë e Allahut maten me sjelljen që e kënaq Atë.

Harun Jahja (Adnan Oktar)

Ai nuk ndjen zili kur ndan gjërat me të tjerët apo kur u fal ndonjë send të tjerëve. Për shembull, ai nuk shqetësohet kur fal si dhuratë diçka të preferuar apo kur lejon dikë ta përdorë atë. Allahu ua këshillon këtë lloj sjelljeje besimtarëve në Kur'an:

Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani Allahu e di mirë atë. (Sure Ali Imran: 92)

Muslimani e di se të gjitha mirësitë në jetën e kësaj bote i janë dhënë atij përkohësisht në përdorim dhe si provë; ai e di se cilësitë negative si lakmia dhe zilia janë të gabuara dhe duhet të largohet prej tyre.



Lënia e dyshimit dhe thashethemeve

Në një shoqëri njerëzish të paditur, disa prej tyre kanë zakone të cilat u janë bërë pjesë e pandarë e jetës. Këto zakone janë ushqimi i dyshimit për të tjerët, futja e hundëve në punët e të tjerëve, apo përpjekja për të mësuar gjërat e fshehta të jetës së tjetrit, të cilat nuk u duhen aspak dhe thashethemet: marrja nëpër gojë e të tjerëve dhe të folurit prapa kurrizit. Këto dy sjellje zakonisht bëshkëshoqërohen, sepse dikush, i cili merr nëpër gojë dikë tjetër vepron kështu sepse ka mendime të padenja, të mbrapshta për të. Po ashtu, dikush që fut hundët në punët e të tjerëve sillet në këtë mënyrë, sepse ai është dyshues. Në udhën e Kur'anit nuk ka vend për këtë lloj sjellje të pakëndshme dhe Allahu i urdhëron besimtarët për ta shmangur atë:

O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se vërtet disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë. (Sure Huxhurat: 12)

Fjalët e Allahut ndrisin gjithmonë në mendjen e besimtarit, i cili me kujdes largohet nga sjellja e padëshirueshme për Allahun. Ai nuk përpiket për të mbledhur të dhëna për njerëzit e tjerë me qëllim të keq; nuk flet asgjë të pakëndshme, apo diçka për të cilën është i pasigurt, apo që të lëndonte ndjenjat e të tjerëve. Ai nuk kapet në hamendje ziliqare për një njeri, rreth të cilit nuk di asgjë. Mendimet e tij rreth një njeriu që nuk e njeh, mbeten gjithmonë të mira; ai flet vetëm për anët dhe cilësitë e mira apo tërheqëse të tjetrit. Kështu, duke marrë shembullin e sjelljes së besimtarëve ndaj një shpifje drejtuar grave, Allahu thotë në Kur'an se, kur një besimtar nuk është i sigurt në lidhje me dikë tjetër, duhet të mendojë gjithmonë mirë:



**Kur e dëgjuat këtë përgojim, përse besimtarët dhe besimtare
nuk menduan mirë për njëri-tjetrin dhe të thoshin: "Kjo është
shpifje e qartë"?! (Sure Nur: 12)**

Besimtari përpiket gjithmonë për të menduar mirë për familjen e tij, shokët dhe ata që e rrethojnë. Gjithashtu, ai përpiket të flasë për udhëzimin dhe t'i bëjë edhe të tjerët të veprojnë po ashtu. Por, njerëzit janë krijuar harrues, si pjesë e sprovës së tyre në këtë botë dhe ata mund të gabojnë, por, kur bëhen të ndërgjegjshëm për sjelljen e tyre të gabuar, ata kërkojnë strehim në mëshirën e Allahut dhe kërkojnë falje prej Tij.

Lënia e talljes

Sjelljet tallëse janë mjaft të përhapura mes atyre grupe njerëzish, të cilët jetojë larg Kur'anit. Mes njerëzve të paditur, disa mund të tallin të tjerët duke vënë në dukje të metat e tyre, gabimet, çrregullimet fizike, veshjen, mungesën e pasurisë, varfërinë, pakujdesinë, sjelljen, mënyrën e të folurit dhe shkurtimisht, pothuaj gjithçka në lidhje me ta. Për t'u tallur me dikë, ata përdorin disa fjalë, gjepte apo disa shprehje të fytyrës. Për atë që ve në lojë të tjerët, nuk ka fare reëndësi se mund të lëndojë ndjenjat e tjetrit, ta dëshpërojë, ta shqetësojë, ta inatosë apo ta verë në ankth. Ajo që ka rëndësi për ta është rritja e mendjemadhësisë së tyre dhe poshtërimi i shënjestrës së talljes.

Në Kur'an, Allahu i ndalon njerëzit prej talljes së të tjerëve:

O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo. Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirrësh me emër të keq pas (pranimit të besimit)! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës. (Sure Huxhurat: 11)

Në një varg tjetër, Zoti ynë shpall: "Mjerë për çdo përqeshës – shpifës" (Sure Humeze:1) dhe i paralajmëron njerëzit të cilët sillen në këtë mënyrë të shëmtuar, nuk i zbatojnë urdhërat e Kur'anit dhe nuk e vrasin mendjen fare për llogarrinë që do të japin në botën tjetër.

Mes besimtarëve nuk lejohet asnjë formë talljeje. Ata e dinë se është Zoti ynë Ai, i Cili i ka dhënë çdokujt pasurinë, bukurinë, zgjuarsinë, talentet dhe cilësitë e tjera. Ata kënaqen prej cilësive të mira që venë re tek tjetri, sepse kërkojnë kënaqësinë e Allahut dhe jo atë të vetes së tyre. Besimtarët nuk kanë mendjemadhësinë dhe zilinë, që janë tipare të shoqërive injorante. Për këtë arsye, ata janë gjithmonë falës, dashamirës dhe të thjeshtë me njëri-tjetrin.

Njëkohësisht, besimtarët e kuptojnë, se të metat që shohin tek tjetri janë sprova prej Allahut. Për këtë arsye, ata nuk kërkojnë tërheqjen e vëmendjes ndaj këtyre defekteve, por, i mbulojnë ato

duke u sjellë mirë. Ata shmangin me kujdes edhe veprimin më të vogël, mimikën apo edhe fjalëzën më të imët që përmban tallje.

Vetësakrifikimi

Ata që mendojnë se kjo jetë është e vetmja dhe s'ka tjetër pas saj, nuk sakrifikojnë për të tjerët, vetëm nëqoftëse përfitojnë diçka prej tyre dhe nuk e marrin mundimin të ndihmojnë dikë tjetër që ndodhet në nevojë. Kjo ndodh sepse ata nuk e kuptojnë se do të marrin shpërblim të përpiktë në jetën tjetër për të mirat dhe të këqijat që kanë vepruar në këtë botë. Allahu na tërheq vërejtjen ndaj kësaj mënyre të çoroditur të menduari.

Vërtet që njeriu është krjuar i paqëndrueshëm: kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort, por, kur i bie e mira, ai bëhet koprac. (Sure Mearixh:19)

A e ke vënë re atë që shmanget (nga e vërteta) dhe jep pak e pa qejf? (Sure Nexhm: 33-34)

Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë; e as ata që janë kopracë, të cilët kërkojnë që edhe të tjerët të bëhen kopracë dhe fshehin atë që ua ka dhuruar Allahu nga mirësitë e Tij. Ne kemi përgatitur për mohuesit ndëshkim poshtërues. (Sure Nisa: 36-37)

Njeriu mund të zhvishet nga egoizimi dhe të këqijat e vetvetes. Për këtë, Zoti ynë na shpall vargun e mëposhtëm:

Prandaj frikësojuni Allahut sa të mundeni, dëgjoni e binduni dhe shpenzoni për bamirësi në të mirën tuaj. Ata që e ruajnë veten nga lakmia e saj, pikërisht ata janë të fituarit. (Sure Tegabun: 16)

Për këtë arsye, një njeri i cili jeton sipas mësimave të Kur'anit, e lë mënjanë egoizmin dhe përpiqet të ndajë ato që ka, me të tjerët rreth tij. Për shembull, ai kënaqet kur e ndan ushimin me dikë që është i uritur. Me gëzim i jep sende me vlerë dikujt, nevoja e të cilit për to është më e madhe. Ai u jep nevojtarëve tepricën e pasurisë (Sure Bekare: 219) dhe e di se do të marrë për të një shpërblim shumë herë më të madh

në botën tjetër. Në Kur'an, Allahu na tregon sjelljen shembullore të Sahabëve të Profetit tonë:

Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që kanë pranuar besimin qysh më parë, i duanmërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtare. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetes, me siguri që do të jetë fitues. (Sure Hashr: 9)

Besimtarët kënaqen thellë në shpirt, kur mendojnë se vepra e tyre e vetësakrifikimit, ka bërë dikë tjetër të lumtur. Ata jetojnë me një paqe të brendshme që buron nga të vepruarit sipas zërit të ndërgjegjjes dhe duke e ditur se Allahu është i kënaqur prej tyre. Edhe kur ata vetë janë në nevojë, i lenë mënjane të drejtat e tyre pa vonesë. Nuk i përmendin veprat e tyre të bamirësisë, nuk kërkojnë të lavdërohen nga të tjerët apo të vihen në pah dhe gjithashtu përpiqen të mos e bëjnë palën tjetër t'ua kthejë nderin që i kanë bërë.



Të vepruarit me drejtësi

Besimtarët nuk janë të pandjeshëm ndaj padrejtësive që vënë re, dëgjojnë apo marrin vesh. Urdhërat e Kur'anit, sipas së cilave jetojnë, i bëjnë ata kundërshtues të çdo lloj padrejtësie, mbrojtës të të drejtave të atyre që u është bërë padrejtësi dhe ndihmues në të mirë të tyre. Në Suren Nisa, Allahu përshkruan se besimtarët kanë një të kuptuar të shkëlqyer të drejtësisë:

O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush, edhe kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), Allahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas dëshirave tuaja e të shtrembëroni drejtësinë! Nëse ju ngatërroni dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet Allahu e di se çfarë bëni ju. (Sure Nisa: 135)

Ata vihen në lëvizje me të gjitha forcat për të parandaluar padrejtësinë. Edhe nëse shumica e njerëzve do të silleshin ndryshe, pakujdesia dhe papërgjegjshmëria e tyre nuk i bën aspak besimtarët të shkujdesen. Ata e dinë se do të merren në pyetje në botën tjetër se çfarë përpjekje kanë bërë për hir të drejtësisë dhe çfarë kanë bërë për të parandaluar padrejtësinë. Ata nuk përpiqen t'i ikin përgjegjësisë ashtu siç veprojnë shumë njerëz në botë duke bërë gjoja se nuk kanë parë, nuk kanë dëgjuar apo nuk kanë vënë re asgjë. Ata sjellin ndër mend faktin se, nëse do të sillen me pakujdesi, do të jenë të humbur; ndaj nëse do të tregojnë kujdes, ata e dinë se dalin të fituar në botën tjetër, dhe të gjithë njerëzit e shtypur dhe që kanë vuajtur padrejtësinë përfitojnë gjithashtu. Për këtë arsye, ata kurrë nuk janë

spektatorë të painteresuar të padrejtësisë.

Edhe nëse interesi i tyre preket, edhe në qoftë e vështirë për ta pranuar, drejtësia duhet zbatuar pa dallim midis nënës, babait, shokëve, të panjohurve, të pasurve apo të varfërve. Për këtë arsye, besimtari nuk mundohet asnjëherë të bëjë padrejtësi gjatë ditës dhe përpiqet të jetë syçelët ndaj saj. Ai i jep çdokujt hakun e tij.

Për shembull, kur ai kalon para njerëzve që presin në rradhë për autobusin, nuk bëhet mosrespektues dhe nuk i mbyll sytë para ndokujt që sillet pa respekt. Ai ndërhyr në një mënyrë që është e përshtatshme për karakterin fisnik dhe pa krijuar aspak tension. Në një garë apo konkurs ai tregohet i kujdesshëm për të lavdëruar ata që e meritojnë lavdërimin. Ai i mbron ata që janë me të drejtën, pa bërë dallim midis tyre dhe miqve të tij. Nëse ai apo shoku i tij i ngushtë, bëjnë ndonjë gabim, do ta pranojë menjëherë nëse ky gabim i bën dëm dikujt tjetër dhe do të bëjë ç'është e mundur të zëvendësojë dëmin që është bërë.



Singeriteti

Disa njerëz nuk e kanë për gjë të gënjëjnë, me qëllim që të fshehin një gabim që kanë bërë, të përfitojnë diçka, ta ruajnë veten nga një situatë e vështirë apo t'i detyrojnë njerëzit të bëjnë atë që duan ata. Megjithëse, ata e dinë mjaft mirë, se kjo që bënë është e gabuar dhe se gënjeshttrat e tyre mund të zbulohen kurdoherë, ngulin këmbë në këtë lloj sjellje të pakëndshme. Atyre nuk u bie ndër mend se do të japin llogarri në Ditën e Gjykimit për gjithçka që kanë thënë dhe vepruar.



Harri Jahja (Adnan Oktar)

Ndryshe ndodh me besimtarët; ata nuk bëjnë kurrë lëshime me ndershmërinë. Ata e dinë se duhet të jenë kurdoherë të singertë, ashtu siç ka shpallur Allahu në Kur'an:

**O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën.
(Sure Ahzab:70)**

Ata i binden këtij urdhri çdo ditë me kujdes. Ashtu siç përmendëm në një temë më lart, ata nuk gjejnë strehë te gënjeshtra, për të mbuluar një gabim. Menjëherë kërkojnë falje për ndonjë gabim që kanë bërë dhe përpiqen për ta riparuar. Nuk shpikin gënjeshtra, me qëllim që të fitojnë respektin e të tjerëve apo të pëlqehen nga ata. Cilado qoftë arsyeja, ata nuk e shohin gënjeshtren si zgjidhje.

Për këtë arsye, një njeri që jeton duke iu bindur mësimëve të Kur'anit në jetën e përditshme, nuk shqetësohet aspak, sepse nuk e ka zakon të thotë gënjeshtra apo të zbulohet se ka gënjyer. Ai bën një jetë të mirë, të qetë, të paqtë, të cilën ia sjell ndershmëria dhe singëriteti. Ai që e përqafton këtë mënyrë të çmuar sjelljeje në këtë botë, do të marrë një shpërblim edhe më të madh në botën tjetër. Allahu u jep këtë sihariq vepërmirëve:

**Allahu thotë: "Kjo është Dita,
në të cilën të cilën, të
singertëve u sjell dobi
singëriteti i tyre. Atyre u
takojnë kopshtet, nëpër të cilat
rrjedhin lumenjtë e ku do të
qëndrojnë përgjithmonë. Allahu
është i kënaqur me ata dhe ata janë të
kënaqur me Atë. Kjo është fitorja e madhe!"
(Sure Maide: 119)**

Përfundim

Përgjatë gjithë këtij libri, kemi parë se besimtarët e bëjnë parim të jetës së tyre, për të jetuar 24 orë sipas vlerave që ka shpallur Allahu në Kur'an. Në çfarëdo lloj kushtesh qofshin, ata nuk i lejojnë vetes largimin nga sjelljet e vyrtytshme. Vlerat e tyre nuk ndryshojnë; ata gjithmonë sillen sipas urdhrave të Allahut dhe këshillave të Tij. Ata e marrin Profetin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) si shembull, të cilin Allahu e lavdëron në Kur'an me këto fjalë:

Ti je me virtyte madhore. (Sure Kalem:4)

Ka vetëm një mënyrë për t'i shpëtuar dënimit të përjetshëm në Zjarr: të jetojmë sipas Kur'anit dhe Sunnetit, sepse me anë të tyre Allahu ua ka dhënë njerëzve "Përkujtuesin e tyre." Ai i ruan njerëzit nga padituria në të cilën janë zhytur, nga mënyra primitive e të menduarit, ambienti stresues, tiparet negative të karakterit, frikërat e pabaza, besimet e çoroditura, dhe torturat e zjarrit - ku të çojnë këto botëkuptime.

Kur'ani, në vend të këtyre që përmendëm më lart, u jep

njerëzve të kuptuar të qartë dhe mençuri, vlera më të larta, një ambient më të shëndetshëm të mbushur me paqe shpirtërore dhe çështje më e rëndësishme, - jetën në Parajsë, të mbushur me mirësi të pafund.

Ka vetëm një mënyrë për të larguar gjithë ankthin, luftrat, armiqësinë, varfërinë, mjerimin dhe inatin që ngulfatin botën tonë: jeta sipas mësimave të Kur'anit dhe Sunnetit të Muhamedit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Për njeriun nuk ka mënyrë tjetër për të fituar lumturinë, mirëqenien, drejtësinë, dashurinë dhe paqen, që ai dëshiron aq shumë.

Të jetosh sipas Kur'anit dhe Sunnetit si një mbrojtje kundër padrejtësisë, konflikteve, pabarazisë, zilisë, luftës, shpërdorimit, frikës, fanatizmit, mizorisë, dhunës, imoralitetit dhe të tjera si këto, është zgjedhja më thelbësore për qeniet njerëzore, - që të gjejnë paqe, lumturi dhe drejtësi.

Njerëzit, të cilët i kanë kthyer shpinën fesë së vërtetë për përfitime të papërfillshme dhe dobësisë njerëzore, i bëjnë dëm të

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

madh vetes së tyre. Refuzimi i Kur'anit dhe Sunnetit, për një njeri do të thotë, të mbetet i pavetëdijsëm për të vërteta thelbësore të jetës. Vetëm se burimet që ai dhe qenie njerëzore si ai, kanë grumbulluar nuk do t'u mjaftojnë për të mbijetuar në situatat dhe problemet që hasin në botë. Njerëz të tillë do ta kalojnë gjithë jetën në shqetësim, ankth, stres, frikë dhe mjerim, duke mos gjetur zgjidhje për problemet e tyre. Dikur, ata do ta pranojnë këtë situatë dhe do ta kalojnë jetën që u mbetet të zhgënjyer, duke menduar se vuajtja e tyre është një "fakt i jetës", kur, në të vërtetë, ajo është një ndëshkim për shkak se ata nuk jetuan sipas këshillave të fesë dhe nuk e ndoqën rrugën e saj.

Besimtarët, të cilët pasojnë vlerat e përshkruara nga Allahu në Kur'an dhe i bëjnë ato sunduese të jetës së tyre, do të jetojnë në mënyrën më të mirë. Allahu i përgëzon besimtarët me fjalët e mëposhtme:

As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t'ju afrojnë tek Ne, por vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira (e meritojnë këtë). Ata do të kenë shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë dhe do të jenë të sigurtë në banesa të larta (në Parajsë). (Sure Sebe: 37)

Ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe japin zekatin, do të kenë shpërblim tek Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen. (Sure Bekare: 277)

Këta janë ata që i përmbahen besëlidhjes me Allahun dhe nuk e prishin premtimin. Dhe ata që mbajnë lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të mbahen, që kanë frikë Zotin e tyre e i frikësohen llogarrisë së rëndë. Dhe ata që durojnë për të fituar dashurinë e Zotit të tyre, që falin namazin, që ndajnë fshehurazi dhe haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne, dhe, që të keqen e kthejnë me të mirë. Atyre u takon shpërblimi në Shtëpinë e fundit. (Sure Rad: 20-22)

Harun Jahja (Adnan Oktar)



Shtojcë Mashtrimi i Evolucionit

Në këtë pjesë të librit, ne do të marrim në shqyrtim disa ide të mbrojtura nga evolucionistët, të cilët nuk besojnë në ekzistencën e Allahut dhe përpiqen t'i mashtrojnë të tjerët, duke pretenduar se, gjithçka erdhi në jetë vetë dhe rastësisht. Por, kur dikush përpiqet të mashtrojë dikë tjetër, e vërteta do të dalë një ditë në shesh. Nëse njeriu, i cili mashtrohet është i zgjuar, gjithmonë do të jetë i vetëdijshëm për faktin se është gënjer. Evolucionistët janë kontraktiktorë, për arsye se thonë gënjeshtër. Në faqet në vazhdim do të shohim se, sa të pabaza janë pohimet e tyre dhe se si është zbuluar mashtrimi i tyre.

ÇFARË ËSHTË TEORIA E EVOLUCIONIT?

Teoria e evolucionit është njëra nga idetë e gabuara të parashtruara nga njerëz, të cilët nuk besojnë në ekzistencën e Allahut. Në film, kjo ide u propozua nga Çarls Darvini, 150 vjet më parë. Sipas kë-

Harun Jahja (Adnan Oktar)

saj teorie jologjike, çdo gjë erdhi në ekzistencë spontanisht, në sajë të ndodhive të rastit. Për shembull, sipas Darvinit, një ditë të bukur, peshqit u shndëruan në gjitarë. Një ditë tjetër, ndodhi diçka tjetër e rastit; zvarranikët u shndëruan në zogj dhe filluan të fluturonin. Sa për njerëzit, ata kanë ardhur nga majmunët. Nuk ka absolutisht asnjë të vërtetë në këtë pohim. E vërteta e vetme është se, Allahu na krijoi ne, të gjitha gjallesat e tjera, botën dhe universin. Darvini dhe të tjerët që e kanë ngritur këtë pretendim, kanë thënë një gënjeshtër të madhe.

Atomët janë pjesëzat më të vogla, prej të cilave përbëhet lënda, qoftë e gjallë ose jo e gjallë. Kjo do të thotë se, çdo gjë rreth jush, përfshi edhe veten tuaj, është formuar në sajë të bashkimit të miliona atomeve. Evolucionistët (ata që ndjekin teorinë e Darvinit) thonë se, atomet vendosën të bashkohen dhe kështu, erdhën në jetë gjallesat. Sipas këtij pohim jologjik, një ditë, u ngrit një erë e madhe apo një stuhi dhe u bashkuan të gjitha këto atome. Sipas skenarit të Darvinit, këto atome u bashkuan për të formuar qelizat. Siç e dini, çdo gjalle-

Çarls Darvini

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

së përbëhet prej qelizash. Këto qeliza, më pas, bashkohen për të formuar sytë, veshët, gjakun, zemrën, shkurt, gjithë trupin tuaj. Ju duhet të keni parasysh se, qelizat janë sisteme shumë komplekse, apo të ndërlikuara. Në çdo qelizë, ka shumë organele të ndryshme. Ne mund ta krahasojmë një qelizë me një fabrikë të madhe. Në të ka shumë punëtorë, transportues për materialet, porta për hyrje dhe dalje, qendra prodhimi, transportues mesazhesh, qendra të kontrollit të energjisë, etj. A është e mundur për një fabrikë që të vijë në jetë vetë, rastësisht, pas një stuhie ku, gurët, dheu dhe uji u bashkuan dhe ajo u ndërtua rastësisht? Sigurisht që jo! Çdo njeri do të qeshte me këtë pohim absurd. Megjithatë, evolucionistët, shprehin një pohim që është po kaq qesharak duke thënë se, "Qeliza u formua rastësisht." Ata duan të na bëjnë të besojmë se këto qeliza formuan qeniet e gjalla kur u bashkuan nga një lloj rastësie.

T'i lemë Evolucionistët të Bëjnë një Eksperiment!

T'i lemë të marrin një fuçi të madhe dhe le të hedhin në të çfarë të dëshirojnë. Le të hedhin të gjitha materialet e nevojshme për formimin e një qenie të gjallë.

Më pas, ata mund t'i shtojnë asaj nxehtësi apo elektricitet sa të duan dhe mund ta vëzhgojnë atë për miliona vjet. (Ata mund t'ia lenë këtë detyrë edhe evolucionistëve të rinj, sepse gjithë jeta nuk do t'u mjaftonte për të kryer këtë punë.) Çfarë do të ndodhte pas kësaj? A mendoni se, qershitë, shalqinët, kumbullat, manushaqet, trëndafilat, elefantët, luanët, qingjat, bletët, macet, qentë, ketrat dhe peshqit mund të dilnin nga kjo fuçi? A mund të dilte prej saj një njeri, i cili lumturohet apo emocionohet, të cilit i pëlqen të dëgjojë muzikë dhe të lexojë libra? Sigurisht që jo! Prej saj nuk mund të dilte asnjë njeri, të themi një profesor, i cili të ndiqte zhvillimin e saj. Jo

Harun Jahja (Adnan Oktar)

vetëm që s'mund të dilte asnjë profesor, por asnjë qelizë e vetme nga trilonët e qelizave të trupit të një profesori. Atomët janë të pajeta. A mund të bashkohet lënda e pjetë dhe të prodhojë një qenie të gjallë, që qesh dhe mendon? Sigurisht që jo. Asnjë gjallesë e vetme nuk mund të krijohej prej asaj fuçie, sepse gjallesat nuk përbëhen prej copëzash lënde të pjetë, që formohet rastësisht. Allahu i ka krijuar të

**Lënda e pjetë kurrë
nuk mund të bashkohet
për të formuar një krije-
së të gjallë. Allahu ka
krijuar universin dhe të
gjitha gjallesat në të
nga asgjëja.**



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

gjitha qeniet e gjalla. Ai ka krijuar njerëzit, malet, liqenet, qingjat, luanët dhe lulet, atëherë kur nuk kishte asgjë në ekzistencë. Ai ka krijuar gjithçka nga asgjëja, vetëm duke thënë: "Bëhu!"


SI KANË EVOLUAR GJALLESAT SIPAS EVOLUCIONISTËVE?

Allahu i ka krijuar të gjitha llojet e gjallesave dhe asnjë prej tyre nuk mund të evoluojë prej tjetrës. Kjo për faktin se, çdo specie ka karakteristikat e saj të veçanta. Teoria e evolucionit është e gabuar në pohimin se saj se, gjallesat kanë evoluar me kalimin e kohës, kanë zhvilluar karakteristika të ndryshme dhe janë shndëruar në gjallesa të tjera. Ju të gjithë i keni parë breshkat, hardhucat dhe gjarprinjtë. Evolucionistët ngrenë pretendimin e palogjikshëm se këta zvarranikë, me kalimin e kohës, u shndëruan në zogj. Po cilat janë këto shkaqe që i bënë zvarranikët të shndërohen në krijesa të tjera? Evolucionistët besojnë se, evolucioni ndodh si rezultat i dy ngjarjeve të veçanta, të cilat ndodhin në të njëjtën kohë, të quajtura "mutacione" dhe "përzgjedhje natyrore." Ky është në të vërtetë një besim i palogjikshëm dhe pa asnjë bazë shkencore.

Çfarë Është Përzgjedhja Natyrore?

Shpjegimi më i thjeshtë për përzgjedhjen natyrore është se, krijesat që janë më të afta mbijetojnë, ndërsa ato më të dobëtat janë të destinuara të zhduken. Le ta shpjegojmë këtë me anë të një shembulli: mendoni për një tufë drerësh, të cilët sulmohen shpesh nga kafshët e egra. Atëherë, çfarë ndodh? Drerët fillojnë të vrapojnë shpejt, por, vetëm më të shpejtit dhe më të shkathët do të mbijetojnë. Gradualisht, drerët e dobët dhe më të ngathët do të zhduken krejtësisht, për shkak se do t'i sulmojnë grabitqarët. Ndërkaq, do të mbeten ve-

Harun Jahja (Adnan Oktar)



Në botë ka me mijëra lloje gjallesash. Evolucionistët kurrë nuk do të jenë në gjendje të shpjegojnë se, si erdhën në jetë ato. Ky është një nga shembujt më të mirë që shfaq mjeshtërinë krijuese të Allahut.

tëm drerët e shëndetshëm dhe të fortë. Prandaj, pas pak kohe, tufa do të përbëhet vetëm prej drerësh të aftë. Ajo çfarë kemi thënë deri këtu është e drejtë, por, këto që thamë nuk kanë të bëjnë fare me evolucionin. Megjithatë, evolucionistët besojnë se, kjo tufë drerësh do të zhvillohej gradualisht në një lloj tjetër kafshe, si psh, në gjirafa. Ju vetë mund ta kuptoni se sa të gabuar janë ata në pohimet e tyre! Ju e kuptoni se, sa të gabuar janë ata! Nuk ka rëndësi se sa shpejt vrapon një dre, apo se sa lart e ngre qafën, ai nuk mund të kthehet në një krijesë tjetër, psh në një luan apo gjirafë. Kjo mund të ndodhë vetëm nëpër përralla. Ju ndoshta mund ta dini të gjithë historinë për bretkocën që u shndërua në princ. Megjithatë, në jetën e vërtetë, për një dre është e pamundur që të kthehet në një luan apo ndonjë kafshë tjetër. Por, megjithatë, evolucionistët ende këmbëngulin se kjo gjë mund të ndodhë!

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Ç'janë Mutacionet?

Mutacionet janë ndryshime që sjellin pasoja negative tek një organizëm i gjallë. Ato mund të shkaktohen nga rrezatimet apo nga substancat kimike. Pasojat që lenë pas rrezatimet apo substancat kimike mbi qeniet e gjalla janë gjithmonë të dëmshme. Afrësisht 60 vjet më parë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, një bombë atomike u hodh në qytetin Hiroshima të Japonisë. Ajo shpërndau rrezatim në atë zonë dhe kjo u shkaktoi dëm të madh njerëzve. Rrezatimi i saj shkaktoi sëmundje të rëndë tek shumica e njerëzve që iu ekspozuan atij ose vdekje. E, çështje me keqja, ajo shkatërroi disa prej sistemeve të tyre në organizëm dhe kjo bëri që fëmijët e tyre të lindnin ose të sëmurë ose të paralizuar, të gjymtuar. Ja pra, kjo është ajo që evolucionistët duan të na bëjnë ne të besojmë: Një ditë të bukur, një peshk i nënshtrohet një procesi mutacioni; psh, ndikohet nga pasoja të rrezatimit, si njerëzit e Hiroshimës, apo nga diçka tjetër të ngjashme. Si rezultat i këtij mutacioni, në trupin e peshkut ndodhin disa ndryshime dhe një ditë ai shndërrohet në krokodil. Ky pohim me të vërtetë na bën për të qeshur. Për më tepër, ashtu



Harun Jahja (Adnan Oktar)

siç e përmendëm më lart, mutacionet janë gjithmonë të dëmshme tek qeniet e gjalla. Ato, ose mund t'i lenë të gjymtuara, ose mund t'i sëmurin gjallesat. Pohimin e evolucionistëve ne mund ta krahasojmë me shembullin më poshtë: nëse do të merrnit një sëpatë dhe ta godisnit fort një televizor bardhë e zi, si thoni, do të kthehej në një televizor me ngjyra? Sigurisht që jo! Nëse, ndonjëherë, do të godisnit një televizor e pakta do të ishte të merrnit në dorë një kafaz për llumbash. Po kështu, do të ndodhte nëse do të godisnit diçka tjetër me sëpatë, pa dyshim që do ta dëmtonte atë. Ashtu, edhe mutacionet i dëmtojnë qeniet e gjalla.



**Ai nuk ka shok në
sundimin e Tij. Ai
krijoi çdo gjë dhe e
përsosi në mënyrë të
qartë e të matur.
(Sure Furkan: 2)**



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

FOSILET QË EVOLUCIONISTËT NUK PO MUNDEN T'I GJEJNË

Një fosile është një pjesë e një kafshe apo e një bime që ka qenë në tokë për një kohë të gjatë, zakonisht, mijëra apo miliona vjet. Ajo ruhet në formacionet shkëmbore që ndodhen në koren e tokës. Me qëllim që një bimë



Nën shtresat e kores së tokës gjenden mbetjet e krijesave që kanë jetuar në të kaluarën. Këto mbetje quhen fosile dhe ato hedhin poshtë teoritë e hedhura prej evolucionistëve.

**Merimangë
fosile**



Kërmill fosil




Allahu krijoi çdo gjallesë prej uji. Ka prej tyre që zvarriten rrëshqitas në barkun e vet, ka që ecin me dy këmbë, ...

Harun Jahja (Adnan Oktar)

apo kafshë të kthehet në fosile, ajo duhet që të varroset menjëherë pasi ngordh. Për shembull, nëse në tokë do të ndodhej një zog dhe mbi të binte një pirg rëre dhe ta vriste, mbetjet e këtij zogu do të ruheshin për miliona vjet. Ngjashëm me këtë rast, mund të kemi rrëshirën e disa pemëve, të cilat fosilizohen në sajë të proceseve gjeologjike dhe në këtë rast quhen "qelibar." Në të kaluarën, kjo rrëshirë kapte zogjtë në grackë, kur rridhte nëpër pemë. Ajo, më pas, u ngurtësua dhe qelibari dhe insektet brenda saj janë ruajtur shumë mirë për miliona vjet me rradhë deri në ditët e sotme. Ky fakt na ndihmon në të mësojmë shumë për krijesat që kanë jetuar shumë kohë më parë. Të tilla mbetje të ruajtura mirë të një lloji apo të një tjetri quhen fosile.

... ka edhe të tilla që ecin të mëkatër
këmbët Allahu krijon çka të dojë, sepse
vërtet Allahu ka mundësi për çdo gjë.

(Sure Nur: 45)



Evolucionistët pretendojnë, për shembull, se, yjet e detit u zhvilluan për miliona vjet dhe u shndërruan në peshq. Sipas këtij pohimi, duhet të ketë shumë "forma të ndërmjetme" që gjenden midis yjeve të detit dhe peshqve. Por, deri tani, nuk është gjetur asnjë formë e tillë e ndërmjetme. Në mbetjet fosile gjenden yje deti dhe peshq, por, nuk ekziston asnjë formë e ndërmjetme me një formë të çuditshme që ngjan me të dy llojet.

Ç'kuptojmë me "Forma Kalimtare" të Fosileve?

Gënjeshtër më e madhe që kanë sajuar evolucionistët është ajo e "formave kalimtare". Në disa libra evolucioni ajo mund të gjendet edhe me termin "forma të ndërmjetme kalimtare." Siç e dini, evolucionistët parshetrojnë idenë se, krijesat kanë evoluar nga njëra-tjetra. Ata gjithashtu pohojnë se, krijesa e parë erdhi në jetë në sajë të rastësisë. Ata duan të na bëjnë të besojmë se, me kalimin e kohës, kjo krijesë u shndërrua në një tjetër, e kështu me rradhë. Evolucionistët thonë se peshqit, për shembull, e kanë prejardhjen nga një krijesë që i ngjante yllit të detit. Kjo do të thotë se, një ditë të bukur, në sajë të mutacionit, ylli i detit e humbi njërin nga krahët e tij. Përgjatë miliona vjetësh në vazhdim, ai i humbi edhe disa nga krahët e tjerë, përveç nja dyve që



Qindra fosile peshqish dhe
yesh deti janë gjetur. Por
përkundër trillimeve të
evolucionistëve, asnjë fosil i
ndërmjetëm nuk është gjetur
që të tregojë një yll deti në
procesin e shndërrimit
në peshk.

Një fosil peshku 50 milion vjeçar



Një yll deti fosil 400 milion vjeçar

Yjet e detit nuk kanë ndryshuar kurrë. Ata janë sot ekzaktësisht siç kanë qenë
miliona vjet më parë. Kjo vërteton se evolucionistët kanë gënjyer. Sipër mund të
shihni një yll deti dhe përkrah një yll deti fosil 400 milion vjeçar.



Foto e një gaforeje fosile që ka jetuar
150 milion vjet më parë



Foto e një gaforeje që jeton në
ditët e sotme. Nuk ka asnjë
ndryshim midis dy gaforeve,
apo jo?

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

filluan të bëhen fletëza notimi për hesap të tyre. Po ashtu, në të njëjtën kohë, ndodhën edhe shumë ndryshime që janë të nevojshme që një yll deti të shndërohet në peshk. (Asgjë nga këto që po themi nuk ka ndodhur kurrë, por, ne vetëm sa po ju kujtojmë ju të dashur fëmijë se, me çfarë duan të na mashtrojnë evolucionistët. Sipas teorisë së tyre, yllit të detit iu desh të kalonte nëpër shumë faza, derisa të kthehej në peshk. Kështu, këto krijesa imagjinare, në fazat e tyre të transformimit quhen lloje të ndërmjetme në procesin e evolucionit. Sërish, sipas teorisë jologjike të evolucionistëve, të gjitha ato duhet të kenë disa pjesë rudimentare apo të paformuara mirë. Për shembull, llojet e ndërmjetme, të cilat, gjatë formuar ndërsa peshqit po ktheheshin në zvarranikë, duhet të kenë këmbë, fletëza notimi, mushkëri dhe velëza "gjysmë të zhvilluara". Ne duhet të kemi parasysh se, nëse në të kaluarën do të kishin jetuar krijesa të tilla, do të gjenim patjetër fosile të tyre. Është interesant fakti se, deri tani nuk është gjetur asnjë fosile e këtyre llojeve të ndërmjetme, për të cilët evolucionistët pretendojnë të kenë ekzistuar. Krijesat nuk kanë ardhur nga njëra-tjetra. E vërteta është se, ato u sollën në jetë menjëherë, me të gjitha karakteristikat e tyre të paprekura dhe pa të meta. Ata nuk ndryshojnë aspak nga anëtarët e tjerë të llojeve të ndryshme, të cilat janë të gjalla në ditët e sotme. Allahu i krijoi ato të gjitha, pa përjashtim.

ÇFARË NDODHI GJATË PERIUDHËS KEMBRIANE?

Fosilet më të vjetra, janë ato, të cilat datojnë që nga koha e njohur si era Kembriane, që do të thotë 500 milion vjet më parë. Krijesat që kanë jetuar gjatë kësaj ere provojnë gjithashtu se, teoria e evolucionit është tërësisht një marrëzi. Po në ç'mënyrë?

Këto krijesa janë shfaqur të gjitha njëherësh gjatë erës Kembri-



Kjo krijesë e quajtur "trilobite" ka jetuar në erën Kambriane

ane. Para tyre nuk kishte asnjë gjallesë në planet. Fakti që, këto krijesa u shfaqën prej asgjësë dhe përnjëherë, është një provë që vërteton se, Allahu i krijoi ato në një moment të vetëm. Nëse teoria e propozuar nga evolucionistët do të ishte e vërtetë, atëherë, këto krijesa do të kishin evoluar gradualisht prej paraardhësve të tyre më të thjeshtë. Por, megjithatë, këto krijesa nuk kanë as paraardhës, as formë të kalimtare që të kenë jetuar para tyre. Nuk ka absolutisht asnjë gjurmë organizmash të tillë askund në mbetjet fosile. Fosilet na tregojnë se, këto krijesa, ashtu si dhe të gjithë gjallesat e tjera, u shfaqën papritur gjatë erës Kambriane, me të gjitha cilësitë e tyre të paprekura, por, pa asnjë paraardhës të supozuar evolutiv, prej të cilit të kishin evoluar. Kjo është prova më e qartë se, Allahu është Krijuesi i tyre. Për shembull, gjatë erës Kambriane ka jetuar një krijesë e quajtur trilobite, ndonëse ne nuk mund t'i shohim ato tani, sepse janë zhdukur. Trilobitet kishin sy shumë të ndërlikuar dhe të përsosur. Ato përbëheshin prej qindra qelizash në formë hojesh dhe këto qeliza u mundësonin atyre që të shihnin në mënyrë të përkryer. Është e qartë se, gjallesa me të tilla karakteristika të mrekullueshme nuk ka mundësi që të kenë ardhur në jetë në sajë të rastësisë.

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

GËNJESHTRA SE PESHQIT JANË SHNDËRUAR NË ZVARRANIKË

Evolucionistët thonë se, zvarranikët e kanë prejardhjen nga peshqit. Sipas tyre, një ditë, kur ushqimi në det u pakësua mjaft, peshqit vendosën ta kërkonin atë në tokë dhe kur mbërritën atje, ata u shndëruan në zvarranikë me qëllim që të mbijetonin. Siç mund ta shihni, kjo është një ide absurde, sepse gjithkush e di se çfarë do të ndodhte nëse peshqit do të mbeteshin pa ujë: ata do të ngordhnin! Keni shkuar ndonjëherë për peshk? Vetëm mendoni! Çfarë do të ndodhte nëse peshkut do t'i ngecte karremi dhe do të varej në kallamin tuaj dhe ju do t'i shpëtonit jetën dhe do ta çonit në shtëpi për të pushuar në oborrin tuaj? Ashtu siç thamë edhe më parë, sigurisht që do të ngordhte. Nëse do të shkonit përsëri për peshk dhe do të kapnit mjaft dhe t'i çonit përsëri në shtëpi, çfarë do të ndodhte? Po e njëjta gjë: ata të gjithë do të ngordhnin! Me gjithatë, evolucionistët refuzojnë të pajtohen me këtë fakt. Ata thonë se, një nga peshqit në oborrin tuaj, papritur filloi të ndryshojë kur ishte duke ngordhur dhe u shndërrua në zvarranik dhe vazhdoi të jetonte! Kjo është plotësisht e pamundur! Kurrë nuk mund të jetë e mundur, sepse midis peshqve dhe krijesave të tokës ka shumë ndryshime



Shpikje e Imagjinatës

Harun Jahja (Adnan Oktar)

dhe të gjitha ato nuk mund të ndodhin papritur dhe rastësisht. Le të përmendim disa elementë që u nevojiten peshqve për të mbijetuar në tokë:

1. Peshqit përdorin velëzat për të marrë frymë në ujë. Në tokë ata nuk mund të marrin frymë me velëza dhe kështu do të ngordhin nëse do të mbeten pa ujë. Atyre u duhen mushkëritë. Le të supozojmë se, një peshku iu mbush mendja të linte ujin dhe të jetonte në tokë: ku do t'i gjente mushkëritë? Për më tepër, ai nuk e ka idenë se ç'janë mushkëritë!

2. Peshqit nuk kanë një sistem veshkash si i yni, por, nëse do t'ju duhej të jetonin në tokë do të kishin nevojë për një të tillë. Nëse do të vendosnin të lëviznin në tokë të thatë, është shumë e qartë se, një peshk nuk do të ishte i aftë të gjente diku ndonjë palë veshka për vete.

3. Peshqit nuk kanë këmbë, prandaj nuk mund të ecin kur mbërrijnë në breg. Po si ia bënë peshqit të gjenin këmbë, kur vendosën të dilnin në tokë të thatë? E gjitha kjo është qartas e pamundur. Janë vetëm nja treqind gjëra që duhet të kishin patur peshqit, me qëllim që të mbijetonin në tokë.

Po Peshku Me Emrin Koelakanth?

Për vite me rradhë, evolucionistët, një peshk me emrin koelakanth, e kanë quajtur si formë kalimtare, e cila



Evolucionistët pretendojnë se, koelekanthi është një peshk që filloi të shdërrohej në një zvarranik. Më vonë, u zbulua një koelekanth i gjallë, duke dalë në shesh marifeti i evolucionistëve. Koelekanthi është një peshk i vërtetë.

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

pothuajse kishte dalë në breg të detit. Në të gjithë librat dhe revistat e tyre, ata e portretizonin atë si një provë të teorisë së tyre. Ata mendonin se, koelakanthi kishte shumë kohë që ishte zhdukur. Kjo është arsyeja pse shpikën një seri historish false kur studiuan fosilet e këtij peshku. Vetëm pak vjet më vonë, një peshkatar kapi një koelakanth të gjallë. Qysh atëherë, janë kapur shumë të tjerë. U bë e qartë se, koelakanthi është një peshk normal. Për më tepër, sipas evolucionistëve nuk ishte përgatitur për të dalë në breg. Evolucionistët janë shprehur se: "Ai jetonte në ujë shumë të cekët dhe po bëhej gati të dilte në breg." Në të vërtetë, koelakanthi jetonte në ujë shumë të thellë. Ai nuk ishte një formë kalimtare siç donin të besonin evolucionistët, por ishte një peshk i vërtetë. Që atëherë, deri në ditët e sotme, janë zbuluar mjaft ide fallco të evolucionistëve.

POHIMI SE, ZOGJTË E KANË PREJARDHJEN NGA ZVARRANIKËT ËSHTË I GËNJESHTËRT

Një deklaratë tjetër të gënjeshtërt që bëjnë evolucionistët është në lidhje me faktin se, si erdhën në jetë zogjtë. Përralla e tyre e gja-



Shpikje e Imagjinatës

Harun Jahja (Adnan Oktar)

të thotë se, zvarranikët, të cilët jetonin nëpër pemë, filluan të kërcenin nga njëra pemë tek tjetra dhe, në këtë kohë, ata zhvilluan krahët. Madje, një përrallë tjetër është se, disa zvarranikë, duke u përpjekur të kapin miza, filluan të vraponin dhe të përplasnin parakrahët dhe se, këta, më vonë, u shndërruan në krahë. A nuk është absurde të imagjinosh një dinosaur të zhvillojë krahë duke vrapuar? Gjëra të tilla mund të ndodhin vetëm nëpër përralla apo filma vizatimorë. Ka edhe një çështje shumë të rëndësishme. Këta evolucionistë thonë se, ky dinosaur i madh zhvilloi krahë kur përpiqej të kapte miza. Mirë, po si ia bënte vetë miza për t'u ngritur në ajër? Ku i gjeti krahët? Kur ata përpiqeshin të shpjegonin se, si mund të fluturonte një dinosaur i madh, a nuk duhet të kshin shpjeguar më parë se si mundej të fluturonte një insekt i vo-



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

gël? Sigurisht që po. Por, kjo është një nga çështjet që evolucionistët nuk do të jenë kurrë në gjendje ta shpjegojnë. Miza është një nga krijesat më të mira fluturuese në tokë. Ajo mund t'i përplasë krahët nga 500–1000 herë në sekondë. Siç e dini, ajo mund të manovrojë në ajër me lehtësi të madhe. Nuk ka rëndësi se, sa përralla tregojnë evolucionistët, ata ende nuk mund të shpjegojnë se, si u krijuan krahët e zogjve. E vërteta është se: Allahu ka krijuar krahët e zogjve dhe të mizave, së bashku me aftësinë e tyre për të fluturuar.

Arkeopteriksi, Të Cilin Evolucionistët e Quajnë Formë të Ndërmjetme, Ishte në të Vërtetë Një Zog Plot Me Pupla!

Në fillim le të japim disa ndryshime midis zvarranikëve dhe zogjve:

1. Zogjtë kanë krahë, kurse zvarranikët jo.
2. Zogjtë kanë pendë, kurse zvarranikët luspa.

3. Zogjtë kanë një sistem skeleti unik dhe kockat e tyre janë të zgavëruara. Kjo bën që ata të jenë më të lehtë dhe ua lehtëson fluturimin. Këto janë vetëm disa ndryshime, të cilat të vijnë ndër mend menjëherë. Por, ka edhe mjaft ndryshime të tjera midis këtyre krijesave. Nëse ndonjë lloj zvarranikësh do të ishte shndërruar në zogj, duhet të kishte patur shumë krijesa që duhet të kishin jetuar midis zogjve dhe zvarranikëve, të cilat të përfaqësonin fazat e këtij ndryshimi. Studiuesit e fosileve duhet të kenë ndeshur të paktën një nga këto lloje fosilesh. Kjo do të thotë se, duhet të kenë ekzistuar krijesa me gjysmë krahë, gjysmë të veshur me pupla dhe gjysëm me luspa, gjysmë gojë e gjysmë sqep dhe fosilet e tyre duhet të jenë gjetur, por, e vërteta është se, asnjë shëmbëlltyrë e tillë nuk është hasur në fosi-

Fosilja e një zogu të quajtur Arkeopteriks, të cilën evolucionistët u përpoqën ta përshkruanin si një lloj të ndërmjetëm, tregon se evolucioni është një teori që mbështetet mbi mashtrimin. Kjo fosile i përket një zogu të vërtetë dhe tregon se zogjtë nuk kanë ndryshuar aspak për miliona vjet.



let e tokës. Atë fosile që janë gjetur i përkasin ose një zvarraniku të plotë, ose një zogu të plotë. Kjo do të thotë se, zogjtë nuk kanë evoluuar prej zvarranikëve. Është Allahu, Ai, i cili ka krijuar zogjtë, ashtu si dhe gjithë gjallesat e tjera. Megjithatë, meqenëse, evolucionistët nuk duan ta pranojnë këtë, atëherë përpiqen t'i bindin edhe njerëzit e tjerë se, ajo që thonë ata është e vërtetë, duke shpikur përralla. Ata kanë gjetur fosilen e një zogu, të quajtur Arkeopteriks, i cili ka jetuar 150 milion vjet më parë dhe pretendon se, ky zog është një formë kalimtare midis dinosaurve dhe zogjve. Por, të thuash se, Arkeopteriksi ishte një paraardhës i zogjve është krejtësisht jologjike, sepse, ai ishte një zog me trupin të mbuluar me pupla! Për arsyen se:

1. Ai kishte pupla, ashtu si zogjtë në kohën tonë.
2. Ai kishte të njëtin kafaz kraharori, në të cilin ishin kapur krahet, ashtu si dhe zogjtë e tjerë që fluturojnë.
3. Arkeopteriksi nuk mund të jetë paraardhësi i të gjithë llojeve të zogjve sepse, janë gjetur fosile zogjsh që janë më të vjetër se ai.

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

PËRRALLA E GJATË E EVOLUCIONIT TË NJERIUT

Evolucionistët mbrojnë pikëpamjen se, njerëzit e kanë prejardhjen nga majmuni dhe për këtë arsye, majmunët janë paraardhësit tanë. As Darvini, as ndonjë evolucionist tjetër, nuk kanë patur kurrë ndonjë provë për ta mbështetur këtë pikëpamje, e cila është krejtësisht një fabrikim. Në të vërtetë, një nga arsyet pse u mendua teoria e evolucionit, në rradhë të parë, është t'i bëjë njerëzit të harrojnë se,

Allahu krijoi qeniet njerëzore me gjuhë, raca dhe ngjyra të ndryshme. Kjo shumëllojshmëri është një mirësi e mrekullueshme.



Harun Jahja (Adnan Oktar)

janë krijesa të Allahut. Nëse njerëzit besojnë se, ata kanë ardhur në jetë rastësisht dhe paraardhësit e tyre janë majmunët, atëherë ata nuk do të ndjejnë asnjë lloj përgjegjësie kundrejt Allahut. Si rrjedhim, kjo do t'i bënte ata të harronin të gjitha vlerat fetare dhe të bëheshin tepër egoistë. Vetëm njerëzit egoistë i humbin vlera të tilla, ashtu siç është dashuria për njerëzit dhe familjet e tyre. E kuptoni se, evolucionistët përpiqen t'i largojnë njerëzit prej ndjenjave të tilla dhe kjo është arsyeja pse, ata përpiqen të përhapin teorinë e evolucionit. Qëllimi i tyre është t'i bëjnë njerëzit ta harrojnë Allahun dhe i drejtohen çdo njeriu duke i thënë: "Allahu nuk të krijoi ty. Ti ke erdhur nga majmuni, me fjalë të tjera, ti je një kafshë e përparuar." E vërteta është



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

të se, Allahu i ka krijuar të gjithë njerëzit. Kraheluar me të gjitha kafshët e tjera, njeriu është krijesa e vetme që mund të flasë, të mendojë, të ngazëlletet, të marrë vendime, është inteligjent, mund të themelojë qytetërime dhe mund të komunikojë në një nivel shumë të përparuar. Allahu është Ai, i Cili ua ka dhënë të gjitha këto cilësi qenieve njerëzore.

Evolucionistët Nuk Mund të Ofrojnë Asnjë Provë se Njerëzit e Kanë Prejardhjen nga Majmuni

Në fushën e shkencës, është shumë e rëndësishme sjellja e "provave", apo argumenteve. Kur nxjerr një teori dhe dëshiron që edhe të tjerët ta besojnë atë, atëherë, duhet të japësh prova që e vërtetojnë atë.

Për shembull, nëse në rastin më të thjeshtë, ju i prezantoheni dikujt dhe ai nuk beson se ju jeni ai që jeni, atëherë në këtë rast, duhet të keni ndonjë provë që t'ia vërtetoni. Cila do të ishte prova juaj? Një provë do të ishte psh, një kartë identiteti,

Harun Jahja (Adnan Oktar)

një certifikatë lindje, pasaporta ose ndonjë dokument tjetër. Nëse do t'ia tregonit këto, këtij njeriu do t'i mbushej mendja se, ju jeni ai që jeni. Tani le të japim një shembull shkencor. Ishte një shkencëtar, i quajtur Isak Njuton, i cili ka jetuar në shekullin e 18-të, i cili thuhet se, ka zbuluar gravitetin. Kur njerëzit e pyesnin se, çfarë e bëri atë kaq të sigurt, ai përgjigjej:

"Kur molla shkëputet nga pema, ajo bie në tokë, nuk qëndron në ajër." Kjo përgjigje desh të thoshte se, ekziston një forcë që e tërheq mollën të bierë në tokë, të cilën ai e quajti "gravitet." Ngjashëm me këtë rast, edhe evolucionistët duhet të shfaqin disa prova për t'i bërë të besueshme teoritë e tyre. Për shembull, teoria e evolucionit thotë se, njeriu ka ardhur nga majmuni. Për këtë arsye, ne duhet t'i pyesim ata: Ku e gjetët këtë ide dhe ku janë provat tuaja? Nëse majmunët do të ishin me të vërtetë paraardhësit e njeriut, ne duhet të gjenim patjetër fosile të krijesave që do të ishin gjysmë majmun, gjysmë njeri, si vërtetim të kësaj. Megjithatë, nuk është zbuluar ende ndonjë fosile e tillë. Ne kemi gjetur vetëm fosilet e njerëzve ose të majmunëve. Kjo do të thotë se, evolucionistët nuk kanë absolutisht asnjë provë që majmunët janë paraardhësit e njeriut. Megjithatë, ata ende përpiqen t'i devijojnë njerëzit me teoritë e tyre.



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

Disa Mashtrime të Evolucionistëve:

1. Evolucionistët flasin për fosilet e majmunëve të zhdukur sikur ato t'u përkisnin krijesave që, sipas tyre, ishin gjysmë majmun e gjysmë njeri. Ju, sigurisht që, duhet të keni parë diku foto si kjo më lart, apo jo? Evolucionistët i përdorin ato për të mashtruar njerëzit. E vërteta është se, krijesa të tilla nuk kanë ekzistuar kurrë. Në të kaluarën, kanë ekzistuar njerëz si dhe majmunë, ashtu si në ditët e sotme dhe ata kanë qenë dhe janë krejtësisht të ndarë njëri nga tjetri dhe nuk kanë asnjë lidhje me njëri-tjetrin. Asnjë nga krijesat e shfaqura në faqen e kaluar nuk ka ekzistuar kurrë. Kjo gjë nuk ka ndodhur kurrë. Ashtu siç thamë edhe më lart, nuk është gjetur asnjë fosile që ta provojë një pohim të tillë. Megjithatë, evolucionistët vazhdimisht provojnë gënjeshtër të tipit të fundit mbi këtë temë. Për shembull, kur ata studiojnë një fosile që i përket një lloji të zhdukur majmunësh, ata pretendojnë se, ajo i përkiste një krijese midis majmunit dhe njeriut. Meqenëse, njerëzit nuk janë të mirëinformuar mbi këtë temë, ata priren të besojnë ato që thonë evolucionistët.

2. Evolucionistët i trajtojnë fosilet e njerëzve që u përkasin racave të ndryshme sikur ato të ishin krijesa gjysmë majmun, gjysmë njeri. Siç e dimë, në botë, ka mjaft raca etnike,

si: Afrikanët, Kinezët, Amerikanët Indigjenë, Turqit, Europianët, Arabët e shumë të tjerë. Është e qartë se, njerëzit që i përkasin grupeve të ndryshme etnike kanë karakteristika të ndryshme. Për shembull, Kinezët kanë sy në formë bajame dhe disa Afrikanë kanë lëkurë me ngjyrë shumë të errët dhe flokë shumë të dredhur. Kur shihni një Amerikan Indigjen dhe një Eskimez, menjëherë, ju e kuptoni se, ata i përkasin grupeve të ndryshme etnike. Në të kaluarën, kanë ekzistuar shumë grupe të tjera etnike dhe disa nga karakteristikat e tyre ishin të ndryshme nga ato që kanë njerëzit sot. Për

Harun Jahja (Adnan Oktar)

shembull, kafkat e njerëzve që i përkisnin racës së Neandertalit ishin më të mëdha se kafkat e njerëzve që jetojnë sot. Gjithashtu, muskujt e tyre ishin më të fortë se tanët. Megjithatë, evolucionistët i shfrytëzojnë ndryshimet midis kësaj race dhe tonës si një mënyrë për të mashtruar njerëzit. Për shembull, kur gjejnë një kafkë që i përket racës së Neandertalit ata thonë: "Kjo kafkë i përket paraardhësve të njeriut, të cilët kanë jetuar dhjetra mijëra vjet më parë." Ndonjëherë kafkat që ata gjejnë janë më të vogla se masa mesatare e kafkës së njerëzve që janë sot. Duke treguar me gisht tek ajo, ata thonë: "Ai që e ka patur këtë kafkë ka qenë pika e kalimit nga majmuni tek njeriu." Në realitet, edhe sot ka njerëz që i përkasin racave të ndryshme etnike, të cilët kanë kafka më të vogla se mesatarja. Për shembull, vëllimi i kafkës së Australianëve Autoktonë (Aborigjenëve) është shumë e vogël, por kjo nuk do të thotë se, ata janë gjysmë majmunë, gjysmë njerëz. Ata janë njerëz normalë, njëlloj si ju dhe si gjithkush tjetër. Rrjedhimisht, ne mund ta shohim se, fosilet të cilat, evolucionistët i portretizojnë si provë që tregon se njerëzit kanë rrjedhur nga majmuni, u përkasin racave të mëhershme të majmunëve apo njerëzve, të cilët tashmë janë zhdukur. Kjo do të thotë se, krijesat gjysmë majmun, gjysmë njeri nuk kanë ekzistuar kurrë.

DALLIMI MË I MADH

Dallimi më i madh midis majmunëve dhe njerëzve është se, njerëzit kanë shpirt, kurse majmunët jo. Njerëzit kanë ndërgjegje: ata mendojnë, flasin dhe i përçojnë mendimet e tyre të tjerëve në fjali të kuptimshme, marrin vendime, ndjejnë, zhvillojnë shije, dinë për artin, pikturojnë, kompozojnë, këndojnë dhe janë të mbushur plot ndjenja dashurie dhe vlera morale. Të gjitha këto cilësi janë unike për shpirtin e njeriut. Vetëm qeniet njerëzore i posedojnë kë-

24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

to karakteristika të veçanta. Evolucionistët janë të paaftë t'i përgjigjen kësaj pyetje. Një majmun, që t'i ngjante një njeriu, duhet t'i nënshtrohej shumë ndryshimeve fizike dhe duhej të kishte cilësi të tjera të njëjta me njerëzit. A ka ndonjë forcë në natyrë që t'ia japë një majmuni aftësi të tilla si: të menduarit, apo artet, si piktura dhe kompozimi? Sigurisht që jo! Allahu i ka krijuar vetëm njerëzit me të tilla aftësi dhe nuk u ka dhënë kafshëve asnjë nga këto aftësi. Siç e pamë, për një majmun është krejtësisht e pamundur që të shndërrohet në një qenie njerëzore. Qeniet njerëzore kanë qenë të tilla qysh nga dita kur u krijuan. Po ashtu, peshqit kanë qenë peshq dhe zogjtë kanë qenë zogj. Asnjë krijesë nuk është paraardhës i ndonjë tjetri. Allahu është Krijuesi i të gjithë njerëzve dhe i të gjitha gjallesave të tjera. Arsyeja pse, evolucionistët pretendojnë se, njeriu ka ardhur nga majmuni, është ngjashmëria fizike midis tyre. Megjithatë, ka edhe krijesa të tjera që u ngjajnë njerëzve edhe më tepër. Për shembull, papagalli që shihni në figurë mund të flasë. Oktapodët kanë sy të ngjashëm me ata të njerëzve. Macet dhe qentë na binden dhe dëgjojnë urdhrat tona krejt si njerëzit. Ç'do të mendonit nëse diskutohet do t'ju thoshte se, njerëzit kanë ardhur nga qentë, papagajtë apo oktapodët? E kuptoni, nuk ka ndryshim midis idesë dhe historive që shpikin evolucionistët.

ALLAHU ËSHTË KRIJUESI I GJITHÇKAJE

Zoti Ynë është Ai që ka vendosur biliona copëza informacioni në një vend kaq të vogël saqë, ne nuk mund ta shohim pa përdorur pajisje speciale. Allahu është Ai që na ka krijuar ne, sytë tanë, flokët, këmbët tona. Ai është, gjithashtu, Krijuesi i familjeve tona, i prindërve tanë, vëllezërve dhe motrave, shokëve dhe mësuesve. Allahu është

të Ai, që ka krijuar për ne ushqimin, të cilin ne e duam aq shumë, reçelin, drithërat dhe brumërat, frutat dhe perimet, që na bëjnë ne të shëndetshëm dhe të fortë. Nëse Allahu nuk do ta kishte krijuar luleshtrydhen, ne nuk do ta dinim se, si do të ishte shija e saj. Allahu na ka dhënë gjithashtu shqisat e të shijuarit dhe të nuhatjes. Nëse Ai nuk do të na i kishte dhënë ato, ne nuk do të dinim se çfarë shije do të kishin ushqimet. Për ne do të ishte njëlloj të hanim një patate apo një tortë. Allahu nuk ka krijuar vetëm ushqime të shijshme dhe me aromë të këndshme, por, Ai na ka dhënë neve aftësitë e nevojshme për t'i shijuar ato. Ju pëlqeni disa gjëra dhe kënaqeni me to dhe mendoni sa të këndshme janë. Për shembull një ëmbëlsirë, një lojë me të cilën kënaqeni duke luajtur apo një shëtitje me njerëzit e afërt. Çfarëdo që të jetë, kurë mos harroni se, është Allahu Ai i Cili i mundëson për ju të gjitha



24 ORË NGA JETA E MUSLIMANIT

këto. Sepse Ai është Krijues i Gjithmëshirshëm dhe Ai iu fal juve gjithmonë dhurata të bukura dhe të këndshme. Ka qenë një kohë kur ju nuk ekzistonit. Vetëm mendoni pak, ju nuk ishit askund para se të krijoheshit. Ju ishit asgjë. Allahu iu krijoi juve nga asgjëja. Për këtë arsye, ne duhet t'i jemi mirënjohës Allahut për çdo moment të jetës tonë. Në çdo gjë me të cilën kënaqemi dhe e duam, ne duhet të përkujtojmë Allahun dhe të themi: "O Allah! Unë të falenderoj Ty për të gjitha mirësitë që më ke falur." E nëse e gjejmë veten në një situatë të pakëndshme, përsëri duhet t'i lutemi Atij, sepse, vetëm Ai mund t'i rregullojë punët dhe gjendjet tona. Ai na i dëgjon lutjet dhe u përgjigjet atyre. Allahu e di se, çfarë mendojmë ne në thellësi të zemrave tona; Ai dëgjon dhe i përgjigjet çdo lutje. Ajo që na mbetet të bëjmë është, ta falenderojmë me gëzim Zotin tonë, i Cili na krijoi neve, botën tonë me gjithë mirësitë që përmban ajo. Duke ditur se, Allahu është gjithmonë me ne, na shikon dhe na dëgjon në çdo moment, ne duhet të vishemi gjithmonë me një sjellje të hijshme.

"Qofsh i lavdëruar! – thanë ata – Ne dimë

vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti."

(Sure Bekare: 32)